




# **Metoda e selefëve në trajtimin e fitneve**

Bledar Hoxha

# METODA E SELEFËVE NË TRAJTIMIN E FITNEVE

Përgatiti: Ebu Enes (Bledar HOXHA)  
Të drejtat e botimit: Libraria "Imam Albani"  
e-mail: imamalbani\_libri@yahoo.com

## Përmbajtja

### Parathënie

Kapitulli i parë: Muslimanët e brezave të parë të këtij populli

Kapitulli i dytë: Koha e shfaqjes së trazirave (fitneve)

Llojet e trazirave

Kapitulli i tretë: Historia e shfaqjes së hauarixhëve

Vrasja e prijësit të besimtarëve, Ali ibën Ebi Talib

Vazhdueshmëria e daljes së hauarixhëve dhe arritja e fitnes

Kapitulli i katërt: Gjendja e muslimanëve në kohën e sotme

Dukuria e hauarixhëve në kohën tonë

Fitneja e Xhuhejmanit dhe Haremit të Mekës

Fitneja e Hamasë (qytet në Siri)

Fitneja e Algjerisë dhe "Frontit Islam për Shpëtim"

Dialog i rebelëve algjerianë në majat e maleve me dijetarin e madh Ibën Utthejmin  
(Më, 1 Ramadan 1420h.)

Kapitulli i pestë: Fitneja i është autorizuar tre personave

Fjalë përmbledhëse rreth boshtit të fitnes, fryteve të saj

Kapitulli i gjashtë: Detyra e kohës në të cilën jetojmë

Kapitulli i shtatë: Llojet e dijeve dhe metodologjia e ndjekur për të arritur tek e  
vërteta e gjërave

Mospraktikimi i haditheve të fitneve në kohën aktuale

Përfitimi prej haditheve të fitneve sipas metodës së rregullt akademike

Domosdoshmëria e të mësuarit të haditheve për fitnet

Adoleshentët dhe hadithet e fitneve

Kapitulli i tetë: Kushtet dhe rregullat e praktikimit të haditheve të fitneve mbi ngjarje  
reale

Letra e shejhut të Islamit Ibën Tejmije për mbretin Nasir

Xhihadi në kohë fitnesh

Kapitulli i nëntë: Si duhet t'i kuptojmë hadithet e fitneve

Kapitulli i dhjetë: Fitneja dhe nxënësit shqiptarë të dijes

## Parathënie

Falenderimi i takon vetëm Allahut. Vetëm Atë falenderojmë, Atij i kërkojmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej të keqes së veteve (shpirtrave) dhe punëve tona. Atë të cilin e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb dhe atë të cilin humb Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një e i Pashok dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

**"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun me një devotshmëri të vërtetë dhe mos vdisni ndryshe, vetëm se duke qenë muslimanë!"**

**"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj i Cili ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm dhe pastaj krijoji prej tij shoqen e tij e prej atyre të dyve shtoi burra e gra të shumtë! Kini frikë Allahun me të Cilin ju kërkon të drejtat tuaja dhe ruajeni farefisën! Allahu është Mbikëqyrës mbi ju."**

**"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe flisni fjalë të drejta e të vërteta! Kështu, Ai jua rregullon juve punët tuaja dhe jua fal gjynahet tuaja. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai ka arritur fitoren më të madhe."**

Thënia më e mirë është Fjala e Allahut, ndërsa udhëzimi më i drejtë është ai i Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Punët më të këqija janë shpikjet në to, çdo shpikje është bidat (e panjohur më parë në fe) dhe çdo bidat është humbje (nga Rruga e Drejtë), ndërsa çdo humbje e ka vendin në zjarr.

\*\*\*

Fenomeni i njoftimit të të fshehtave dhe profetësive të të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), pushton pasionin dhe vëmendjen e çdo lexuesi të librave të sunetit. Ç'domethënie kanë? Ç'është për qëllim me to? Cili është ndikimi edukativ i tyre në shpirtin njerëzor? Cilat janë gjurmët e tyre në akiden islame, në hovin e muslimanit drejt thirrjes për tek Allahu i Madhëruar dhe në praktimin e Islamit në mënyrën e të jetuarit?

Për të njohur diçka nga të gjitha këto, duhet patjetër të analizojmë këtë fenomen me një analizë ligjore, e cila buron nga parimet kuranore, hadithet profetike, gjurmët e selefëve dhe konceptet autentike islame; pastaj t'i interpretojmë ato sipas bazave të përgjithshme, si dhe të analizojmë qëllimet e tyre në formimin e personalitetit islam.

Por, meqë natyra njerëzore është e prirë për të mësuar se çdo të ndodhë në të ardhmen dhe çfarë fshihet në botën mistere, kjo ka bërë që njerëzit të bien pre e mashtrimeve dhe

përshtjellimeve të shumë shkrimtarëve të këtyre kohëve të fundit, qoftë për shkak të injorancës apo për qëllime, të cilat i di vetëm Allahu i Lartësuar.

Si t'i dallojmë ata dhe cila është mënyra e të perceptuarit të këtyre haditheve, si dhe ndikimi i tyre në jetën e shoqërisë muslimane?

\*\*\*

Nëse do të hidhje një vështrim në realitetin e gjendjes së muslimanëve sot, do të të ulej shikimi i trishtuar dhe do të ndjeheshe, ndoshta, pesimist. Gjaku i muslimanëve sot është shumë i lirë dhe derdhet pa të keq. Përçarja dhe mosmarrëveshja ndërmjet muslimanëve është e madhe. Ata janë ndarë në parti e grupe të shumta, duke menduar se kjo do të ishte zgjidhja e problemit dhe arritja e vendit të tyre si muslimanë në mesin e kombeve.

Në të vërtetë, çështja nuk do të ishte kaq e ndërlikuar, nëse muslimanët do të kishin ndjekur udhëzimet e dijetarëve të tyre, qofshin ata muslimanë të thjeshtë apo nxënës të dijes, apo shoqata e grupe, të cilat janë themeluar për përmirësimin dhe ndryshimin e gjendjes së muslimanëve, sipas pretendimit të tyre.

Më interesante është se të gjithë ata thonë se janë prej ehli sunetit, madje disa thonë se janë selefi... por a është e vërtetë diçka e tillë?

Si mund ta njohim vërtet menhexhin e selefëve dhe si t'i dallojmë ata të cilët janë nga ata që nuk janë selefi?

Kjo është shumë e thjeshtë dhe e lehtë, sepse Allahu nuk e ka lënë popullin musliman në dorë të fatit. Ai u dërgon atyre në krye të çdo shekulli dikë që t'iu ripërtërijë fenë e tyre, siç thuhet në hadithin e saktë nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Pikërisht, këta dijetarë edukatorë, janë ata të cilët i tregojnë popullit rrugën e tij, atë që duhet dhe që nuk duhet të bëjnë. Ata janë si dielli që ndriçon dhe ngroh me rrezet e tij, ata janë dijetarët e mëdhenj selefi. Për ta dhe dijen e tyre ka dëshmuar i gjithë populli musliman.

Rruga e tyre është e qartë, menhexhi i tyre është ai i selefëve, detyra dhe jeta e tyre kanë qenë për edukimin e popullit musliman me edukim qiellor.

Prej menhexhit të selefëve është se ata nuk pranojnë kurrë asgjë pa e vërtetuar atë dhe pa ditur se kush e ka thënë. Ata për çdo fjalë të dikujt kërkojnë senedin deri tek ai që e ka thënë atë. Senedi është ai që e ka ruajtur këtë menhexh (menhexhin e selefëve) në veçanti dhe Islamin bashkë me dy burimet e tij, Kuranin dhe Sunetin, në përgjithësi.

Senedi dhe vërtetimi i fjalëve mund të jenë shkak për ruajtjen apo derdhjen e gjakrave, për ruajtjen apo shkeljen e ndereve e të pasurive të muslimanëve, siç do ta shohim me fakte në faqet e këtij libri.

\*\*\*

Për përgatitjen e këtij libri, shkak u bënë disa vëllezër të mi, të cilët më kërkuan të përgatisja disa fletë në lidhje me gjendjen e vëllezërve muslimanë të Shqipërisë, si dhe për rrugën (menhexhin) e selefëve në edukimin e popullit dhe në trajtimin e fitneve e trazirave. Kështu që, fillova të hartoja kapitujt e librit dhe të mblidhja materialin.

Mund të them se e gjeta atë që kërkoja, madje thuajse të përputhur krejtësisht në disa tema, në librin e shejh Meshhur Hasen el Selman, me titull "Iraku në Hadithet dhe etheret e fitneve". Kam përfituar shumë prej këtij libri, madje disa tema i kam marrë fjalë për fjalë nga ai.

Nëse kam marrë nga burime të tjera, këtë gjë e kam shënuar në shënimet poshtë faqes së librit.

Sigurisht, këto fletë i drejtohen vëllezërve muslimanë të cilët flasin gjuhën shqipe, por kjo nuk do të thotë që të mos flasim edhe për gjendjen e muslimanëve në përgjithësi, sepse muslimanët janë si një trup i vetëm, por do të veçojmë muslimanët shqiptarë në disa çështje që kanë të bëjnë me ta në veçanti, apo në lidhje me të tjerët.

Nga vetë tematika e librit, ai nuk është shumë i këshilluar për muslimanët e rinj në fe, thjesht, për arsyen se në të ka disa shprehje apo terma paksa të vështira, d.m.th që kërkojnë të kesh disa njohuri paraprake rreth Islamit dhe degëve të tij.

\*\*\*

Libri është trajtuar në mënyrë të atillë që fillon me fragmente të historisë së muslimanëve të parë, pastaj shfaqjen e bidateve dhe trazirave në mesin e muslimanëve, si dhe shkaqet e tyre dhe mënyrën e trajtimit nga selefët.

Më pas kemi kaluar në kohë për të hedhur dritë mbi disa trazira (fitne) të kohëve të fundit, shkaqet, atë që qëndron pas tyre, si dhe trajtimin e tyre nga dijetarët e mëdhenj selefi bashkëkohorë.

Subhan-Allah! Disa persona të cilët i thonë vetes mendimtarë islam, menhexhi i të cilëve nuk është as Kurani (të cilin disa e interpretojnë sipas autokracisë së tyre), as Suneti, e aq më pak rruga e selefëve, të cilët vetë i thonë vetes se nuk janë dijetarë, por mendimtarë; a është e drejtë të ndiqen këta dhe të lihen dijetarët e vërtetë?! A jemi urdhëruar të pasojmë rrugën e këtyre, apo rrugën e dijetarëve të Islamit?!

Ose ka humbur logjika, ose dëshmohet kundër vetes me humbje të sigurtë në të dyja botët!

\*\*\*

Qëllimi me këtë libër është dhënia e kontributit për ardhjen në ndihmë të vëllezërve të mi muslimanë shqiptarë, në mënyrë që ata të njohin menhexhin e selefëve dhe të dijetarëve të mëdhenj në trajtimin e problemeve dhe trazirave, si dhe në rregullimin dhe ndryshimin e gjendjes së muslimanëve; d.m.th. me qëllim që ata të njohin aktualitetin dhe të dinë si ta trajtojnë atë.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në shumë hadithe të tij ka folur për trazirat dhe shtimin e tyre me kalimin e kohës. Qëllimi i tij ka qënë paralajmërimi i njerëzve dhe mësimi i tyre se si duhet të veprojnë, nëse ata i arrijnë ato trazira. Disa prej këtyre haditheve janë përmendur edhe në këtë libër.

Lus Allahun e Madhëruar të na japë sinqeritet në fjalë e në vepër, të më bëjë dobi me këtë vepër mua dhe vëllezërve të mi muslimanë! Ai është Dëgjues dhe Plotësuesi i lutjeve!

\*\*\*

## Kapitulli i parë

### **Muslimanët e brezave të parë të këtij populli dhe trajektorja e shfaqjes së bidateve në mesin e tyre**

Mund t'i ndanim këto breza në disa periudha kohore si më poshtë:

#### **- Periudha e parë: Nga viti (1-37 h.)**

Kurani i nderuar iu shpall të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për njëzet e tre vjet me radhë dhe ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ua komunikonte atë njerëzve, duke ua sqaruar atyre, derisa u plotësua feja dhe Mirësia e Allahut, pastaj Allahu i Madhëruar e mori të Dërguarin e Tij.

Shokët e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e dëgjonin Kuranin dhe e kuptonin domethënien e tij, pastaj besonin në të dhe punonin sipas dispozitave të tij.



Nga gjërat me të cilat zbriti Kurani i ndershëm është njoftimi për gjërat e fshehta si: njoftimi për Qënien e Allahut të Madhëruar si dhe Cilësitë, Emrat dhe Veprat e Tij, njoftimi për botën tjetër, për ngjarjet dhe tmerret e saj, për xhenetin dhe zjarrin si dhe për atë që ka përgatitur Allahu në to prej shpërblimit dhe dënimit të Tij...

Të gjitha këto e të tjera si këto, shpalleshin në Kuran dhe i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ua komunikonte ato njerëzve, duke i sqaruar ato, ndërsa sahabët e tij i dëgjonin, i kuptonin dhe besonin në to. Ne besojmë se ata i kuptonin të gjitha gjërat që u thuheshin në fe, sepse përndryshe do të kishin pyetur dhe kërkuar sqarim për domethënien e tyre të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), pasi kjo kishte të bënte me pjesën kryesore të jetës së tyre, me pjesën e bindjes dhe besimit.

A nuk ishin ata në fillim të Islamit, të cilët i drejtuan shpatën në fytyrë të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për shkak se ende nuk ishin bindur për misionin e tij, ndërsa më pas ata e ruanin atë me vetet e tyre, me fëmijët dhe pasuritë e tyre?

Sigurisht që këtë gjë, ata nuk do ta bënë për hir të një feje së cilës nuk ia njihnin bindjen dhe domethënien e saj.

Ndoshta, disa prej sahabëve e kanë pyetur të Dërguarin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për disa çështje të cilat lidhen me dispozitat e sheriatit, por ato ishin çështje të cilat kishin lidhje me veprat dhe jo me bindjen e besimin.

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në lidhje me këtë thotë:

"Nuk kam parë popull më të mirë se shokët e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Ata nuk e kanë pyetur atë, vetëm se për trembëdhjetë çështje, derisa ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ndërroi jetë dhe të gjitha ato çështje janë në Kuran...**"Të pyesin ty për periodat..."; "Të pyesin ty për muajin haram (të ndalur)..."**; **"Të pyesin ty për jetimët..."**. Ata nuk e pyesnin për gjë tjetër, përveç asaj që iu bënte dobi."

Ky është realiteti në të cilin jetuan sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Shoqëria e tyre ka qenë e pastër dhe larg çdo devijimi apo rrëshqitjeje që mund të prekte pastërtinë dhe kthjelltësinë e saj.

Në fakt, disa devijime kërkuar të ngrenë kokë në atë shoqëri, por ato u trajtuan në kohën e duhur, që në djep dhe nuk u shfaqën më kurrë në këtë periudhë.

Në kohën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dikush prej sahabëve foli për kaderin (caktimin), por i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin

mbi të!) u zemërua dhe i ndaloi nga thellimi në të, ndërsa ata ndaluan veten përnjëherë nga kjo gjë.

Abdullah ibën Amër ibën el Asi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) thotë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) doli dhe i gjeti ata duke u grindur për caktimin e Allahut. Dikush përmendte një ajet dhe dikush një ajet tjetër. Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) u skuq sikur të kishte plasur para fytyrës së tij një kokërr shegë, pastaj tha: "A mos jeni urdhëruar për këtë gjë? A mos jeni ngarkuar që të përplasni një pjesë të Librit të Allahut me një pjesë tjetër të tij? Shihni atë për të cilën jeni urdhëruar dhe kryejeni atë! Shihni atë nga e cila jeni ndaluar dhe largohuni prej saj!"

Ky hadith tregon se disa prej sahabëve u futën në çështjen e kaderit në kohën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), por ajo polemikë ishte diçka aksidentale dhe nuk u përsërit më prej tyre.

Në kohën e Umer ibën el Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) u shfaqën tek-tuk disa gjëra të tilla, por u zhdukën shumë shpejt.

Përmendim këtu atë që ka ndodhur me Sabigun, i cili pyeste për ajetet jo të qarta në Kuran (muteshabih), por Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) e rrahu atë, derisa u pendua.

Transmeton El Lalikai me senedin e tij nga Sulejman ibën Jesar se një burrë prej fisit beni temim, të cilin e quanin Sabig ibën Isël hyri në Medine duke pasur me vete disa libra. Ai filloi të pyeste për ajetet jo të qarta të Kuranit. Kjo gjë i shkoi në vesh Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), i cili dërgoi që ta thërrasin, ndërkohë që kishte bërë gati disa lëvore hurme për të goditur atë.

Kur ai hyri dhe u ul, Umeri i tha:

- Kush je ti?

- Unë jam rob i Allahut, Sabigu.

- Ndërsa unë jam rob i Allahut, Umeri. Pastaj u ngrit dhe filloi ta godasë me lëvoret e thata. Vazhdoi ta godasë derisa e çau dhe filloi t'i rridhte gjaku nëpër fytyrë.

- Mjaft, o prijësi i besimtarëve! Për Allahun, më iku ajo që kisha në kokë."

Me këtë përmbledhje bëhet e qartë pastërtia e atij brezi nga bidatet dhe devijimet në akide dhe metodologji (menhexh). Ky brez konsiderohet shembull i saktë, tek i cili duhet të hedhë vështrimin muslimani në çdo kohë. Ky brez, është gjithashtu, baza origjinale, mbi të cilën mbështeten pasuesit e sunetit dhe të xhematit për kuptimin e Islamit dhe njohjen e tij.

Atë që ka njohur dhe që ka bërë të qartë ky brez, e kanë marrë pasuesit e tyre dhe e kanë publikuar, ndërsa atë për të cilën kanë heshtur dhe nuk kanë hyrë në të, ata janë larguar prej saj dhe e kanë lënë. Ai brez janë njerëzit më të mirë pas pejgamberëve të Allahut.



Ata janë më të ditur në fenë e Allahut dhe qëllimin e Tij se kushdo tjetër prej krijesave të Allahut. Allahu i zgjodhi ata për të qenë shokë të të Dërguarit të Tij, ndihmues të fesë së Tij, ngritje të Fjalës së Tij dhe për komunikimin e saj të krijesat e Tij, gjë e cila është nderi më i madh dhe dëshmia më e madhe për ta nga Krijuesi i tyre.

Ai që nuk i merr ata për shembull dhe nuk e ndjek rrugën e tyre, ai është mbi një dërrasë të kalbur, e cila është gati për t'u gremisur bashkë me të në zjarrin e xhehenemit.

#### **- Periudha e dytë: Nga viti (37-100 h.)**

Në këtë periudhë, e cila fillon nga mesi i pushtetit të Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), u shfaqën kokat e bidateve. Kjo për shkak të gjurmëve të mosmarrëveshjeve politike, me të cilat u ndeshën sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) në përpjekjet e tyre.

Në kohën e tij (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), u shfaqën hauarixhët dhe shijat, dy grupe të kundërta me njëri-tjetrin. Njëri grup e quan Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) kafir dhe e mohon atë si udhëheqës të tyre, ndërsa grupi tjetër e mbështet dhe e ndihmon atë. Më pas u shfaqën grupe të tjera si: kaderijet dhe murxhijet, të cilat do t'i sqarojmë më pas.

#### **Bidati i hauarixhëve**

Hauarixhët u shfaqën në kohën e Ali ibën ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), në vitin 37 h. për shkak se ata e kundërshtuan çështjen e gjykimit, edhe pse në fakt, ishin ata të cilët e detyruan Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) që ta pranonte gjykimin kur shokët e Muauijes ngritën Kuranin me shpatat e tyre. Kur ai ua përmendi atyre detyrimin që i kishin bërë, ata thanë: "Kjo gjë ishte kufër nga ana jonë, por ne u penduam tek Allahu i Madhëruar, kështu që pendohu edhe ti, siç u penduam ne dhe atëherë do të japim besën!"

Ata njerëz e keqkuptuan çështjen e gjykimit dhe thanë se Aliu mori gjykatës burrat për fenë e Allahut.

Njëri prej hauarixhëve i tha Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!): "Për Allahun, o Ali, nëse ti nuk e lë gjykimin e burrave në Librin e Allahut të Madhëruar, unë do të luftoj ty, duke kërkuar me këtë Fytyrën e Allahut dhe kënaqësinë e Tij."

Origjina e ngatërresës dhe dyshimit të tyre është se ata u argumentuan me Fjalën e Allahut: "**Dhe kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu, ata janë josbesimtarë.**" Dhe me Fjalën e Allahut: "**Atëherë luftojeni atë grup që ngre krye, derisa të veprojnë në përputhje me urdhërin e Allahut!**"

Ata thonë: "Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që të luftohen kryengritësit, ndërsa Aliu e la luftimin e tyre në kohën kur veptoi sipas gjykimit (pajtimit), duke lënë kështu Ligjin e Allahut të Madhëruar, gjë e cila të çon në mosbesim, sepse Allahu thotë: **"Dhe kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu, ata janë josbesimtarë."**

Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) u përpoq që t'ua hiqte atë ngatërresë dhe moskuptim për çështjen e gjykimit, duke thënë se ai në të vërtetë, ka marrë për gjykatës Librin e Allahut dhe u vuri kusht dy gjykatësve që të ngjallin atë që ka ngjallur Kurani dhe të vdesin atë që Kurani e ka vdekur.

Nga ana tjetër, Kurani është i shkruar midis dy koreve të librit dhe nuk flet, por ata që flasin me të janë burrat.

Ata nuk e pranuan fjalën e tij dhe vazhduan në errësirën e tyre, derisa përfundoi çështja me vrasjen e tij.

Më pas, huarixhët filluan të gjykojnë për çdo njeri që bën gjynah të madh, se ai ka dalë nga Islami dhe lejohet gjaku dhe pasuria e tij.

### **Bidati i shijave**

Përkrahja e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në fillim të çështjes, ishte diçka e mesme dhe e drejtë, sepse në mesin e sahabëve kishte prej tyre që e paraprinin në pushtet Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) mbi Uthmanin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) pa shfaqur ndonjë pakënaqësi apo sharje të dy prijësve të mëparshëm, Ebu Bekrit dhe Umerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Ka ardhur me lajm të prerë e të saktë nga Ali ibën Ebu Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ai ka thënë: "Më i miri prej këtij populli pas të Dërguarit të tij, është Ebu Bekri, pastaj Umeri."

Kjo është një çështje për të cilën kanë rënë dakord shijat e vjetër. Të gjithë ata e konsideronin Ebu Bekrin dhe Umerin si më të mirët e popullit, por mosmarrëveshja ishte për Aliun dhe Uthmanin, në kohën kur disa u bënë grup me njërin dhe të tjerë grup me tjetrin, kurse Ebu Bekri dhe Umeri nuk kishte asnjë që të bëhej grup me ta, por i gjithë populli ishin një pas tyre, madje edhe huarixhët..." Më pas u shfaq një person çifut, të cilin e quanin Abdullah ibën Sebe, i cili shfaqti Islamin dhe pretendoi se e donte familjen e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Ai e teproi me Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) derisa tha se udhëheqja është trashëgimi e tij dhe më pas e ngriti atë deri në hyznizim.

Shijat, me gjithë kundërshtimet dhe numrin e shumtë të grupeve të tyre, trashëguan fjalën se Aliu është imami dhe halifja i cili është përmendur në Kuran dhe në amanetin e

të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Të gjitha këto ishin mbetjet e Ibën Sebe.

Kështu, shijat shpikën amanetin e hilafetit, rikthimin e imamëve, mungesën e imamet të fundit, madje edhe fjalën se Aliu është zot.

### **Bidati i kaderive**

Fjala për caktimin dhe lidhjen e veprave të njerëzve me dëshirën e Allahut të Madhëruar është prej çështjeve të cilat kanë ekzistuar që para Islamit, siç na tregon për këtë Libri i Allahut të Madhëruar.

Allahu i Lartësuar thotë: **"Idhujtarët thanë: "Sikur të donte Allahu, nuk do të kishim adhuruar gjë tjetër përveç Atij, as ne dhe as prindërit tanë. As nuk do të kishim bërë haram diçka pa urdhërin e Tij. Kështu kanë vepruar edhe ata që kanë qenë para tyre. A kanë detyrë tjetër të Dërguarit, veçse komunikimin e qartë?" [En Nahl: 35].**

Fjala për caktimin u shfaq pas mesit të shekullit të parë të hixhretit nga Meabed el Xhuheni, i cili e mori nga një person i krishterë që u bë musliman dhe më pas u kthye përsëri i krishterë. Meabedi ishte i pari që e përhapri atë në mesin e njerëzve. Transmeton Muslimi nga Jahja ibën Jeamer se ai thotë: "I pari që foli për kaderin (caktimin) ishte Meabed el Xhuheni në Basra."

Ibën Auni thotë: "Arritën njerëzit të flisnin për Aliun dhe Uthmanin, derisa diku aty u shfaq dikush që i thonë Sensuejh El Bekal. Ai ishte i pari që foli për kaderin."

Kaderitë në fillimin e shfaqjes së tyre thonin se gjërat ndodhin pa e ditur Allahu më parë dhe pa caktuar Ai. Allahu e di atë që ndodh, vetëm pasi të ndodhë.

Por, kaderijet me këtë kuptim janë shkrirë dhe nuk gjendet njeri prej tyre, siç thotë Ibën Haxher, i cili e transmeton nga El Kurtubi: "Ky medhheb është shkrirë dhe nuk njohim sot asnjë prej të mëvonshmëve që t'i drejtohet atij."

"Ndërsa kaderijet e sotëm e pohojnë që Allahu e di se çdo të ndodhë para se të ndodhë, por ata e kundërshtojnë rrugën e selefëve duke thënë se veprat e njerëzve bëhen me fuqinë dhe mundësinë e tyre në mënyrë të pavarur."

Fjalën për kaderin e mbështetën Mu'tezilitë dhe kështu u shtua numri i grupeve dhe medhhebeve rreth tij.

**Bidati i murxhive**

El Irxha është vonimi i punës nga imani (besimi).

El Bagdadi thotë: “Ata u quajtën murxhie sepse vonuan (lanë mënjane) punën nga imani.”

Si fillim El Irxha u shfaq si kundërthënie e bërjes mohues (tekfir) të atyre të cilët morën njerëzit për gjykatës dhe bërjen kafir të Ali ibën Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) prej hauarixhëve, por ai nuk është El irxha që lidhet me imanin.

I pari që ka folur për El Irxha ka qënë El Hasen ibën Muhamed ibën el Hanefije, i cili ka vdekur në vitin 99 hixhri. Këtë e kanë përmendur të gjithë ata që kanë shkruar për biografinë e tij. Libri që ai ka shkruar për El irxha nuk flet për irxhain në besim, por për lënien në Dorë të Allahut çështjen e fitnes (ngatërresës) që ndodhi pas dy shejhave të mëdhenj, Ebu Bekrit dhe Umerit.

Librat që flasin për grupet muslimane thonë se Gajlan ed Dimashki, i cili e ka trashëguar kaderizmin nga Meabedi, ka qënë murxhi. Zerkani transmeton prej tij se ai ka thënë: “Imani është pohimi me gjuhë dhe ai është besimi. Ndërsa njohja e Allahut është vepër e Allahut dhe nuk është prej besimit.”

Më pas vjen Xhehm ibën Safvan, i cili u vra në vitin 128 hixhri dhe thotë: “Imani është vetëm njohja e Allahut (të besosh që ka Zot).”

**- Periudha e tretë: Nga viti (100-150 h.)**

Në hyrje të shekullit të dytë të hixhretit u shfaqën katër personalitete prej bidatçinjve, çdonjëri prej të cilëve u bë kokë për në humbje dhe errësirë.

Këta të katërt ishin:

- 1.Uasil ibën Ata' El Basri, i cili është themeluesi i grupit të mutezilive (vdiq 131 h.)
- 2.El Xhead ibën Dirhem (vdiq 124 h.)
- 3.El Xhehm ibën Safuan (vdiq 128 h.)
- 4.Mukatil ibën Sulejman (vdiq 150 h.)

**Bidatet e Uasil ibën Ata'**

Ato janë dy bidate kryesore:

Bidati i parë: Gjykimi i tij për atë që bën gjynah të madh se ai ndodhet në një gjendje midis dy gjendjeve, as besimtar, as josbesimtar.

Bidati i dytë: Thënia e tij se njëra nga dy palët që luftuan njëra-tjetrën prej sahabëve është e prishur (fasik), por pa thënë se cila prej tyre. Për këtë shkak ata e diskredituan drejtësinë e tyre dhe nuk e pranorin dëshminë e askujt prej tyre.

### **Bidatet e El Xhead ibën Dirhem**

Ky ishte i pari që tha se Kurani është i krijuar dhe se Allahu nuk ka folur vërtet me Fjalët e Tij. Ai gjithashtu ka mohuar që Allahu ta ketë marrë Ibrahimin të dashur të Tij. Ky ishte i pari që foli për Cilësitë e Allahut, duke i mohuar ato. Profesori i tij, Uehbi ibën Munebih e vuri re fillimin e devijimit tek ai për shkak të pyetjeve të tij të shumta rreth Cilësive të Allahut të Madhëruar dhe i tha atij: "Mjerë ti, o Xhead! Mos e zgjat në këtë çështje sepse unë të shoh prej të shkatërruarëve! Nëse Allahu nuk do të na tregonte në Librin e Tij se Ai ka Dorë, ne nuk do ta thonim këtë. Pastaj përmendi Cilësitë e tjera si: Dija, Fjala etj."

### **Bidatet e El Xhehm ibën Safuan**

Xhehmi mbështeti idetë e El Xhead ibën Dirhem në lidhje me mohimin e Cilësive të Allahut dhe fjalën se Kurani është i krijuar, por ai shtoi disa bidate të tjera:

1. Thënia se njeriu është i detyruar në veprat e tij dhe i pavullnetshëm në kryerjen e tyre. Ai nuk cilësohet si i mundshëm dhe as me fuqi veprimi.
2. Thënia se imani është thjesht njohja e Allahut, ndërsa kufri është thjesht mosnjohja e Allahut (mosbesimi në Zot).
3. Thënia se xheneti dhe zjarri do të kenë fund, sepse sipas tyre nuk mund të imagjinohen lëvizje të pafundshme.
4. Thënia se dija e Allahut është e rastësishme, duke thënë se nuk lejohet që Allahu t'i dijë gjërat para se të ndodhin.

### **Bidatet e Mukatil ibën Sulejman**

Mukatili e teproi në pohimin e Cilësive të Allahut të Lartësuar, derisa i përngjasoi ato me cilësitë e krijesave. Shkak për këtë ndoshta ka qënë teprimi i Xhehmit në mohimin e tyre. Është përcjellë nga Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë!) se ka thënë: "Nga lindja na erdhën dy ide të prishura: Ideja e Xhehmit, mohues të Cilësive të Allahut dhe ideja e Mukatilit, përngjasues i Cilësive të Allahut me ato të njerëzve."

### **- Periudha e katërt: Nga viti (150-234 h.)**

Në këtë periudhë nuk u shfaq ndonjë bidat i ri, por ato që ishin u ndërthurën dhe u ndërlikuan tek njëri-tjetri, duke na dhënë katër grupe kryesore:

- 1.Hauarixhët
- 2.Shijat
- 3.Mutezilitë
- 4.Murxhitë

Në këtë periudhë u rrit lëvizja e mutezilive dhe ata zunë vend të madh tek pushtetarët. Në fillim të shekullit të tretë të hixhretit ata mundën ta bindin halifen abasit Memunin, që të besojë në bindjet e tyre dhe t'i përhapë ato me forcën e shpatës dhe detyrimit. Për këtë shkak u burgosën dhe u vranë shumë njerëz, derisa ai vdiq në vitin 218 hixhri.

Më pas vjen në pushtet El Mutesim dhe El Uathik, të cilët trashëguan bindjet e tij dhe vazhduan në rrugën e trazirave me përkrahjen dhe nxitjen e mutezilive. Në këtë fitne është treguar edhe qëndrimi i imam Ahmedit, i cili mbrojti të Vërtetën, duke duruar torturat në rrugën e saj.

Kjo trazirë vazhdoi deri në kohën e El Muteuekil, i cili e mori pushtetin në vitin 232 hixhri, ndërkohë që fitneja u ngrit dhe mori fund përfundimisht.

Ata shpikën fjalë të reja e të çuditshme, disa prej të cilave u bënë shkak për quajtjen mohues të njëri-tjetrit, apo edhe për quajtjen e tyre mohues prej të tjerëve, siç e ka përmendur El Bagdadi.

Po mjaftohemi me këtë vështrim të shpejtë dhe të përmbledhur të trajektores së shfaqjes së bidateve në mesin e popullit musliman, për të kaluar në diçka më të hollësishme, e cila ka lidhje direkte me trazirat dhe shkaqet e tyre në mesin e muslimanëve.

**kthehu lart**

\*\*\*

## Kapitulli i dytë

### **Koha e shfaqjes së trazirave (fitnes) - Lindja e tyre, përforcimi dhe fundi i tyre**

Janë përcjellë disa hadithe të cilat tregojnë fitnen e parë në këtë popull dhe nëse do të ishte shtypur që në fillim të shfaqjes së saj, nuk do të kishin ndodhur më trazira. Por ky është ligji i Allahut në krijim, nëpërmjet të cilit qartësohen shumë çështje të sheriatit, sidomos ato që kanë lidhje me shpirtin njerëzor dhe me ligjet shoqërore.



Transmetohet nga Ebu Bekrate se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kaloi pranë një burri i cili ishte duke bërë sexhde, ndërsa i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) po shkonte për në namaz. Pasi e kreu namazin, ai u kthye nga ai dhe e gjeti përsëri në sexhde. Atëherë i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Kush e vret këtë?”

Atëherë ngrihet një person, zgjat duart dhe nxjerr shpatën e tij, por pastaj dridhet dhe thotë: “O Lajmëtar i Allahut, më i shtrenjti tek unë, si mund të vras një njeri i cili është në sexhde dhe dëshmon se nuk meriton të adhurohet askush tjetër, përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij?!”

Pastaj ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Kush e vret këtë?”

Atëherë ngrihet një person tjetër dhe tha: “Unë”. Pastaj zgjati duart dhe nxjerri shpatën e tij, i dridhet dora dhe thotë:

“O Lajmëtar i Allahut, si mund të vras një njeri i cili është në sexhde dhe dëshmon se nuk meriton të adhurohet askush tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij?!”

Atëherë i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Për Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, sikur ta kishit vlarë atë, do të kishte qenë trazira (fitneja) e parë dhe e fundit!”

Në një transmetim tjetër të Ahmedit thuhet se këta burra kanë qënë Ebu Bekri, Umeri dhe në një shtesë tjetër edhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!), i cili shkon për ta vlarë atë burrin që falej, pasi dy të parët nuk mundën ta vrisnin, por ai nuk e gjen dhe kthehet, ndërsa i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Ky dhe shokët e tij e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre. Ata dalin nga feja, ashtu siç del shigjeta nga harku dhe pastaj nuk kthehen më në të, derisa të kthehet shigjeta në harkun e saj (prej të cilit doli). Vritini ata, sepse ata janë krijesat më të këqija!”

Ky hadith është i saktë me të gjitha rrugët e tij të transmetimit dhe nuk ka dyshim në të, por ai ka nevojë për meditim dhe kuptimin e tij. Hadithi tregon qartë se nëse do të vritej ai person, i cili është ai që kundërshtoi të Dërguarin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në çështjen e ndarjes së plaçkës së luftës kur tha: “Ti i ndave, por nuk i ke ndarë drejtë”, atëherë nuk do të kishte më kurrë trazira pas tij.

Ky hadith tregon lindjen dhe fillimin e trazirave në këtë popull, por kur është koha e shtrëngimit dhe shtimit të tyre? Këtë do ta shohim më poshtë:

I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka pasur për qëllim që ta paralajmërojë popullin e tij se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, prej trazirave dhe shkaqeve të tyre, në mënyrë që ata të kujdesen dhe të ruhen prej tyre.

Duhet të kemi parasysh se ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) nuk ka për qëllim sharjen e vendit apo të kohës, sepse trazirat e kohës së fundit (para Kiametit) do të shtohen dhe do të vërshojnë si dallgët e detit, gjë e cila fillon me vrasjen e Umer ibën el Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

Buhariu ka nxjerrë në Sahihun e tij, në kapitullin e kohëve të faljes, në kapitullin e zekatit, në kapitullin e agjërit, në kapitullin e trazirave etj.

Gjithashtu edhe Muslimi në kapitullin e trazirave me senedet e tyre nga Ebu Uail, vëllai i Ebu Selemes, i cili ka thënë: “Kam dëgjuar Hudhejfen të thotë: "Ndërsa ne ishim të ulur tek Umeri, ai tha: “Kush prej jush e ka ruajtur fjalën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për trazirat (fitnen)?

- Sprovën e burrit në familjen e tij (gruan), pasurinë e tij, fëmijën dhe në komshiun e tij e fshin falja (namazi) dhe lëmosha e tij si dhe urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

- Nuk po të pyes për këtë, por për trazirat që vërshojnë si dallgët e detit.

- Nuk ke pse të shqetësohesh për to, o prijësi i besimtarëve, sepse ndërmjet teje dhe tyre është një derë e mbyllur.

- A do të thyhet ajo derë apo do të hapet?

- Do të thyhet.

- Atëherë nuk do t'u mbyllka më kurrë.

- Po, ashtu është.

Ne i thamë Hudhejfes: - A e dinte Umeri se kush ishte ajo derë?

- Po, ashtu siç e di unë që me ditën e nesërme na ndan nata, sepse unë i tregova atij një hadith të vërtetë që nuk përmban gabime. - tha Hudhejfja

Ne donim ta pyesnim se kush ishte dera, kështu që i thamë Mesrukut që ta pyeste dhe ai e pyeti:

- Kush është ajo derë?

- Umeri, - u përgjigj Hudhejfja

Muslimi e ka nxjerrë gjithashtu këtë hadith në kapitullin e imanit nga Hudhejfe, duke thënë: "Ishim tek Umeri dhe ai na tha:

- Kush prej jush e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të flasë për trazirat?

- Ne e kemi dëgjuar, - u përgjigj dikush.

- Ndoshta keni për qëllim sprovën e burrit në familjen dhe komshiun e tij? - vazhdoi Umeri.

- Po.

- Atë e fshin namazi, agjërimi e lëmosha, por kush prej jush e ka dëgjuar të Dërguarin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të flasë për trazirat që vërshojnë si dallgët e detit?

Njerëzit heshtën. Unë, - tha Hudhejfja

- Ti! I Zotit qoftë babai yt (që bëri një si ti)!
  - Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! të thotë: "Trazirat lidhen me zemrat dhe lënë gjurmë në to, ashtu siç lë gjurmë rrogozi vija-vija kur fle me fytyrë mbi të. Çdo zemër që i fut brenda plotësisht dhe i pi ato (trazirat), shënohet në të një njollë e zezë dhe çdo zemër që i kthen mbrapsht ato, shënohet në të një pikë e bardhë. Pastaj ato (trazirat) do t'i ballafaqohen dy zemrave; një zemre të bardhë si guri i lëmuar, në të cilin nuk është ngjitur asgjë (për shkak të besimit të fortë dhe pastërtisë së tij nga të metat) dhe këtë zemër nuk e cënon asnjë trazirë sa të jenë qiejt dhe toka; si dhe (do t'i ballafaqohen) një zemre tjetër të zezë e të nxirë si një koçan misri i përmbysur, që nuk njeh të mirën dhe nuk ndalon nga e keqja, përveç asaj me të cilën ka mbushur zemrën prej dëshirave të tij." - tregoi Hudhejfja
  - Ndërmjet teje dhe tyre është një derë e mbyllur, e cila është afër thyerjes (ato nuk do të shfaqen sa të jesh ti gjallë).
  - A do të thyhet? A je i vetedijshëm për atë që thua? Sikur ajo të hapej, ndoshta edhe mund të mbyllej përsëri, - pyeti Umeri
  - Jo, ajo do të thyhet.
- Hudhejfe thotë se i tregoi atij një hadith të vërtetë dhe jo ndonjë përcjellje gabim të njerëzve, se kjo derë është një burrë i cili do të vritet ose do të vdesë.

Prej këtyre transmetimeve përfitojmë shumë dobi, nga më të rëndësishmet e të cilave janë:

\*\*\*

## Llojet e trazirave

Trazirat janë dy llojesh:

1. Sprova e burrit në familjen, pasurinë, fëmijët dhe komshiun e tij.

Kjo fitne nuk i ndahet njeriut në asnjë vend dhe në asnjë kohë. Ajo lidhet me dashurinë e tepërt, maninë, koprracinë dhe zhburrërinë, si dhe të preokupon nga kryerja e shumë veprave të tjera të mira.

Jeta e kësaj bote është e gjitha fitne dhe sprovë. Si e mira ashtu edhe e keqja e saj janë sprovë. Edhe dëshirat janë sprovë gjithashtu. Kjo është një sprovë që ka ekzistuar në të gjitha kohërat dhe i përfshin të gjithë bijtë e Ademit.

2. Trazirat që vërshojnë si dallgët e detit

Këto trazira janë përngjasuar me dallgët e detit, për shkak të madhësisë së tepërt dhe përhapjes së tyre. Ky lloj i trazirave forcohet dhe shtohet me kalimin e kohës, duke u ndezur në disa vende, sipas Ligjit të Allahut në zbritjen e dënimeve, duke qenë herë në formë furtunash e herë në formë katastrofash, tërmetesh apo vullkanesh, të cilat bien mbi të këqinjët dhe pastaj shtrihen deri tek shumica, te të mirët. Ato janë dënim dhe vuajtje për një grup njerëzish dhe mëshirë, mirësi e lartësim për disa të tjerë.

Përngjasimi i trazirave me dallgët e detit, të jep të kuptosh se janë të forta dhe të fuqishme, pastaj janë të njëpasnjëshme dhe se askush nuk mund të qëndrojë përball tyre, sepse askush nuk mund të qëndrojë përball dallgëve të detit. Lëvizja e njerëzve në kohën e këtyre trazirave do të çrregullohet, qetësia e tyre do të prishet, gjokset e tyre do të ngushtohen dhe fryma e tyre do t'iu mbahet, ashtu siç ndodh me atë që ndeshet me dallgët. Ne e dimë që dallgët e detit shtohen dhe rriten me shtimin e forcës së erës dhe përhapjen e reve, kështu që mund ta përfytyrojmë kohën e trazirave me një kohë të zymtë e të errët. Ai që vështrohet dallgën e detit të ngritur lart duke i shfaqur atij kaltërsinë e detit dhe sipër tij gjendet errësira e reve dhe madhësia e tyre, ndërkohë që era dhe furtuna është e fortë, ai ballafaqohet me këto trazira. Atë e rrethojnë errësitat dhe furtunat. Ai është i merakosur dhe i stresuar, nga jashtë dhe nga brenda vetes së tij. Dallgët kanë gjithashtu një zhurmë, por çfarë zhurme?! Edhe këto trazira kanë një zhurmë të atillë, që i ngrituri në atë kohë nuk dëgjon zhurmë tjetër, përveç zhurmës së tyre, por ajo e pushton atë sikur të ishte fryrja e ringjalljes në Ditën e Kiametit, në të cilën ai që ngrihet qëndron pezull, i frikësuar dhe i stresuar. Kërkon që të gjejë sigurinë, por nuk e gjen dot.

A mund të shpëtojë nga deti dhe dallgët e tij ndokush, përveç atij që qëndron larg tij? Ky është edhe vërtetimi i fjalës së të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i cili thotë:

"Njeriu më i mirë në atë ditë është ai besimtar i veçuar në një nga pronat e tij, i cili ruan devotshmërinë ndaj Allahut dhe i lë njerëzit të qetë nga sherri i tij."

Ajo që i përmbledh të gjitha rrjedhat e trazirave dhe ngjarjet e tyre është sprovimi dhe përgënjeshtrimi i atyre që pasojnë të parët e mirë të këtij populli në dije, përfytyrim dhe veprim, i atyre që sqarojnë të kuptuarit e tyre, i preokupojnë zemrat dhe i njësojnë qëllimet e tyre sipas rrugës së selefëve.

### **Fundi i trazirave**

Hadithi i mësipërm i dialogut të Hudhejfes me Umerin (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) të lë të kuptosh se sikur Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) të kishte vdekur jo me vrasje, atëherë do të ndizeshin trazira, por ato do të shuheshin dhe dera e tyre do të mbyllej. Ndërsa sikur ai të vritej, dera e trazirave do të qëndronte me të dyja kanatet të hapura dhe kështu ndodhi. Kjo tregon kohën e përfundimit të trazirave dhe dallgët e tyre, ndërsa fundi është përmendur në hadithin e transmetuar nga Enesi (Allahu qoftë i

kënaqur prej tij!) se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Sikur ai të vritej sot, nuk do të ishin kundërshtuar dy burra nga populli im, derisa të dalë Dexhali!"

Në një hadith tjetër të saktë thuhet se të gjitha trazirat janë gjendur për shkak të sprovës së Dexhalit, siç e ka nxjerrë Ahmedi, Bezari, Ibën Hibani dhe Taberani nga hadithi i Hudhejfes se ai ka thënë:

"Tek i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) u përmend Dexhali dhe ai tha: "Unë kam më shumë frikë trazirat tuaja me njëri-tjetrin, sesa sprovës e Dexhalit, sepse ai që do të shpëtojë nga ato trazira, do të shpëtojë edhe nga sprovat e tij. Nuk ka ndodhur ndonjë trazirë, që sa është krijuar kjo botë, as e vogël dhe as e madhe, vetëm se për sprovën e Dexhalit."

Kështu që, trazirat janë një varg, ku secila hallkë e tij është kapur me shoqen e saj, derisa të arrijë tek Dexhali. Ato janë frika që kishte për ne i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), trazirat duke luftuar, vlarë dhe duke i bërë padrejtësi njëri-tjetrit. Pikërisht, kjo gjë filloi në kohën e shfaqjes së havarixhëve, të cilët dolën nga ai burrë, i cili sikur të ishte vlarë, vrasja e tij do të kishte qenë trazira e parë dhe e fundit, siç ka thënë i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

\*\*\*

## Kapitulli i tretë

### Historia e shfaqjes së havarixhëve

Transmetohet nga Ebu Seidi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: "Ndërsa ne ishim tek i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ndërkohë ai po ndante plaçkën e luftës, aty erdhi Dhul Huwejsira, i cili ishte një burrë nga fisi beni temim dhe tha:

- Nda drejt, o i Dërguari i Allahut!
- Mjerë ti! Kush mund të gjykojë drejt, nëse nuk gjykoj drejt unë? Unë do të isha i dështuar dhe i humbur nëse nuk do të gjykoja drejt. - u përgjigj i Dërguari.
- A më lejon që t'ia heq kokën, o i Dërguari i Allahut? - ndërhyri Umeri.
- Lëre! Ai ka disa shokë, para namazit të të cilëve ju e përbuzni namazin tuaj dhe para agjërimit të tyre ju e përbuzni agjërimit tuaj. Ata e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre (nuk ngrihet tek Allahu, ose nuk punojnë me të). Ata dalin nga feja,

ashtu siç del shigjeta nga harku. Ai vështron majën e shigjetës së tij, por në të nuk ka gjë (nuk ka gjak), pastaj vështron në fundin e shigjetës, por në të nuk gjen gjë. Pastaj vështron tek shigjeta e prishur nga përdorimi i shumtë, por në të nuk gjen gjë, pastaj vështron tek penda e shigjetës së tij, por në të nuk ka gjë. Shigjeta e tij ka hyrë dhe ka dalë para se të vrrarit t'i dalë jashtëqitja dhe gjaku. (Ashtu si nuk përlyhet shigjeta e tyre me gjak, ashtu dalin edhe ata nga Islami, pa u ndikuar prej tij). Shenja e njohjes së tyre është një burrë i zi, njëri nga muskujt e krahëve të së cilit është si thitha e sisës së gruas, apo si një copë mishi që shfaqet e humbet. Ata dalin në atë kohë kur njerëzit përçahen me njëri-tjetrin. - tha i Dërguari i Allahut.

Ebu Seidi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) thotë: “Unë dëshmoj se këtë hadith e kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe dëshmoj se Ali ibën ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i luftoi, ndërkohë që unë isha me të.

Ai urdhëroi që t'i sillnin atë person dhe pasi u gjend, unë vështrova tek ai dhe ai ishte tamam ashtu siç e kishte përshkruar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).”

Transmetohet, gjithashtu, nga Ebu Seidi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: “Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dërgoi tek i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ca ar dhe ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ndau atë ndërmjet katër personave: El Akra ibën Habis, El Handhali el Muxhashi, Ujejne ibën Bedër el Fezari, Zejd et Tai, i cili u bë më pas një nga fisi beni nebuhan dhe Alkame ibën Ulathe el Amiri, i cili më pas u bë një nga ata të fisit beni kilab.”

Por kurejshët dhe ensarët u mërzitën dhe thanë: “Ai i jep fisnikëve prej banorëve të Nexhdit dhe na lë neve!”

Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Unë desha t'i afroj ata.”

Pastaj erdhi një njeri me sy të futur thellë, me fytyrë të nxjerrë përpara, me ballë të dalë, me mjekërr të dendur dhe me kokë të rruajtur. Ai tha: ‘Ki frikë Allahun, o Muhamed!’

Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Kush i bindet Allahut, nëse e kundërshtoj unë? Ai më ka besuar për njerëzit e tokës, ndërsa ju nuk më besoni?!”

Një burrë i kërkoi që t'i japë leje për ta vrrarë, më duket se ishte Halid ibën el Uelid, por ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ndaloi atë.

Kur ai person u largua, ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: “Në origjinën, apo në pasardhësit e këtij janë disa njerëz të cilët e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre (nuk ngrihet tek Allahu, apo nuk veprojnë sipas tij). Ata dalin nga feja si

dalja e shigjetës nga harku. Vrasin muslimanët dhe lënë idhujtarët. Sikur unë t'i arrij ata, do t'i vrasë si vrasja e popullit të Adit."

Të dy këto hadithe janë muttefekun alejhima.

Kjo ishte shfaqja e parë e tyre, apo shfaqja e kokës së tyre. Më pas ata u shfaqën për të formuar një grup të konsiderueshëm pas vrasjes së Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në Irak. Ibën Kethiri kur përmend historinë e daljes së tyre në librin "El bidaje uen nihaje", thotë:

"Këta lloj njerëzish janë nga speciet më të çuditshme të bijëve të Ademit. I Lartësuar është Ai që i ka bërë të shumëllojshme krijesat e Tij, ashtu si Ai do dhe si është shkruar në Caktimin e Tij të hershëm. Nuk ka fjalë më të mirë se ajo që kanë thënë selefët për hauarixhët se ata janë për qëllim në Fjalën e Allahut: **"Thuaj: A t'ju njoftojmë juve me humbësit më të mëdhenj të veprave të tyre? Ata të cilëve u ka shkuar mundi kot në jetën e dynjasë, duke menduar se po përfitonin mirësi nga veprat e tyre! Ata janë ata të cilët i mohojnë ajetet e Zotit të tyre dhe takimin me Të, kështu që veprat e tyre janë të kota dhe nuk do t'iu sjellin dobi dhe në Ditën e Kijametit, Ne nuk do t'u japim peshë atyre."** [El Kehf: 103-105].

Këta injorantë janë të humbur, të prishur në fjalë e vepra. Mendimi i tyre u bashkua për të dalë kundra grupit të muslimanëve. Ata bashkëpunuan në fshehtësi që të dilnin nëpër qytetet e muslimanëve dhe t'i sundonin ato, të ruheshin pas mureve të tyre dhe të thërrisnin vëllezërit dhe shokët e tyre që të bashkohen me ta. Ata të cilët janë në të njëjtin mendim dhe në të njëjtën rrugë me ta, prej banorëve të Basras e të qyteteve të tjera, kishin bërë plane që bashkimi i tyre të bëhej në të (në Basra).

Zejd ibën Husajn et Tai u tha atyre: "Ju nuk mund t'i merrni qytetet (Basran), sepse në to është një ushtri e madhe të cilës nuk i bëni dot ballë, por lini takim me vëllezërit tuaj në urën e lumit Xhuha dhe mos dilni nga Kufa në grupe, por dilni një nga një, me qëllim që të mos bini në sy!"

Atëherë ata shkruan një letër të përgjithshme, për të gjithë ata që ishin në rrugën dhe drejtimin e tyre prej banorëve të Basras dhe vendeve të tjera, që të takoheshin me ta te lumi dhe të bëheshin një dorë e vetme kundra njerëzve. Pastaj dolën një nga një pa marrë vesh askush prej tyre. Ata dolën nga mesi i baballarëve, nënave, dajëve e tezeve dhe u ndanë prej të gjithë të afërmëve të tyre, duke besuar me atë injorancën e tyre dhe mangësinë e dijes dhe mendjes së tyre, se kjo gjë e kënaq Zotin e tokës e të qiejve. Por ata nuk e dinin se ai ishte prej gjynaheve më të mëdha, gjynaheve shkatërruese, prej gabimeve më të mëdha dhe prej zbukurimit të Iblisit, shejtanit të mallkuar, i cili është përzënë nga qiejt dhe që i ka shpallur armiqësinë babait tonë Ademit dhe më pas pasardhësve të tij për sa ta kenë shpirtin në trupa.

Ne lusim Allahun që të na ruajë prej tij me Fuqinë e Tij, Ai është Plotësuesi i lutjeve."



Më poshtë po paraqesim një fragment tjetër të daljes së tyre dhe se si i shtypi ata ushtria e muslimanëve.

Transmetohet nga Zejd ibën Uehbi se ai ishte në ushtrinë e atyre që ishin me prijësin e besimtarëve, Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), të cilët shkuan tek huarixhët. Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) tha: “O Njerëz! Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të thotë: “Nga populli im do të dalin disa njerëz të cilët do ta lexojnë Kuranin dhe leximi juaj para leximit të tyre nuk është asgjë, as namazi juaj nuk do të jetë gjë para namazit të tyre dhe as agjërimi juaj nuk do të jetë gjë para agjërit të tyre! Ata e lexojnë Kuranin dhe mendojnë se ai është për ta (për t'u shpërblyer me të), por ai është kundër tyre. Namazi i tyre nuk i kalon klavikulat e tyre. Ata dalin nga Islami ashtu siç del shigjeta nga harku. Sikur ushtria që do t'i luftonte ata ta dinte se ç'është premtuar për ta nga gjuha e të Dërguarit të tyre, ata do t'i kishin lënë të gjitha punët e tjera. Shenja e kësaj është se në mesin e tyre është një burrë me muskuj dhe pa parakrahë. Në muskulin e tij ka një si thitha e gjoksit mbi të cilën ka disa qime të bardha.

A do të shkoni tek Muauija dhe banorët e Shamit, ndërsa këta t'i lini pas tek familjet dhe pasuritë tuaja?! Për Allahun, unë mendoj se këta janë ata që duhet të luftojmë, sepse ata kanë derdhur gjakun e ndaluar dhe kanë sulmuar pasurinë e njerëzve, të cilën e kanë fituar me mund e djersë! Shkoni me Emrin e Allahut!”

Seleme ibën Kuhejl tregon: “Zejd ibën Uehbiu më tregoi shumë gjëra, derisa tha: “Kaluam pranë një kupole dhe aty u ndeshëm me huarixhët. Ata kishin prijës të tyre Abd ibën Uehbi er Rasibi, i cili u tha atyre: “Hidhini shtizat dhe futini shpatat në këllëfet e tyre! Unë kam frikë se do të bëjnë be, ashtu siç bënë në ditën e Harurasë.”

Ata i hodhën shtizat e tyre, i futën shpatat dhe njerëzit i ngacmuan me shtizat e tyre.

Disa prej tyre u vranë njëri mbi tjetrin, ndërsa nga ushtria e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) nuk u vranë atë ditë veçse dy prej tyre. Prijësi i besimtarëve, Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) tha: “Kërkoni në mesin e tyre atë të mangëtin (pa duar).” Ata kërkuan por nuk e gjetëm. Atëherë Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) u ngrit vetë që ta kërkonte, derisa mbërriti tek disa njerëz që ishin vranë njëri mbi tjetrin dhe tha: “Hiqini ata nga njëri-tjetri! E gjeti atë të fundit në tokë (poshtë të gjithëve) dhe madhëroi Allahun, pastaj tha: “Allahu ka thënë të Vërtetën dhe i Dërguari i Tij e komunikoi atë.”

Ubejde es Selmani shkoi tek ai dhe i tha: “O prijësi i besimtarëve, betohu për Zotin që është Një dhe i Pashok, a e ke dëgjuar këtë hadith nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)?”

Ai tha: “Po, për Zotin që është Një dhe i Pashok!”

Këtë betim ia kërkoi tre herë dhe ai i betohej atij."

Transmeton Ahmedin dhe Muslimi.

### **Vrasja e prijësit të besimtarëve, Ali ibën Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)**

Ibën Xherir et Taberi dhe dijetarë të tjerë të historisë kanë përmendur se tre prej hauarixhëve: Abdurrahman ibën Amër, i njohur si Ibën Mulxhim el Humejri Senani, aleat i fisit beni hanife nga Egjipti, esmer, me fytyrë të bukur dhe në ballin e tij dalloheshin gjurmët e sexhdes.

I dyti ishte El Berk ibën Abdullah et Temimi, ndërsa i treti ishte Amër ibën Bekër et Temimi.

Këta të tre u bashkuan dhe po kujtonin vrasjen e vëllezërve të tyre në Nehrauan nga Aliu dhe i kërkonin Allahut falje e mëshirë për ta.

Pastaj thanë: "Ç'na duhet më qëndrimi në këtë jetë pas vdekjes së tyre, ndërsa ata ishin që nuk kishin frikë në fenë e Allahut asgjë. Si thoni sikur t'i shesim vetet tona për Allahun dhe të vrasim kokat e rrugës së humbur, kështu lirojmë vendet prej tyre dhe marrim hak për vëllezërit tanë."

Ibën Mulxhim tha: "Unë iu siguroj vrasjen e Ali ibën ebi Talibit."

El Berak tha: "Unë ju siguroj Muauijen."

Amër ibën Bekër tha: "Ndërsa unë iu siguroj Amër ibën el Asin." Pastaj i dhanë besën njëri-tjetrit që nuk do t'i ndaheshin atij që kishin marrë përsipër vrasjen e tij, derisa ta vrisnin, ose të vriteshin duke luftuar me të.

Atëherë morën shpatat e tyre dhe i helmuan, pastaj ranë dakord që secili prej tyre duhet të gjendej në vendin e objektivit të tij në natën e shtatëmbëdhjetë të Ramazanit.

Ebu Mulxhim u nis për në Kufa dhe e fshehu qëllimin e tij edhe nga shokët e tij prej hauarixhëve që gjendeshin atje. Ndërsa ai ishte ulur me disa njerëz nga fisi beni rabab dhe po kujtonin të vrarët e tyre në Nahrauan, aty vjen një grua prej fisit të tyre, të cilën e quanin Kutam bintu Shexhne e cila ishte shumë e bukur dhe e njohur për bukurinë e saj. Asaj i kishte vrarë Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në ditën e Nahrauanit babanë dhe vëllanë. Ajo ishte veçuar nga njerëzit dhe qëndronte në xhaminë kryesore për të

adhuruar Allahun në të. Kur Ibën Mulxhimi e pa atë, atij iu prish mendja dhe e harroi misionin për të cilin gjendej aty. Ai shkoi t'i kërkojë dorën asaj, por ajo i vuri atij kusht që t'i jepte asaj tre mijë dirhem, një shërbëtor, një shërbëtore dhe që të vriste për të Ali ibën ebi Talib.

Ai tha: "Ai është i yti (do ta vras) dhe për Allahun, nuk më ka sjellë në këtë vend, veçse vrasja e Aliut. Pastaj u martua me të dhe ajo filloi ta nxiste për misionin e tij. Për këtë gjë ajo i dha atij në shërbim një burrë prej fisit të saj, të cilin e quanin Uirdan. Ibën Mulxhimi mori edhe një burrë tjetër, të cilin e quanin Shebib ibën Nexhde el Eshxhei, i cili tha:

- A dëshiron që të arrish nderin në këtë botë dhe në botën tjetër?
- E si mund ta arrijë këtë?
- Duke vrarë Aliun.
- Të humbtë nëna, e si mund ta bëjmë një gjë të tillë?
- Të fshihemi në xhaminë e tij dhe kur ai të dalë për t'u falur në namazin e sabahut, atëherë i hidhemi dhe e vrasim. Nëse shpëtojmë pas kësaj, atëherë kemi qetësuar shpirtin tonë dhe kemi marrë hakun tonë dhe nëse vritemi, atëherë ajo që është tek Allahu është më e mirë se kjo dynja!
- Ç'thua? Si mund ta bëjmë një gjë të tillë kur dihet që Aliu ka hyrë herët në Islam dhe ai është i afërm i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)
- kështu që unë nuk shoh se më qetësohet shpirti me vrasjen e tij."
- A nuk e di se ai ka vrarë shokët tanë në Nahrauan?
- Po, e di.
- Atëherë ta vrasim për shkak se ai ka vrarë ata.
- Atëherë ai ra dakord.

Hyri muaji i Ramazanit dhe Ibën Mulxhim la takim me ta të xhumanë, në natën e shtatëmbëdhjetë të Ramazanit dhe tha: "Kjo është nata në të cilën u kam dhënë besën shokëve të mi, të cilët do të marrin hak ndaj Muauijes dhe Amër ibën el Asit.

Këta të tre: Ibën Mulxhimi, Uirdani dhe Shebib, hynë në xhami me shpatat të fshehura dhe u ulën përballë derës nga e cila dilte Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Kur ai doli, filloi të zgjonte njerëzit për namaz, duke thënë: "Namazi, namazi!"

Atëherë Shebib i vërsulet dhe e godet me shpatë, por ajo nuk e kapi dhe goditi atë në harkun e tij. Pastaj e godet Ibën Mulxhimi me shpatë në ballë dhe gjaku i rrodhi në mjekrrën e tij (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Kur e goditi Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), ai tha: "Gjykimi nuk i takon askujt tjetër, përveç Allahut dhe nuk të takon ty, o Ali dhe as shokëve të tu!" Pastaj filloi të lexojë Fjalën e Allahut: **"Dhe ka prej njerëzve që e shesin veten e tyre për të kërkuar Kënaqësinë e Allahut dhe Allahu është i Mëshirshëm me robërit e Tij."**

Aliu tha: "Kapeni atë!"

Ndërsa Uirdani ia mbathi, por atë e zuri një burrë nga Hadrameuti dhe e vrau. Ndërsa Shebib iku dhe u shpëtoi njerëzve. Ndërsa Ibën Mulxhimi u kap. Atëherë Aliu vuri Xheade ibën Hubejra ibën ebi Uehbi, si imam të njerëzve për namazin e sabahut, ndërsa atë e çuan në shtëpi.

Më pas i shpunë atij Ibën Mulxhimin, i cili qëndroi i lidhur para tij, Allahu e fëlliqtë!

Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i tha atij:

- O armik i Allahut, a nuk të kam bërë mirë ty?

- Po, - u përgjigj ai.

- Atëherë ç'të shtyu që ta bësh këtë?

- Unë e futa shpatën për dyzetë ditë në helm dhe i kërkova Allahut që të vriste me të krijesën më të keqe të Tij.

- Nuk shoh ndryshe, vetëm se të vritesh me atë shpatë dhe nuk të shoh ty, veçse krijesën më të keqe të Allahut. Nëse unë vdes, vriteni atë dhe nëse rroj, e di unë se ç'do të bëj me të. - tha Aliu.

Xhundub ibën Abdullah tha:

- O prijës i besimtarëve, nëse ti vdes, a t'ia japim besën Hasenit?

- Unë as nuk ju urdhëroj, as nuk ju ndaloj. Ju e dini më mirë çështjen tuaj, - u përgjigj Aliu.

Kur po i dilte shpirti, ai (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) filloi të thoshte: "La ilahe il-lallah" dhe asgjë tjetër. Gjithashtu, thuhet se fjala e fundit që ai tha ishte: **"Kush vepron një të mirë sa grimca, ai do ta shohë atë dhe kush vepron një të keqe sa grimca, ai do ta shohë atë."**

Ai la amanetet e tij kur në kokën e tij ishte Hasani dhe Husejni (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!), të cilët i porositi që të kenë frikë Allahun, të falin namazin, të japin zekatin, të mbajnë hidhërimin, të mbajnë lidhjet e gjakut, të sigurohen në çështjet e fesë dhe t'i kthejnë ato tek Kurani dhe Suneti si dhe këshilla të tjera.

Kjo histori tregon qartë injorancën dhe mendjelehtësinë e tyre, ashtu siç thoshte Ibën Kethiri më sipër. Prandaj të të mos gënjejë aparenca dhe devotshmëria sipërfaqësore e tyre! Por shtrëngohu për xhematin e muslimanëve sipas rrugës së të parëve të këtij populli!

### **Vazhdueshmëria e daljes së hauarixhëve dhe arritja e fitnes së tyre në çdo vend**

Ky ishte fillimi i shtrëngimit të trazirave dhe dallgëve që u përngjet dallgëve të detit, sepse fitneja e tyre arriti në çdo vend, gjurmët e tyre kanë ngelur deri sot, gjë të cilën e argumenton realiteti të cilin e shohim me sytë tanë në shumë vende. Dhe kjo do të shtohet edhe më tepër me kalimin e kohës, por neve na mjafton Allahu dhe tek Ai mbështetemi.

Argumenti dhe prova për këto fjalë është si më poshtë:

Transmeton Nesai dhe të tjerë nga hadithi i Ebu Berze, se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Në fund të kohës do të dalin disa njerëz, sikur ky të ishte prej tyre. Ata e lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre. Ata dalin nga Islami ashtu siç del shigjeta nga harku."

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka treguar në këtë hadith dhe në hadithe të tjera, se ata do të vazhdojnë të dalin deri në kohën e Dexhalit dhe muslimanët janë në një fjalë se haurixhët nuk kanë qenë vetëm në atë brez."

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) bën shenjë në hadithin që transmeton Ibën Maxheh e të tjerë me sened sahih, nga Ibën Umer (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) se ka thënë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të thotë: "Do të lind një grup njerëzish të cilët do ta lexojnë Kuranin, por ai nuk i kalon gurmazet e tyre. Sa herë që del një grup prej tyre, ai pritët (shuhet), derisa në mesin e tyre të dalë Dexhali."

Ndërsa shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) e ka quajtur kështu një nga temat e librit "Es silsiletu es sahiha": "Vazhdueshmëria e daljes së haurixhëve".

Kështu, prej Ligjit të Allahut, i cili nuk ndryshon kurrë, për haurixhët dhe ata që ndjekin rrugën e tyre për ndryshimin e gjendjes së muslimanëve sot, është se këta shfaqen kohë pas kohe, por shumë shpejt ata shuhën dhe priten. Prerja e tyre bëhet me argumente e prova të qarta nga ana e dijetarëve, ose me kërcënim e frikësim nga ana e qeverisë, ose me të dyja bashkë, apo me atë që e ka caktuar Allahu në rregullin e Tij ndërkosmik (të krijimit).

Imam Uehbi ibën Munebih, në këshillën e tij drejtuar Ebu Shemir Dhi Haulan, ndër të tjera thotë:

"A nuk e sheh, o Dhu Haulan, se unë e arrita brezin e parë të Islamit, për Allahun, haurixhët nuk kanë pasur kurrë grup të tyrin, vetëm se Allahu e ka shpërndarë atë në mënyrën më të keqe për ta. Nuk kishte njeri prej tyre që ta shfaqte idenë e tij, vetëm se Allahu ia printe kokën. Asnjëherë nuk është bashkuar populli nën udhëheqjen e haurixhëve dhe nëse Allahu do t'i mundësonte ata që t'ua impononin idenë e tyre njerëzve, atëherë toka do të prishej, rrugët e furnizimit do të bllokoheshin, vizita e Shtëpisë së Shenjtë të Allahut do të ndalej. Atëherë çështja e Islamit do të kthehej në injorancë, saqë njerëzit do t'i drejtoheshin maleve për t'u mbrojtur, ashtu siç bënin në kohën e injorancës. Atëherë do të ngriheshin më shumë se dhjetë, apo njëzetë burra prej tyre dhe do të kërkojnë pushtetin për veten e tyre. Çdonjëri prej tyre do të kishte nga pas dhjetëmijë njerëz dhe do të luftonin njëri-tjetrin..."

El Bagdadi në librin e tij "El Ferkul bejnel firak" thotë:

"Atë ditë u vranë hauarixhët (ditën e nahravanit) dhe nuk shpëtuan prej tyre vetëm se nëntë vetë. Dy prej tyre shkuan në Sixhistan dhe prej pasuesve të tyre janë hauarixhët e Sixhistanit, dy të tjerë shkuan në Jemen dhe prej pasuesëve të tyre janë ibaditë e Jemenit, dy të tjerë shkuan në Uman dhe prej pasuesve të tyre janë hauarixhët e Umanit, dy të tjerë shkuan në drejtim të Xheziras (një zonë në Gadishullin Arabik) dhe pasuesit e tyre janë hauarixhët e Xheziras, ndërsa njëri prej tyre shkoi në Telmurun.

Më pas dolën kundra Aliut një grup prej hauarixhëve, të cilët ishin ende me idenë e atij gjykimi të parë. Prej tyre ishte Eshras ibën Aufi, i cili doli me ushtri në El Enbar. Pas tij doli et Tejmi nga Tejm Adij, i cili doli në Masidhan. Gjithashtu, ngriti krye edhe El Eshheb ibën Bishr el Areni, i cili doli në Xhurxharaja, Sead ibën Kafl ngriti krye në El Medain, Ebu Merjem es Seadi ngriti krye në tokat e Kufas.

Atëherë Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dërgoi nga një ushtri tek secili prej tyre dhe në secilën ushtri caktoi nga një komandant. Ata i shtypën të gjithë ata hauarixhë dhe po në atë vit u vra edhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në muajin Ramazan, në vitin tridhjetë e tetë të hixhretit."

Grupi i tyre u shfaq në shumë vende, ndërsa Iraku ishte foleja e tyre. Ushtria e tyre u ngrit kundra Muauijes në Kufa në vitin 41 h. Pas saj ata u ngritën në kryengritje të shumta ndërmjet viteve 41-64 h. Por udhëheqësit emevit mbajtën qëndrim të ashpër kundra tyre.

Disa bashkëkohorë thonë për vendet në të cilat gjenden hauarixhë në ditët e sotme: "Hauarixhët humbën dhe u shkrinë, përveç një grupi prej ibadive, të cilët jetojnë në Uman, në ishullin Xherbe në Tunis dhe në jug të Algjerisë."

\*\*\*

## Kapitulli i katërt

### Gjendja e muslimanëve në kohën e sotme

#### Dukuria e hauarixhëve në kohën tonë

Ky ishte një vështrim i shpejtë në historinë e hauarixhëve, por i mjaftueshëm për të marrë prej tij mësimet e duhura.

Tani të hedhim një vështrim në dukurinë e ngritjes krye kundër pushtetarëve në kohën tonë, sepse për shkak të saj janë derdhur gjakra dhe janë marrë jetë të pafajshme nën

parrullën e xhihadit dhe të luftës në Rugën e Allahut. Kjo dukuri ka shkaqet dhe motivet e saj dhe është shumë e ndërlikuar, por me anë të saj shfaqet saktësia e rrugës në të cilën janë dijetarët e mëdhenj edukatorë të popullit dhe imamët e sunetit, të cilët e kanë lënë ngritjen kundra pushtetarëve. Kjo, sepse ndryshimi i gjendjes së muslimanëve dhe rregullimi i saj nuk lidhet me posedimin e fuqisë apo me grupin i cili është i mundshëm të ngrihet në kryengritje, as me studimin legjislativ për të nxjerrë lejimin e daljes kundra pushtetarëve, apo për obligueshmërinë a ndalimin e saj, por ajo lidhet me diçka tjetër më të rëndësishme se të gjitha këto e cila është shpërbërja e shoqërisë islame, shfaqja e partishmërisë së kohës së injorancës në mesin e tij. Gjykimi sipas të dyshimtave dhe dëshirave në mesin e muslimanëve dhe largimi nga ligjet e fesë së tyre të pastër në bindje e vepra, aq larg saqë i bënë ata në veten e tyre më të pavlerë, sesa vendosmëria e tyre për t'u përpjekur për heqjen e dukurive të këqia e të prishura dhe për ngritjen e drejtësisë. I bënë ata më me pak vend te Zoti i tyre, sesa të meritojnë nderimin hyjnor për gjykimin me sheriatin islam, i cili është baza e sigurisë dhe qetësisë së njerëzve, si dhe shkaku i të mirave e rehatisë.

**"Kështu, Ne i bëjmë zullumqarët ndihmues të njëri-tjetrit (në krime), për shkak të asaj që ata vetë fituan."** [El En'am: 129].

**"Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata vetë të ndryshojnë vetveten e tyre. Kur Allahu do ndëshkimin e një populli, nuk ka më kthim mbrapa të atij ndëshkimi dhe ata nuk do të gjejnë përveç Tij mbrojtës tjetër."** [Errad: 11].

Saktësia e këtij qëndrimi të dijetarëve vërehet nëpërmjet veçorive të së Vërtetës, e cila nuk shpëtohet nga ai qëndrim, nëpërmjet qëndrueshmërisë së tyre në të, mbushjes së gjokseve të tyre, rrugës së gjatë dhe shfaqjes së fryteve të tyre. Allahu e mëshiroftë Ibën Hazmin i cili tha: "Çelja e fitnes nuk lulëzon kurrë."

Kjo do të thotë se fitneja (trazirat, sprovat) ka një paraqitje mashtruese në fillim të çeljes së saj dhe njerëzve mund t'iu duket e mirë, kështu që, lidhin shpresat tek ajo, por shumë shpejt ajo vyshket dhe shkrihet, ashtu si lulja që vyshket para se të hapë petalet dhe të lulëzojë.

Kjo thënie e shkurtër është një urtësi e madhe nga prodhimi i mendjes së Ibën Hazmit (Allahu e mëshiroftë!), i cili jetoi fitnen e berberëve në Andaluzi dhe pa me sytë e tij sesi njerëzit shkonin pas çdo kryengritje ari dhe pas çdo fitneje të re, duke pasur shpresa të mëdha se do të ndryshonin gjendjen e tyre dhe do të rregulloheshin, por shumë shpejt ato shpresa ktheheshin në tragjedi e hidhërim, në viktima e shkatërrim.

Kjo fjalë e tij i përshtatet çdo kohe dhe vendi, kështu që ne, bijtë e kësaj kohe, duhet të jemi më shumë të vëmendshëm në domethënien e saj, sepse ne jetojmë në një kohë në të cilën është pakësuar dija dhe është shtuar injoranca, fundërrimat kanë ngritur kryet përpjetë dhe nëpër shpirtra sundojnë lëkundjet dhe dëshirat e pasioneve."



\*\*\*

Shfaqja e huruxhit të ri dhe çelja e tij, e cila nuk ka lulëzuar dhe nuk do të lulëzojë kurrë. Prej saj është fitneja e Xhuhejmanit dhe Haremit të Mekës

Huruxhi i ri, është shfaqur në shumë vende dhe kohë të ndryshme dhe jo vetëm që nuk ka lulëzuar, por pasuesit e tij kanë prishur shumë në mesin e muslimanëve për shkak të mosnjohjes së tyre "obligueshmërinë e kohës". Nga shembujt më të qartë për "çeljen e fitnes" e cila "nuk ka lulëzuar" në shekullin e sapo kaluar është:

### **Fitneja e Xhuhejmanit dhe Haremit të Mekës**

Fitneja e Xhuhejman ibën Muhamed ibën Sejf el Atibi në Haremin e Mekës, filloi në kohën e namazit të drekës së të martës së parë të muajit muharrem dhe përfundoi në kohën e ikindisë së ditës së enjte, në shtatëmbëdhjetë muharrem të vitit 1400 h. (gjatë kësaj kohe nuk është thirrur ezani në minaret e Kabes për 82 herë).

Shkaku i saj paraprak ishte bindja e një grupi njerëzish të bazuar në ëndërra, duke i përdorur e komentuar hadithet që flasin për fitnet në një formë të gabuar. Ata besonin se një burrë prej tyre, të cilin e quanin Muhamed ibën Abdullah el Kahtani, ishte "Mehdiu i pritur". Kështu, ata hynë në mesxhid el haram (në Kabe) dhe derdhën gjak në të, pastaj u thanë njerëzve se në aksham, toka do të fundoset bashkë me ushtrinë që do të vijë të na luftojë neve.

Sigurisht, toka nuk u fundos, kështu që ata u thanë njerëzve se kjo çështje është shtyrë për katër ditë të tjera dhe kështu me radhë. Lufta vazhdoi afërsisht njëzetë ditë (ndërmjet tyre dhe ushtrisë së Saudisë). Në atë luftë u vranë prej ushtrisë që i luftoi ata 12 oficerë dhe 115 ushtarakë e ushtarë. Nëpër spitale u dërguan 49 oficerë dhe 402 ushtarakë e ushtarë.

Vendimi me pushkatim u zbatua mbi 63 vetë prej këtyre tiranëve të Haremit të Mekës. Gjatë pastrimit të Haremit u gjetën 15 kufoma prej atij grupi, të cilët u identifikuan nga shokët e tyre të kapur rob. Thuhet se 27 persona prej tyre vdiqën për shkak të plagëve të marra dhe se dënimi i tyre me vrasje u lehtësua me heqje lirie për periudha kohore të ndryshme, për 19 persona prej tyre. Numri i grave dhe fëmijëve, të cilët u gjendën me ta arriti në 23, ndërsa për 38 persona të tjerë nuk u bë i mundur vërtetimi nëse ishin apo jo bashkëpunëtorë me ta, kështu që i lëshuan.

Shkaku i kësaj fitneje të madhe brenda Tokës së Shenjtë të Mekës, ishte moskuptimi dhe mosnjohja e zbritjes së haditheve, të cilat flasin për fitnet në të tashmen dhe kohën në të cilën jetojmë, megjithëse, disa koka të bashkëpunëtorëve në këtë fitne kanë pasur njohuri

rreth hadithit dhe kuptimin e rëndësisë së të qëndruarit në hadithet e sakta si dhe lënien e haditheve të shpikura e të dobta. Organizata e dijetarëve të mëdhenj të asaj periudhe, në mbledhjen e tyre të pesëmbëdhjetë, i quajti ata si "një grup i humbur dhe kriminel, për shkak të agresionit të tyre në Haremin e Allahut, derdhjes së gjakut të ndaluar, veprimin e diçkaje që shkakton përçarjen e muslimanëve dhe dobësimin e fuqisë së tyre.

Ndërsa thirrjen e këtij grupi ata e quajtën: "Thirrja e tyre është fara e një fitneje dhe qorrrokaku. Ajo është rrugë për rrënujë e çrregullime, për të luajtur me fatet (interesat) e njerëzve e të vendeve. Thirrja e tyre mund ta mashtrojë me sipërfaqësoren e saj atë të padjallëzuarin, ndërsa brenda saj gjendet e keqja që përhapet."

Ata (Allahu ua shpërbleftë me të mira!) i paralajmëruan muslimanët për përmbajtjen e atyre shkrimeve me komentime të kota, dilema që përmbajnë gjynah dhe drejtime të këqija."

Vlen të përmendim këtu disa çështje të rëndësishme:

Së pari: Lidhja e kësaj fitneje me Irakun dhe kjo qartësohet nëpërmjet një hipoteze: A është ky grup prej hauarixhëve? Nëse ata janë të tillë, atëherë ajo fitne është prej ngatërresave që kanë ardhur nga atje dhe që kanë dalë nga origjina e atij personi, i cili sikur të ishte vlarë, njerëzit do të kishin rënë rehat nga sherri i tij, atëherë ai grup është një grup i keq, prej të këqijve.

Së dyti: Xhuhejmani ka mohuar në shumë prej shkresave të tij që ata të jenë prej hauarixhëve. Ai thoshte se disa dijetarë e nxënës të dijes, të cilët ishin vënë në poste të larta, u ishin dhënë grada dhe që paguhen, ua mvëshën atyre këtë emërtim (hauarixh).

Ai bën dallim ndërmjet "hauarixhit" dhe "atij që del si tiran kundra pushtetarëve" duke thënë: "Medh'hebi i hauarixhëve është kufër, ndërsa dalja kundër imamet dhe kërkimi i rrëzimit të tij është padrejtësi, në të cilën duhet të ndëshkohet dhe vlarë ai i cili ngrihet kundra tij."

Nisur që këtu, ai thoshte për veten dhe grupin që e pasonte në lidhje me dijetarët e kohës së tij:

"Nëse ti i kundërshton, ata të vrasin, për shkak të disa dilemave me të cilat i mbyllin gojën lepurit (frikacakut), duke i thënë: "Ti je "harixhij" megjithëse lepur i tyre nuk e di se çdo të thotë "harixhij".

Por ty mos të mashtrojë ky dallim që ai ka bërë, sepse ajo është një lojë fjalësh në të cilën nuk ka llojshmëri në të. Hauarixhët, sipas mendimit të dijetarëve, nuk janë josbesimtarë, por dukuria më e shfaqur tek ata është nxjerrja e njerëzve nga Islami për shkak të gjynahut të madh, si dhe dalja e tyre kundër pushtetarëve.

Ndërsa këta përputhen me ta në pikën e dytë, le të shohim se ç'thotë ai në fund të letrës së tij "Qeverisja dhe Besa", ku quan të dobët një hadith të cilin e ka nxjerrë Muslimi në Sahihun e tij, ku thuhet: "Prijësit tuaj më të mirë janë ata të cilët i doni dhe ju duan."

Ai thotë: "E zëmë se ai hadith është i saktë, megjithatë këta pushtetarë nuk kanë prova në të, sepse ai thotë: "Prijësit tuaj", d.m.th. prijësit e muslimanëve, ndërsa këta pushtetarë nuk janë prijës, sepse pushteti i tyre mbi muslimanët nuk është i saktë, por është diçka e keqe, e cila duhet hequr, siç e provuam këtë me argumentet e mësipërme, sepse ata nuk janë prej kurejshëve, nuk e zbatojnë fenë dhe nuk janë bashkuar rreth tyre muslimanët. Ata janë pushtetarë, të cilët i kanë detyruar muslimanët që të plotësojnë interesat e tyre, madje ata e kanë marrë fenë si mjet për të arritur interesat e tyre të kësaj dynjaje. Ata e anuluan xhihadin, u miqësuan me të krishterët dhe u shkaktuan muslimanëve të gjitha të këqiat dhe prishjet."

Kjo tregon se ai takohet me hauarixhët në idetë e tij për pushtetarët, siç është domosdoshmëria e ngritjes kundër tyre dhe pretendimi se ata nuk janë prijës të muslimanëve. Ai e pohon hapur këtë gjë në një fletëpalosje, e cila është botuar me titull "Këshilla e vëllezërve për muslimanët dhe pushtetarët".

Shejh Abdul Muhsin el Abikan ka thënë fjalë me vend kur ka folur për hauarixhët, duke përmendur ngjarjen e Haremit të Mekës shkurtimisht:

"Këta që dolën (me Xhuhejmanin në ngjarjen e Haremit), pretendonin se ishin dijetarë të hadithit, por ata janë të humbur dhe jo ashtu siç thanë. Ata flasin nga fjalët e krijesave më të mira dhe pretendojnë se janë prej pasuesve të hadithit dhe të kapur për sunetin, por nuk është ashtu. Ata nuk e kuptojnë hadithin e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), pastaj ata janë të vegjël në moshë, gjë të cilën e di çdokush që e ka arritur atë ngjarje. Ata kanë ëndërra qesharake dhe shumica e tyre kanë qenë injorantë dhe nuk kanë qenë prej njerëzve të rritur dhe atyre që ulen në qoshe për të dhënë mësim. Ky hadith është përshkrim i cili përputhet krejtësisht me këta njerëz. Sidoqoftë, ata kanë dalë nga bindja ndaj imamit, madje kanë dalë kundra tij dhe kanë vepruar vepra të këqija, gjë për të cilën nuk ka asnjë dyshim.

Hadithi në fjalë transmetohet nga prijësi i besimtarëve, Ali ibën ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i cili ka thënë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të thotë: "Në kohërat e fundit do të dalin disa njerëz të rinj në moshë, me ëndërra qesharake. Ata flasin me fjalët e krijesave më të mira, por besimi i tyre nuk i arrin gurmazet e tyre. Ata dalin nga feja ashtu siç del shigjeta nga harku. Kudo që t'i gjeni, vritini ata, sepse ai që i vret ata do të ketë shpërblim për vrasjen e tyre në Ditën e Kiametit!"

Ky hadith është muttefekun alejhi.

Por kjo nuk do të thotë që haurixhët janë kufarë dhe se kanë dalë nga populli musliman, sepse as Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) nuk i ka quajtur jobesimtarë, por mjafton që ata janë njerëz të humbur dhe se duhen luftuar, duke mos lënë askënd prej tyre në mesin e popullit të Muhamedit (Pagja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), sepse shkatërrimi i tyre është i madh dhe sherri i tyre, gjithashtu.

Së fundi: Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) në disa leksione të tij i quante ata "haurixh".

Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) thotë në librin "Es-Silsiletu es sahiha" në hadithin me numër 2236: "Pastaj do të zbresë Isai i biri i Merjemes dhe prijësi i tyre, Mehdiu do të thotë: "Eja falu si imami ynë!" Ai do të thotë: "Jo, sepse ju jeni popull që do të prini njëritjetrin si nderim i Allahut për këtë popull."

Shejh Albani thotë: "Dije, o vëlla besimtar, se shumë prej njerëzve iu fluturojnë zemrat kur ndodh ndonjë fitne (trazirë) dhe nuk dinë si të veprojnë e të sillen në lidhje me të. Ata nuk ndjekin rrugën e mesme të cilën ajo vetë u tregon atyre, por e humbin atë rrugë dhe shkojnë shumë larg saj. Për shembull, dikush prej tyre ka thënë se ai është Mehdiu, apo Isai, siç kanë bërë kadianitë, të cilët ndoqën Mirzanë, shërbëtorin e Ahmed el Kadianit, i cili në fillim tha se ai ishte Mehdiu, pastaj tha që ishte Isai dhe pastaj tha se ishte profet.

Po kështu, edhe grupi i Xhuhejman Suudit, i cili udhëhoqi fitnen e Haremit të Mekës në krye të vitit 1400 h., duke pretenduar se me të është Mehdiu i pritur dhe kërkoi prej atyre që ishin prezent në Harem t'i jepnin besën atij. Atij i shkonin pas disa mendjelehtë, të pavëmendshëm dhe të këqinj prej pasuesve të tij. Pastaj Allahu i dha fund fitnes së tyre, pasi ata kishin derdhur shumë prej gjakut të muslimanëve. Pastaj Allahu i qetësoi njerëzit nga sherri i tyre."

Fitneja e Mehdiut dhe zhytja në të, është e vjetër. Hafs ibën Gijath thotë: "I thashë Sufjan Theurit: "O Ebu Abdullah, njerëzit po flasin shumë për Mehdiun, po ti çfarë thua për këtë?"

Ai tha: "Nëse ai kalon para derës tënde, mos shko pas tij derisa të bashkohen të gjithë njerëzit dhe t'i japin besën atij!"

Ky është praktikim i një baze selefije të rëndësishme në kohën e fitneve, e cila është shtrëngimi pas teksteve dhe mosnxitimi për komentimin dhe zbritjen e tyre në ngjarjet e kohës si dhe domosdoshmëria e kuptimit, ashtu si kanë ardhur në pamjen e dukshme të tyre. Gjithashtu, prej fitneve të cilat nuk kanë mundur të lulëzojnë dhe në të cilat muslimanët kanë djegur veten e tyre, e cila është ndezur prej zjarrit të fitneve të Irakut dhe vatra e së cilës ka pasur ndikim të madh në vazhdueshmërinë e fitneve, ka qenë:

## Fitneja e Hamasë\*

Ajo ndodhi në qytetin Hama, në vitin 1402 h.(1982) në ngjarjet e muajit shkurt, ku në Siri shpërtheu një kryengritje gjithpërfshirëse nën emrin e Islamit. Pati përplasje ndërmjet një grupi kryengritësish të Islamit dhe sistemit sirian. Ngjarjet u përqëndruan në Hama, pjesë të mëdha të së cilës u shkatërruan me bombardime e shpërthime. Pas gjithë këtyre qëndronin rreth njëzet e pesë mijë të vrarë dhe shkatërtime katastrofale, të cilat gazetat e huaja i përngjasuan me shkatërrimin e një prej qyteteve të luftës së dytë botërore, përveç burgosjes së mijëra banorëve të saj dhe largimin e mijëra të tjerëve brenda dhe jashtë Sirisë.

Këtë e pasuan divizione e ndarje në mesin e grupit të "Ihuanul Muslimin" dhe të udhëheqjes së tyre në Siri.

Disa prej tyre e hodhën veten e tij në prehërin e Irakut dhe filluan të belbëzonin se do të lirojmë Sirinë me tanket irakiene, me pushkët palestineze dhe me trimat sirianë!

Ata hapën edhe një stacion radioje në Irak, në të cilin u bënë të njohura zërat e tyre për kryengritje dhe për thurjen e himneve për të, si dhe thonin se posedojnë kampe për stërvitjen e muxhahidinëve atje.

Shkaku i këtyre fitneve ka qënë nxitimi, moskuptimi i obligueshmërisë së kohës, mungesa e edukimit të dijetarëve sipas metodologjisë edukatore të selefëve, mospërshtatja e saktë me ligjet e sheriatit të veprave që ata bëjnë prej shkatërtimeve e katastrofave nën emrin e Islamit.

Këtyre u përputhet ajo që ka thënë Ibën Halduni, i cili thotë sikur t'i kishte për qëllim me emrat dhe personalitetet e tyre:

"Ata janë prej atyre që i vunë detyrë vetes së tyre për vënien e drejtësisë, por që nuk dinë se çfarë iu duhet për ta vënë atë."

Ai gjithashtu thotë: "Shumë prej atyre që shfaqen si njerëz të devotshëm e adhurues të mëdhenj, mendojnë se duhet ngritur krye kundër udhëheqësve, duke thënë se po ndryshojnë të keqen, po urdhërojnë për të mirë dhe shpresojnë me këtë shpërblimin e Allahut. Kështu që pasuesit e tyre prej mendjelehtëve të popullit të thjeshtë shtohen dhe ia ekspozojnë veten e tyre shkatërtimeve, në të cilat shumica e tyre humbin edhe jetën e tyre, por duke marrë me vete gjynah dhe shpërblim, sepse Allahu nuk ia ka ngarkuar këtë gjë atyre."

Gjithashtu ai thotë për ata dhe ia ka qëlluar të vërtetës:

"Ata nuk i ndiejnë rrjedhojat e veprës së tyre dhe përfundimet e gjendjes së tyre. Ata janë njerëz me fiksim, çështja e të cilëve ka nevojë për kurim, nëse janë prej të çmendurve, ose të marrin ndëshkimin e tyre me vrasje, ose me rrahje, nëse ata shkaktojnë trazira, ose të shpallet tallja me ta!"

Shejhu ynë, El Albani i ndalonte ata në kohën e fitnes nga ajo që ata bënin, por disa prej tyre talleshin me të, madje disa të tjerë, (Allahu ia shpërbleftë ashtu siç e meritojnë!) e akuzuan atë, duke thënë se ai është çifut. Sa e sa akuzime e tallje për shejhun tonë, El Albanin kemi dëgjuar në atë kohë nga disa prej ihuanul muslimin, sepse sipas pretendimit të tyre, ai i ndalonte ata nga xhihadi. Madje disa prej tyre thonin për të se ai i ka preokupuar njerëzit me lëvizjen e gishtit në namaz, ndërsa ne i preokupojmë ata me lëvizjen e gishtit në xhihad.

Një mendimtar prej tyre (sipas pretendimit të tyre) thotë për shejh Albanin: "Ai i mëson popullit që të hyjnë në xhami me këmbën e djathtë, ndërsa ne i mësojmë atyre se si pastrohen xhamitë nga kufarët dhe si lirohen prej tyre. A e sheh sa dallim të madh ka ndërmjet nesh?"

Po, për Allahun! Dallimi është shumë i madh dhe ai ka baza dhe rrënjë. Dallimi ndërmjet asaj që themelohet mbi ujë, realiteti i së cilës është pluhuri (ajri, boshllëku) është shumë i madh nga themelimi i burrave të mëdhenj sipas një menhexhi (rruge, drejtimi, metode) me baza të forta e të qëndrueshme dhe me degë të larta e të pastërta, të cilat e japin frytin e tyre në çdo stinë, me lejen e Zotit të tyre të Madhëruar.

## **Fitneja e Algjerisë e lindur nga kryengritja e parë në Irak**

Përveç këtyre që kaluan, ndodhi edhe një fitne tjetër, e cila mori pamjen e kryengritjes dhe të përplasjes së armatosur ushtarake me qeverinë. Kjo është fitneja më e madhe që ka ndodhur në kohën tonë, gjë e cila shtohet edhe më tepër kur gjejmë që ata të cilët e kanë organizuar atë i janë ngjitur (në mënyrë të rreme e të falsifikuar) "selefizmit", edhe pse dijetarët dhe imamët e mëdhenj kanë thënë se janë larg saj dhe njerëzve të saj, si dhe paralajmëruan organizatorët e saj para se t'i hipnin asaj në shpinë!

Kjo fitne është:

### **Fitneja e Algjerisë dhe "Frontit Islam të Shpëtimit"**

Për këtë fitne ka shumë për t'u thënë, sepse ajo ka degëzime e pasoja të shumta. Por këtu nuk do të paraqesim të gjitha ato ngjarje me hollësi, sepse nuk është ky vendi i tyre, por

do të mundohemi të paraqesim lidhjen e lindjes së kësaj fitneje nga fitneja e atij personit, i cili sikur të ishte vrarë, nuk do të kishte më trazira pas tij.

Kjo fitne dhe ajo para kësaj (fitneja e Hamasë) kanë lindur nga "dasma e shejtanit në Irak, e cila bëri vezë dhe çeli zogjtë e saj".

Këto dy fitne u shfaqën kur shejtani i gjeti hauarixhët objekt të daljes kundra pushtetarëve, duke u bërë shkak për derdhjen e gjakrave dhe vrasjen e të pafajshmëve.

Kjo fitne e nxori tymin nga këmbët e disa njerëzve, të cilët shfaqnin se ishin "selefi", por ata nuk ishin dhe nuk janë të atillë. Përkundrazi, ata kanë shpifur dhe kanë folur keq për imamët e selefive si dhe i qëndrojnë në pusi asaj. Këta janë prej atyre që kanë ndjekur metodologjinë e ihuanul muslimin dhe që janë ndikuar disi me thirrjen selefite, por pa qëndrueshmëri në rrugën dhe metodën e selefive në ndryshimin dhe përmirësimin e gjendjes së muslimanëve si dhe pa qëndruar tek fjalët e imamëve të tyre të hershëm e të tanishëm.

Ajo që i shtoi më tepër baltë kësaj fitneje ishte:

Së pari: Përhapja e përmendjes së saj nga përkrahja dhe zmadhimi i saj në fjalët e predikuesëve, vaizave dhe nxënësve të dijes, shumica e të cilëve ishin nga shkolla e Muhamed Surur Zejn el Abidin, për shkak të përputhshmërisë së shijeve e preferencave dhe njëshmërisë së drejtimeve të tyre me të.

Së dyti: Pretendimi i shumë prej tyre se gjoja "Fronti i Shpëtimit" është shtrirje e "Organizatës Selefite të Dijetarëve", pas së cilës qëndronte dijetari i madh selefi (sipas tyre) Abdul Hamid ibën Badis.

Së treti: Thashethemet e padrejta dhe të rreme që e shoqëruan atë, se gjoja dijetarët e kohës si shejh Albani dhe Ibën Bazi (Allahu i mëshiroftë!) e përkrahin atë, bëjnë lutje për të, janë me të dhe ajo ecën me udhëzimet dhe fetuatë e tyre.

Për Allahun, kjo është një gënjeshtër e hapur dhe ne jemi dëshmitarë (shejh Meshhur Hasen) të asaj që ka rrjedhur ndërmjet tyre dhe dijetarit të madh dhe muhadithit, profesorit tonë Muhamed Nasirudin ibën Nuh Nexhati el Albani (Allahu e mëshiroftë!). Ky është sqarimi:

Organizatorët e "Frontit të Shpëtimit" të përmendur më sipër i dërguan një letër në të cilën kërkonin fetua prej shejhut tonë Albanit, pas kohës së ikindisë të ditës së martë, 18 xhemadul ahira, 1412 h., nëpërmjet faksit, dy ditë para zgjedhjeve të përgjithshme në Algjeri.

Atëherë shejhu ynë në mbrëmjen e të njëjtës ditë i dërgoi mesazh nëpërmjet telefonit tre personave për të cilët kishte mendim të mirë, dhe duke i njoftuar ata se Allahu i



Madhëruar e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) që të konsultohet me shokët e tij, dhe se këtu janë disa pyetje (gjashtë pyetje), të cilat sillen rrotull "zgjedhjeve" dhe "parlamentit". Më poshtë po paraqesim fjalë për fjalë këto pyetje dhe përgjigjet e tyre, të marra nga shkrimi i shejh Albanit (Allahu e mëshiroftë!)

مديحرل انمحرل اهل الامسب

Falenderimi i takon vetëm Allahut. Vetëm Atë falenderojmë, Atij i kërkojmë Ndhimë dhe falje të gjynaheve tona. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej të keqes së veteve (shpirtrave) dhe punëve tona. Atë të cilin udhëzon Allahu, nuk ka kush ta humbë dhe atë të cilin humb Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut Një e të Pashok dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Dërguar Këshillit të thirrjes dhe udhëzimit të "Fronti Islam për shpëtim"

Ue alejkumu selam ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Në pasditen e ditës së martë, më 18 xhemadul ahira të vitit 1412 h. unë mora letrën tuaj, të cilën ma dërguat nëpërmjet faksit. Unë e lexova atë dhe i kuptova ato që ishin shkruar në të nga pyetjet në lidhje me zgjedhjet parlamentare, për të cilat thoshit se do të bëhen aty tek ju në ditën e enjte, (d.m.th pasnesër) dhe kërkonit prej meje që të shpejtoja në kthimin e përgjigjeve të tyre. Kështu që, fillova menjëherë shkruajtjen e përgjigjes në të njëjtën mbrëmje, për t'ua dërguar juve gjithashtu me faks, mëngjesin e kësaj dite (të mërkurën) duke ju falenderuar juve për mendimin e mirë që keni për vëllanë tuaj dhe për fjalët e bukura që thonit për të, por të cilat ai nuk i meriton. Lus Allahun e Lartmadhëruar që t'ju japë sukses në thirrjen dhe udhëzimet tuaja!

Tani po ju paraqes atë që më mundësoi Allahu prej përgjigjeve të pyetjeve tuaja, duke shpresuar nga Allahu që të më inspirojë saktësinë dhe qëllimin e të vërtetës në to!

**Pyetja e parë:** Cili është gjykimi i sheriatit për zgjedhjet parlamentare, nëpërmjet të cilave përpiqemi të ngremë shtetin Islam dhe hilafetin e drejtë?

**Përgjigja:** Dita më e lumtuar për muslimanët në vendet e tyre është dita në të cilën do të ngrihet flamuri "La ilahe il-Allah" dhe që gjykimi do të jetë me atë që ka zbritur Allahu.

Prej asaj në të cilën nuk ka dyshim, është se të gjithë muslimanët, gjithësecili sipas mundësisë, e kanë për detyrë të përpiqen për ngritjen e shtetit musliman, i cili gjykon me Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) sipas drejtimit të selefëve tanë të mirë.

Prej asaj që është e prerë dhe padiskutueshme për çdo studiues musliman, është se kjo gjë nuk mund të arrihet e vetëm se me dijen e dobishme dhe punën e mirë. Gjëja e parë për këtë është që një grup dijetarësh të merren me dy çështje shumë të rëndësishme:

E para: T'u kumtojnë dijen e dobishme muslimanëve që kanë përreth, dhe për këtë nuk ka rrugë tjetër, përveç marrjes, me spastrimin dhe pastrimin e dijes që kanë trashëguar, nga përzierja e saj me shirqet e idhujtaritë e ndryshme, saqë shumica e muslimanëve nuk e dinë më kuptimin e fjalës së tyre "La ilahe il-Allah" dhe se kjo fjalë e bukur ka për rrjedhojë, Njësimin e Allahut të Madhëruar në adhurim, i Cili është Një e i Pashok. Duke mos kërkuar ndihmë, vetëm se prej Tij, duke mos therur e as zotuar vetëm se për Të dhe që të mos e adhurojnë Atë, vetëm se ashtu si Ai ka urdhëruar në gjuhën e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), gjë e cila është rrjedhojë e fjalës së tyre "Muhamedun rasulull-llah".

Kjo kërkon prej tyre që të pastrojnë librat e fikhut nga mendimet dhe konkluzionet, të cilat bien në kundërshtim me sunetin e saktë, me qëllim që adhurimi i tyre të jetë i pranuar. Kjo kërkon gjithashtu, pastrimin e sunetit nga ajo që ka hyrë në të me kalimin e kohëve, prej haditheve të dobëta dhe të shpikura. Gjithashtu, kërkon pastrimin e sjelljeve nga devijimet që gjenden në tariketet e sufive dhe nga teprimi në adhurim dhe asketizëm, si dhe gjëra të tjera, të cilat e kundërshtojnë dijen e dobishme.

E Dyta: Të edukojnë veten e tyre mes njëri-tjetrit dhe muslimanët që kanë përreth, sipas kësaj dijeje të dobishme. Atëherë, dija e tyre do të jetë e dobishme dhe puna e tyre e mirë, siç thotë Allahu i Lartësuar: **"Kush shpreson takimin me Zotin e tij, atëherë të veprojë punë të mirë dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurimin e Zotit të tij!"** [El Kehf: 110].

Atëherë kur të ngrihet një grup prej muslimanëve dhe të kujdeset për këtë spastrim dhe edukim sipas sheriatit, atëherë nuk do të gjendet më në mesin e tyre njerëz të cilët ngatërrojnë mjetet politeiste me mjetet e sheriatit, sepse ata e dinë se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka ardhur me sheriat të plotë, me qëllimet dhe mjetet e tij, prej të cilave është, p.sh. ndalimi nga të përngjasuarit me mosbesimtarët dhe nga marrja e mjeteve dhe sistemeve të tyre, të cilat i përshtaten zakoneve dhe traditave të tyre. Prej tyre është gjithashtu, zgjedhja e udhëheqësve të shtetit dhe të deputetëve me anë të votimeve. Ky mjet (votimet) i përshtatet kufrit dhe injorancës së tyre, të cilët nuk bëjnë dallim ndërmjet besimit dhe mosbesimit, as ndërmjet vepërmirit dhe vepërkeqit dhe as ndërmjet mashkullit dhe femrës, ndërsa Zoti ynë thotë:

**"A t'i konsiderojmë muslimanët njësoj si kriminelët? Ç'është kështu me ju? Si gjykoni kështu?"** [El Kalem: 35-36]

**"Dhe mashkulli nuk është si femra."** [Al Imran: 36].

Ata gjithashtu, e dinë se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ka filluar ndërtimin e shtetit musliman me thirrjen në Njësimin e Allahut dhe qortimin e paralajmërimit nga adhurimi i idhujve si dhe me edukimin sipas ligjeve të sheriatit, të atyre që i përgjigjeshin thirrjes së tij, derisa ata u bënë si një trup i vetëm, nga i cili nëse do të ankohej një prej gjymtyrëve të tij, atëherë i gjithë trupi do të vuante nga dhimbja dhe ethet, siç thuhet në një hadith të saktë. Në mesin e tyre nuk kishte njerëz të cilët vepronin gjynahe të mëdha, ngrënie kamate, imoralitet apo vjedhje. Këta mund t'i gjeje shumë rrallë.

Kështu që, ai që do vërtet të ndërtojë shtet musliman, nuk duhet t'i përziejë e t'i bashkojë njerëzit duke qenë në atë gjendje që ata janë, prej kudërshtimit dhe ndryshimit në ide dhe edukatë, siç është gjendja e e partive islamike të njohura sot. Është e domosdoshme që të njësohen idetë dhe botkuptimet e tyre mbi bazat e sakta islame: Kuran dhe Sunet, sipas rrugës së selefëve të mirë, siç e thamë më lart. Atëherë: **"Atë ditë besimtarët do të gëzojnë për triumfin e Allahut."** [Errum: 4-5].

Kush i kthen shpinën kësaj rruge në ngritjen e shtetit musliman dhe ndjek rrugën e kufarëve në ngritjen e shtetit të tyre, ai është si ai që ikën nga zjarri në nxehtësi. Mjafton si gabim, nëse nuk themi gjynah, që ai ka kundërshtuar udhëzimin e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe nuk e ka marrë atë për shembull, ndërsa Allahu i Madhëruar thotë: **"Ju keni pasur shembullin më të mirë tek i Dërguari i Allahut, për atë që shpreson shpërblimin e Allahut dhe botën tjetër, dhe e përmend shumë Allahun."**

**Pyetja e dytë:** Cili është gjykimi i sheriatit për ndihmën dhe përkrahjen (votimin) në lidhje me çështjen e përmendur më parë (zgjedhjet parlamentare)?

**Përgjigja:** Në të njëjtën kohë, ne nuk këshillojmë asnjë prej vëllezërve tanë muslimanë që të kandidojnë për deputet në një parlament i cili nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu, edhe pse në kushtetutën e tij thuhet se "Feja zyrtare është Islami", pasi është vërtetuar me vepra se kjo shprehje është vendosur për të "droguar" gjymtyrët e deputetëve me zemër të mirë! Kjo, sepse ai nuk mund të ndryshojë gjë nga kushtetuta, e cila është në kundërshtim me Islamin, siç është vërtetuar me vepra në disa vende, të cilat e kanë në kushtetutën e tyre një gjë të tillë.

Kjo, nëse ai nuk do të përlyhet me kalimin e kohës që të aprovojë disa ligje të cilat e kundërshtojnë Islamin, duke u justifikuar se ende nuk ka ardhur koha për ndryshimin e tyre, siç e kemi parë në disa vende ku deputeti e ndërton uniformën e tij islame me uniformë perëndimore, me qëllim që të kënaqë deputetët e tjerë. Ai hyn në parlament për të rregulluar të tjerët, por prish veten e tij. Dihet që fillimi i shiut të madh janë pikat e tij dhe pastaj ai derdhet me furi!

Për këtë shkak, ne nuk këshillojmë asnjë që të paraqesë veten e tij për kandidat, por nuk shoh ndonjë gjë që ta ndalojë popullin musliman, nëse në mesin e kandidatëve gjenden

persona që e luftojnë Islamin dhe të tjerë kandidatë muslimanë nga partitë me drejtime të ndryshme, atëherë, në këtë gjendje, këshillojmë që çdo musliman të votojë vetëm për kandidatët muslimanë dhe për atë që është më afër rrugës së saktë të dijes.

E them këtë, edhe pse unë besoj se kjo kandidaturë dhe këto votime nuk e realizojnë qëllimin e kërkuar, siç e thamë më sipër, prej pakësimit të së keqes dhe prej shtyrjes së të keqes së madhe me një të keqe më të vogël se ajo, siç thonë dijetarët.

**Pyetja e tretë:** Cili është gjykimi për daljen e grave për të votuar?

**Përgjigja:** U lejohet grave që të dalin sipas kushteve të njohura në lidhje me to. Ato kushte janë që të vishen me veshjen sipas sheriatit dhe të mos përzihen me burrat.

Dhe së dyti, të votojnë për atë që është më pranë rrugës së dijes së saktë, duke u nisur nga shtyrja e të keqes së madhe me të keqe më të vogël se ajo, siç e thamë më parë.

**Pyetja e katërt:** Cilat janë rregullat e sheriatit në lidhje me metodat e të vepruarit sipas sheriatit në parlament dhe në lidhje me deputetët e tjerë?

**Përgjigja:** Qëllimi juaj me këtë pyetje është i turbullt dhe jo shumë i qartë për ne. Kjo, për shkak se deputeti musliman duhet të jetë i vetëdijshëm dhe i njohur me ligjet e sheriatit në format dhe llojet e tyre të ndryshme. Kështu që çdo çështje apo nen që shtrohet për aprovim, duhet të peshohet me kendarin e sheriatit. Atë që përputhet me sheriatin e përkrah dhe atë tjetrën e refuzon, siç është besimi tek qeveria dhe betimi për përkrahjen e kushtetutës etj.

Ndërsa në lidhje me deputetët e tjerë, ndoshta keni për qëllim se cili duhet të jetë qëndrimi i deputetëve muslimanë ndaj tyre?

Nëse qëllimi juaj është ky, atëherë nuk ka dyshim se është obligim mbi muslimanët, deputetë e votues, që të jenë me atë që është në të njëjtën rrugë me ta, mbi të vërtetën e të drejtën, siç thotë Zoti i botëve: **"Dhe jini me të sinqertët!"** [Et Teube: 119].

Përsa i përket pyetjes së pestë dhe të gjashtë, përgjigja e tyre kuptohet nga përgjigjet e kaluara.

Por ne shtojmë këtu, që të mos jetë synimi juaj, grupi i Fronti Islam, arritja në pushtet, para se të përgatitet populli për pranimin e ligjit Islam, gjë e cila nuk mund të bëhet vetëm se nëpërmjet hapjes së instituteve e shkollave në të cilat populli do të mësojë ligjet e fesë së tij në pamjen e vërtetë e të saktë dhe të edukohet që të veprojë sipas tyre. Gjithashtu, të mos ketë ndërmjet tyre kundërshtim rrënjësor, nga i cili lindin parti e përçarje, siç është realiteti i tanishëm në Afganistan. Për këtë shkak Zoti ynë thotë në Kur'an: **"Dhe mos u bëni prej idhujtarëve, prej atyre të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në parti, ku çdo parti është e kënaqur me atë që ka!"** [Er Rum: 31-32].

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Mos u ndani, mos u armiqësoni, mos e urreni njëri-tjetrin, mos kini smirë për njëri-tjetrin, por jini vëllezër, ashtu siç iu ka urdhëruar Allahu!" [Këtë hadith e transmeton Muslimi].

Kështu që, ju duhet të merreni me spastrimin e dijes (tesfije) dhe me edukimin e njerëzve (terbije) me kujdes dhe maturi, sepse "Maturia është prej Rrahmanit, ndërsa nxitimi është prej shejtanit", siç ka thënë pejgamberi ynë (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Për këtë shkak thuhet: "Kush nxitohet në arritjen e diçkaje para kohës së saj, ai sprovohet me humbjen e saj."

Ai që e sheh shembullin e të tjerëve, atëherë le të mësojë prej tij. Ju e dini që disa muslimanë përpara jush në shumë vende muslimane e kanë provuar të hyjnë në parlament me qëllim që të ngrenë shtetin islam, por ata nuk u kthyen as me nostalgji për ngritjen e tij.

Kjo, sepse ata nuk e dinin atë fjalën e urtë që thotë: "Ngrijeni shtetin islam në zemrat tuaja, që t'ju ngrihet në tokën tuaj!"

Kështu, siç thotë edhe i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): "Allahu nuk vështron në pamjet në pasuritë tuaja, por vështron në zemrat dhe në veprat tuaja."

Transmeton Muslimi

Lus Allahun e Lartmadhëruar që të na inspirojë arsyetimin e drejtë, të na mësojë atë që na bën dobi, të na udhëzojë në të punuarit me sheriatin e Zotit tonë, duke ndjekur në këtë sunetin e të Dërguarit tonë dhe rrugën e të parëve tanë të mirë! E gjithë e mira është në pasimin e të parëve, ndërsa e gjithë e keqja është në shpikjet në fe.

Lus Allahun të na largojë shqetësimin dhe mërzitjen tonë dhe të na ndihmojë kundër atyre që na luftojnë!

Allahu është Dëgjues, Lavdiplotë.

Amman, në mëngjesin e së mërkurës, 19 xhemadul ahira, 1412 h.

Muhammed Nasirudin el Albani

Ebu Abdurrahman

Shejh Meshhuri thotë se e ka dëgjuar shejh Albanin (Allahu e mëshiroftë!) pas mbarimit të përpilimit të letrës, të fliste me keqardhje për gjendjen në të cilën kanë arritur muslimanët sot dhe të ankohej nga nxitimi i të rinjve dhe teprimi i tyre, aq më tepër që algerianët janë të njohur për papërmbajtshmërinë e tyre. Frika që të mirët e tyre të

përzihen në një fitne (sprovë, trazirë) të madhe, e cila mund të arrijë deri në derdhjen e gjakrave dhe burgosjen e qindrave apo mijërave prej tyre.

Shejh Meshhuri vazhdon të thotë: “Po për Zotin, e dëgjova këtë prej tij me dy veshët e mi, e zemra ime e kuptoi. Pas një kohe jo të gjatë lexova një artikull të dijetarit të madh selefi, El Xhezairi Muhamed el Beshir el Ibrahim, të cilin e kishte shkruar në vitin 1964 dhe e kishte botuar në revistën "El Basair", sikur ai të ishte shkruar pas asaj që ndodhi në Algjeri. Atëherë kujtova fjalën e shejh Albanit dhe shkova tek ai që t'ia lexoja këtë artikull në një mexhlis të dijes në bibliotekën e tij dhe shejhu (Allahu e mëshiroftë!) e pëlqeu”.

Teksti i atij artikulli është ky:

"Ndërsa në Algjeri, që në fillim kur votimet u bënë rrugë e pasuar, ato ishin lojë e një lojtari, tallje e një tallësi, peng i tiranisë dhe diktatorisë. Ato lindën të shëmtuara e të mangëta dhe vazhdojnë të ecin mbrapsht e të bien mbi kokë. Ato që në ditën e parë u vendosën mbi kundërshtimin më të keq të vetvetes dhe mbi më të shpifurin arbitraritet, dallim dhe racizëm...

Këto votime kanë qenë një e keqe e vazhdueshme për popullin e Algjerisë dhe arma më therëse, të cilën e hodhi kolonializmi, pasi vështroi larg. Kjo ishte një goditje vdekjeprurëse për atë që ky popull përpiquej e përgatitej që prej kohësh për bashkimin e fjalës dhe unitetin e tij. Sa herë që rregulluesit përpiqeshin të bashkonin fjalën e tij (dhe pothuajse ia arrinin) pikërisht, atëherë vinin këto votime për të shkatërruar atë që ndërtuan dhe që thurën me shumë mundime. Të gjitha këto kanë qenë para se qeveria të mbante ato qëndrimet e saj të njohura në zgjedhjet e një viti më parë. Ndërsa pasi ata u shfaqën me këtë shfaqje, pasi për zgjedhjet algjeriane u vendos një kushtetutë e quajtur "Padrejtësia dhe shpata", pasi ata kryen ato turpësira, për të cilat të kullon djersa e ballit nga turpi, të cilat nuk do t'i kryente as një njeri i thjeshtë e i robëruar dhe jo më një qeveri popullore në pamjen e saj dhe demokrate në parrullat e saj, atëherë zgjedhjet u bënë fatkeqësi dhe epidemi për popullin, i cili i mori moralet e larta të fshehura në brendësinë e tij dhe i hodhi ato në erë e në pluhur. Pikërisht, ato “karrige” u bënë një faktor i fortë për prishjen e burrërisë, akides dhe fesë. Po ashtu, për sëmundjen dhe dobësimin e vendosmërisë dhe vetëdashjes. Ato përmbajnë kuptimin e alkoolit, të cilin kush e shijon, bëhet frekuentues i rregullt i tij si dhe kuptimin e bixhozit, të cilin kush e provon, bëhet rob i tij...

O Zot! Deri kur do të vazhdojnë të mbyten partitë me njëra-tjetrën nëpër votime, ndërkohë që kanë parë me sytë e tyre ato që kanë parë?!

Për ç'arsye bëhen gjithë ato shpenzime nëpër propaganda e mbledhje, përderisa qeveria është rivale në këtë çështje dhe jo arbitër. Gjithashtu, ajo mbështetet në rivalitetin e saj, mbi forcën, të cilën ajo e ka në dorë dhe sigurisht që fitoren e ka të sigurt para se të fillojë luftën.

Mjerë për popullin algjerian nga zgjedhjet dhe mjerë për ata që janë sprovuar me to në Ditën e Llogarisë!"

Shejh Albani pyetej për çka ishte duke ndodhur në Algjeri dhe a mund të përgëzohemi me mirësi për fitoren e muslimanëve?

Ndërsa ai (Allahu e mëshiroftë!) nuk shtonte më tepër se fjala e tij "fluska sapuni". Këtë dëgjuan veshët e mi dhe e kuptoi zemra ime.

Ndërsa "Fronti" e shtoi më shumë zjarrin e fitnes kur morën faksin e shejh Albanit, të cilin ai ua dërgoi atyre. Ata i bënë njerëzit të kuptonin se shejhu i ka përkrahur ata, ndërsa pjesën tjetër e fshehën. Pastaj i hipën kokës së tyre dhe nuk zbritën në udhëzimet e dijetarëve, pastaj ndodhi ajo që ndodhi, por Allahu është Ndihmuesi më i mirë dhe tek Ai mbështetemi!

Dhjetra-mijëra të rinj u bënë fli të kësaj fitneje, ndërsa një pjesë prej tyre u larguan nëpër male dhe i dhanë besën një prijësi të tyre. Më pas ata u kundërshtuan mes tyre dhe u ndanë në disa grupe, gjë e cila është rregulli i Allahut me pasuesit e të kotës si dhe pinë gjakun e njëri-tjetrit. Madje njëri prej të mëdhenjve të tyre më ka treguar nëpërmjet telefonit, pas pendimit të tij, se gratë, të cilat ishin me ta në mal, u morën si robëresha luftime për prijësit e tyre pas ndarjes në grupe, duke lejuar imoralitetin me emrin e xhihadit.

Herë pas here këta kryenin ndonjë aksion (sipas emërimit të tyre) dhe shkaktonin kasaphanë, duke mbushur makina me eksploziv dhe duke i shpërthyer ato në vendet ku kishte grumbullim njerëzish.

Nga shpërthime të tilla, ata shkaktuan vrasjen e një numri jo të vogël të pafajshëm.

Një gazetë botoi një artikull të disa të penduarëve prej këtyre, i cili gjoja mbante titullin "Ishim viktimë të fetuave të selefëve", por kjo është një gënjeshtëri. Përkundrazi, vetë ata u dorëzuan një udhëheqjeje, e cila i tërhoqte gjoja me emrin e fesë dhe duke mashtruar për dijetarët selefij, si Ibën Bazi, El Albani dhe Ibën Uthejmini (Allahu i mëshiroftë!). Ata iu hodhën hi syve ndjekësve, duke menduar se dijetarët janë me ta dhe se ata veprojnë sipas udhëzimeve të tyre, fetuave dhe këshillimeve të tyre!

Aspak nuk është kështu, sepse këta dijetarë pohojnë se ajo që ndodhi në Algjeri, nuk ka qenë tjetër vetëm se menhexhi i hauarixhëve!

Shejh Albani thotë ndër të tjera në disa fjalë të tij për atë që ndodhi në Algjeri:

"Nëse pyetja është se kur këta minojnë makinat dhe pastaj i shpërthejnë ato, duke shkaktuar vrasjen e personave të cilët nuk kanë asnjë lloj përgjegjësie në ligjet e sheriatit, diçka e tillë nuk është kurrë prej Islamit.



Por unë them se kjo është një pjesë prej asaj të plotës, më e rrezikshmja e së cilës është kjo kryengritje që ndodhi para disa vitesh, ndërkohë që gjendja vazhdon të keqësohet edhe më shumë.

Për këtë shkak, ne themi se punët janë sipas përfundimeve dhe vulosjeve të tyre. Përfundimi nuk mund të jetë kurrë i mirë, vetëm nëse ngrihet mbi Islamin, ndërsa ajo që ngrihet e ndërtohet në kundërshtim me Islamin, nuk ka për të prodhuar, vetëm se shkatërrim e katastrofë!"

Kështu që shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) mendon se këto shkatërrime prej derdhjes së gjakut dhe prishjes së qetësisë e sigurisë së popullit, shkakut i tyre është "El Huruxh" (dalja kundër pushtetarëve), i cili ndodhi në Algjeri, mbi të cilin vazhduan kryengritësit disa vjet rresht.

Nuk ka dyshim se vrasja e muslimanëve me njëri-tjetrin, qofshin individë me individë apo ushtri me ushtri si dhe konsiderimi i kësaj gjëje si diçka e lejuar, kjo është vetë rruga e huarixhëve pikërisht, edhe nëse nuk kanë shprehur hapur nxjerrjen nga feja për shkak të gjynaheve të mëdha.

Për këtë shkak, kur u pyet fakihu (dijetari i fikhut) i kësaj kohe, shejh Ibën Uthejmini, për atë që ndodh në Algjeri, duke i thënë: Disa grupe ngrihen për të luftuar sistemet qeveritare (të vendeve të tyre) sipas rregullit që thotë: "Luftimi i shteteve islame është më parësor se luftimi i shteteve kufare, të cilat janë josbesimtarë në origjinë, sepse shtetet islame kanë dalë nga feja, ndërsa ai që ka dalë nga feja duhet luftuar më parë se kafiri".

Sa i saktë dhe i vërtetë është ky rregull?

Atëherë shejhu (Allahu e mëshiroftë!) u përgjigj me fjalën e tij:

"Ky rregull është rregulli i huarixhëve, të cilët vrasin muslimanët dhe lënë kufarët. Sigurisht që ai është një rregull i kotë dhe i pavërtetë."

Nuk ka dyshim se hadithi i të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), të cilin e kemi përmendur më parë, në të cilin përmenden veprat dhe kundërshtimet e huarixhëve, ka për qëllim paralajmërimin dhe ruajtjen prej tyre.

Kështu që, nuk thuhet se kjo fitne doli nga njerëz selefi të cilët kanë disa gabime, por që nuk janë prej huarixhëve.

Përkundrazi, ajo doli nga këmbët e disa lloje të njerëzve, të cilët kanë të përbashkët dhe të veçantë me huarixhët, madje disa prej tyre përputhen plotësisht me ta në fenë e tyre dhe nuk dallojnë as sa mollëza e gishtit. Këto lloje e grupe i kanë treguar hapur disa prej tyre të cilëve Allahu ua pranoi pendimin, kur ata u kthyen në pjekurinë dhe logjikën e

saktë të tyre si dhe kur u lidhën me dijetarët e mëdhenj edukatorë dhe me nxënësit e dijes të përparuar e të thelluar në dije.

Për më shumë sqarime po paraqesim për vëllezërit lexues atë që ndodhi ndërmjet këtyre personave që u penduan dhe shejh Ibën Uthejmin (Allahu e mëshiroftë!).

### **Dialog i rebelëve algjerianë në majat e maleve me dijetarin e madh Ibën Uthejmin ,1 Ramazan, 1420 h.**

**Pyetësi:** Së pari, ju bëjmë të ditur se ne që po ju flasim jemi vëllezërit e tu luftëtarë, apo më saktë luftëtarë prej "Grupit Selefi për Thirrjen dhe Luftën". Ne sigurisht që do t'ua komunikojmë fjalën tuaj (inshaAllah) të gjithë vëllezërve tanë luftëtarë në këtë grup dhe në grupet e tjera, gjithashtu.

E kemi hedhur këtë hap, pasi na mbërriti thirrja dhe këshilla juaj e datës trembëdhjetë të muajit sefer të këtij viti (1420 h).

Ajo që vlen të përmendim është se thirrja juaj nuk na ka mbërritur vetëm se para një muaji e gjysëm, madje disa vëllezërve nuk u ka mbërritur ende.

Nga ana tjetër, shumë prej vëllezërve të cilëve u arriti këshilla juaj, ranë në dyshime, të cilat i penguan që t'i përgjigjeshin thirrjes tuaj. Kështu që ishte e domosdoshme të zhvillohej ky dialog i ri me shkëlqesinë tuaj, duke shpresuar që nëpërmjet tij të marrim përgjigje për të gjitha pyetjet e shtruar, për heqjen e të gjitha dyshimeve dhe për sqarimin e të vërtetës së qartë, me qëllim që të jemi në rrugën e drejtë nga e cila nuk devijon, vetëm se ai që është i shkatërruar.

Ne kërkojmë nga shkëlqesia juaj (Allahu ju ruajt!) që të na jepni sa më shumë të jetë e mundur nga koha juaj dhe që të zgjeroheni në sqarime e shpjegime, sepse siç e dini, o shejhu ynë, vëllezërve tanë këtu këto vitet e luftës u janë ngulitur ide e bindje, të cilat nuk është e lehtë që të tërhiqen e t'i lënë ato dhe të besojnë se ato kanë qënë të kota, vetëm nëse ju jepni sqarime bindëse. Kjo për shkak se ju keni një vend të madh në zemrat e vëllezërve këtu, respekt dhe nderim, sepse ne besojmë se ju jeni prej yjeve të ehli sunetit dhe xhematit në këtë kohë.

Tani po ju shtrojmë dyshimet e hedhura në mesin tonë.

**Shejhu:** Më lejo të flas pak! - pastaj tha:

Falenderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Dërgoj salauat e selam mbi të dërguarin tonë Muhamedin, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe mbi ata që ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Këtu nga Unejzetul Kasim të Mbretërisë së Arabisë Saudite, në ditën e parë të muajit ramazan të vitit 1420 h. flas me vëllezërit e mi në Algjeri, ndërsa unë jam Muhamed ibën Salih el Uthejmin.

U them atyre se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në haxhin e Lamtumurës dha vendim për ndalimin e gjakrave tona, pasurive dhe ndereve tona, me një vendim të qartë e të prerë, pasi pyeti shokët e tij për atë ditë, për atë muaj dhe për atë vend, pastaj tha:

"Gjakrat, pasuritë dhe nderet tuaja janë haram për ju, si ndalimi i kësaj dite, të këtij muaji, në këtë vend. A nuk kumtova?" [Buhariu dhe Muslimi].

Kjo është diçka për të cilën janë bashkuar të gjithë dhe nuk kundërshtohen për të, ndërsa vëllezërit, të cilët kanë luftuar për vite me radhë në Algjeri mund të kenë dyshime në veten e tyre. Në fillim të kësaj çështjeje, kur populli algjerian iu drejtua "Fronti të Shpëtimit" dhe ngritën zërat e tyre në favor të "Fronti", por... ky front nuk fitoi dhe gjendjen e morën të tjerët në dorë, padyshim që kjo është për të të ardhur keq dhe se për detyrë është pasimi i shumicës, për të cilën populli algjerian ra dakord për qeverisjen e tij, për thënien dhe pasimin e të vërtetës.

Por, kjo nuk lejon dhe nuk jep shkas që vëllezërit atje t'i ngrenë armët njëri-tjetrit, ndërkohë që obligimi i tyre që në fillim të kësaj çështjeje ka qënë që të shtojnë thirrjen për të gjykuar sipas Kuranit dhe Sunetit, me qëllim që herën tjetër, zërat dhe pesha e tyre tek populli algjerian do të ishte më i madh.

Por ne themi se ky është caktimi i Allahut, i Cili vepron ç'të dojë dhe nëse do të donte Allahu të bëhej ajo që përmenda, do të ishte bërë.

Ndërsa tani, unë mendoj se është obligim për këta vëllezër që të heqin dorë nga kjo luftë, aq më tepër kur qeveria algjeriane ua ka shfaqur këtë dhe i ka dhënë siguri atij që e hedh armën, kështu që nuk ka mbetur justifikim.

Algjeria tani mban mbi shpinë katastrofa pas katastrofash dhe ne na erdhi mirë kur qeverisjen e Algjerisë e mori presidenti Abdulaziz Boteflika, sepse gjendja u qetësua disi.

Kemi dëgjuar se këto ditë është shtruar disi dhunë, gjë e cila është për të ardhur keq që në Algjerinë muslimane të kthehet sërish dhuna... në muajin e begatshëm të Ramazanit.

Ajo që kanë për detyrë muslimanët, është që të bashkojnë fjalën e tyre mbi të vërtetën, në muajin Ramazan dhe në muajt e tjerë, por në Ramazan kjo është edhe më e fortë.

Këshilla ime për vëllezërit tanë luftëtarë...

**Por pyetësi e ndërpreu duke thënë:** Iu bëj të ditur (me qëllim që përgjigja juaj të jetë në përputhje dhe në dobi të vëllezërve), ju sikur besoni apo mendoni se ata që po flasin me ju tani janë prej pasuesve të "Frontit Islam të Shpëtimit"?

O Shejhu ynë, në këtë çast fusha e betejës algjeriane përmban tre grupe:

- Pasuesit e "Frontit Islam për Shpëtim" të cilët kanë dalë për shkak të votimeve dhe çështje të tjera si ato.

- "Grupi Selefi për Thirrje dhe Luftën" në emër të së cilit neve po ju flasim dhe jemi anëtarë të tij. Ky grup nuk ka lidhje me "Frontit Islam për Shpëtim" dhe nuk ka lidhje me partitë dhe as me votimet. Ky grup ka ngritur krye, duke u mbështetur në besimin se ky sundimtar është kafir dhe se lejohet të ngresh krye kundër tij.

- "El hixhra uet tekfir" e cili vazhdon të ushtrojë dhunë dhe të mos i dëgjojë dijetarët.

Ndërsa ne luftëtarët e "Grupit Selefi për Thirrjen dhe Luftën", siç të thashë pak më parë, i duam dhe i madhërojmë dijetarët, veçanërisht dijetarët e ehli sunetit dhe xhematit, siç është shkëlqesia juaj. Ne e marrim fjalën e tyre, por kanë hyrë disa dyshime e pyetje, të cilat janë bërë pengesë për mospranimin e plotë të fjalës tuaj.

**Shejhu:** Nga fjala jote tani kuptova se ju jeni tre grupe: "Fronti i Shpëtimit", "Grupi Selefi" dhe "Grupi Tekfiri (të cilët bëjnë qafira muslimanët)". A nuk është kështu?

**Pyetësi:** Po, kështu është, o shejh!

**Shejhu:** Sa për "Frontin e Shpëtimit" më duket se ata kanë rënë dakord për marrëveshjen e paqes?

**Pyetësi:** Po, o shejh, ata tani janë në armëpushim.

**Shejhu:** Sa për "Grupin selefi" unë mendoj se edhe ata duhet të bien dakord për marrëveshjen, sepse sido që të jetë, dalja kundër sundimtarit të shtetit, edhe sikur kufri i tij të jetë i qartë si dielli, ajo dalje ka disa kushte, prej të cilave është që të mos ketë për rrjedhojë dëm më të madh se ai, duke qënë se kryengritësit kanë fuqi për ta hequr atë pa gjakderdhje. Ndërsa, nëse kjo nuk mund të bëhet pa gjakderdhje, atëherë nuk lejohet kryengritja, sepse ai pushtetar i cili gjykon me atë që i thotë kufri i tij, ai ka pasues dhe ndihmues, të cilët nuk e lënë atë.

Pastaj, cili është kandari me të cilin njihet kufri?

A është kandari sipas temperamentit, d.m.th. ai i cili përputhet me temperamentin (karakterin) e njeriut, nuk është kafir, ndërsa ai që nuk përputhet me të, është kafir?! Kush e ka thënë këtë?!

Ai i cili gjykon me kufër për dikë, është vetëm Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Pastaj ai ka disa kushte dhe për këtë shkak i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur foli për sundimtarët e padrejtë dhe shokët i thanë: "A t'i kundërvihemi atyre? Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: "Jo, vetëm nëse shihni tek ata kufër të hapur, për të cilin keni argument nga Allahu." Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi

Por ku është kjo?

Shumë prej vëllezërve, veçanërisht të rinjtë, e kanë gjykimin me kufër për muslimanin diçka natyrore, temperamentale, të pabazuar në shariat dhe të pambështetur në njohjen e kushteve të gjykimit me kufër.

Për këtë shkak, ne i bëjmë thirrje vëllezërve tanë në Algjeri që t'i hedhin armët dhe të hyjnë në siguri! Të rregullojnë aq sa kanë mundësi dhe pa gjakderdhje. Me këtë kemi për detyrë t'i këshillojmë ata dhe atij që i drejtohet këshilla, ai ka për detyrë që të paktën të tregohet i matur dhe të mendojë për atë këshillë, dhe jo ta kthejë mbrapsht atë i bezdisur, me mendjemadhësi e kryeneçësi.

Lusim Allahun që ta shuajë fitnen dhe t'ia largojë këtë brengë vëllezërve tanë në Algjeri!

**Pyetësi:** Ata vëllezërit këtu tek ne mbështeten për kufrin e sundimtarit të tyre në një fetua të vjetër të shejh Nasirudin Albanit, e cila është mbështetur (Allahu e di më mirë) në një realitet jo të saktë. Ata mbështeten në atë fetua, për gjykimin me kufër për sundimtarin e shtetit të tyre. Gjithashtu, gjenden edhe disa nxënës të dijes, te të cilët ata mbështeten për këtë çështje. Për këtë shkak, kur ju u bëtë thirrje atyre për të hedhur armët, duke qënë se ata besonin se sundimtari i tyre është kafir, kjo gjë i rëndoi shumë, iu duk shumë e madhe që të hidhnin armët dhe të ktheheshin nën gjykimin e atij, për të cilin besojnë se është kafir. Kjo është dilema dhe situata e vështirë. Cila është zgjidhja e saj, o shejh?

**Shejhu:** Për Allahun, kjo nuk është dilemë. Së pari të shohim nëse ka prova për kufrin e këtij sundimtari dhe ky vështirim bëhet në dy anë:

E para: Argumenti që kjo gjë është kufër.

E dyta: Vërtetimi i kufrit në lidhje me personin që e ka bërë atë, sepse fjala mund të jetë kufër i qartë, por thënësi i saj nuk bëhet kafir. Ne të gjithë e dimë fjalën e Allahut që thotë: **"Kushdo që humb besimin në Allahun, pasi ka besuar, përveç atij i cili detyrohet në të, kurse zemra e tij është e bindur me besim, ndërsa ata që ia hapin**

**gjoksin kufrit, mbi ta ka zemërim nga Allahu dhe ata do të kenë dënim të madh.**" [En-Nahl: 106].

Kështu që Allahu e ka gritur gjykimin me kufër për atë që detyrohet në të, edhe nëse ai e shpreh mosbesimin.

Gjithashtu, i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka treguar se Allahu i Madhëruar gëzohet me pendimin e robit të Tij më shumë se një burrë i cili gjen devenë e tij të udhëtimit mbi të cilën ka pasur ushqimin dhe ujin e tij dhe kur i humbi shpresat, ai u shtri nën një pemë. Ndërkohë, vjen deveja e tij dhe ai e kap prej kapistre dhe thotë: "O Zoti im! Ti jo rob i im, ndërsa unë jam zoti yt!"

I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: "Gabo i nga gëzimi i madh." Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Po kështu edhe ai personi që ishte... dhe tha: "Sikur Allahu të më kapte, do të më dënonte me një dënim, me të cilin nuk dënon asnjë prej krijesave. Pastaj urdhëroi familjen e tij që kur të vdiste, ta digjnin dhe ta hidhnin hirin e tij në lum. Allahu e bashkoi atë dhe e pyeti se përse e bëri këtë, ndërsa ai i tha: "E bëra këta prej frikës nga Ti, o Zot!"

Megjithatë ai nuk bëri kufër.

Sundimtari mund të ketë të afërm të prishur që e rrethojnë të cilët ia zvogëlojnë gjërat e mëdha, ia bëjnë të lehta dhe ia zbukurojnë atij, kështu që ai vazhdon duke besuar se po ecën drejt në të lejuarën.

Por kjo nuk është kufër dhe nuk mendoj se ndonjë prej algjerianëve thotë: "Po, unë e di se ky është gjyrimi i Allahut në këtë çështje, por unë e kundërshtoj atë". Nuk besoj që këtë ta thotë dikush nga bindja. Ai mund ta thotë në rast debati, por nga bindja e tij, nuk mund ta thotë, sipas asaj që unë mendoj, sepse populli algjerian është popull musliman dhe ai është që i ka nxjerrë francezët me forcë nga toka e tij. Kështu që detyra e këtyre është që ta rishohin çështjen e tyre, të hedhin armët, të bëjnë paqe me popullin e tyre dhe ta hapin thirrjen në fenë e Allahut duke lehtësuar...jo me dhunë!

**Pyetësi:** O Shejhu ynë, Allahu të ruajt, sikur të supozonim se sundimtari është kafir, a kërkon kjo që të ngrihet krye kundër tij, pa kushte?

**Shejhu:** Jo, kushtet duhen patjetër. Unë i përmenda ato më parë.

**Pyetësi:** Po, i përmende.

**Shejhu:** Sikur të supozohej se ai është kafir, ashtu siç duket dielli në mes të ditës së verës, atëherë nuk lejohet dalja kundër tij me armë nëse ajo sjell për rrjedhojë derdhjen e gjakrave dhe lejinin e pasurive.

**Pyetësi:** Disa vëllezër këtu tek ne thonë se përderisa kanë dalë, kanë ngritur armët dhe kanë hyrë në këtë luftë kundër këtij sistemi, ata sot edhe nëse do të bindeshin se ky nuk është xhihad, sepse ata, siç e thatë ju, nuk i kanë plotësuar kushtet, por megjithatë pyesin: A munden që të vazhdojnë edhe nëse janë të bindur se do të shuhen e do të vriten, apo të emigrojnë, apo çfarë?

**Shejhu:** Për Allahun, kjo nuk lejohet. Për Allahun, atyre nuk u lejohet që ta vazhdojnë më këtë luftë, sepse ajo është një luftë shterpë e cila nuk ka asnjë dobi dhe nuk lind vetëm se të keqe e të këqinj.

**Pyetësi:** Po, po. O shejhu ynë, ju nuk besoni se sundimtari i Algjerisë është kafir, pra. Nuk mendoni kështu?

**Shejhu:** Ne nuk mendojmë për asnjë që ai është kafir, përveç atij që ka quajtur kafir Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) si dhe për atë mbi të cilin janë plotësuar kushtet e kufrit, në çdo vend dhe për çdo njeri qoftë. Gjykimi me kufër nuk është në dorën tonë dhe as te ne, por ai është tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse një person e quan kafir vëllanë e tij, ndërsa ai nuk është kafir, atëherë ajo i kthehet atij dhe ai bëhet kafir, vetëm nëse pendohet.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, disa vëllezër këtu, pasi pranuan që ky nuk është xhihad sipas asaj që ju thatë, nuk kanë besim tek qeveria, pjesërisht, kështu që pyesin nëse iu lejohet atyre të qëndrojnë nëpër male duke mos u kthyer në jetën e qytetëruar dhe pa luftuar kënd, pra të qëndrojnë në mal bashkë me armët e tyre, por ta ndalojnë luftën dhe të mos kthehen në jetën e qytetëruar?

**Shejhu:** Ata nuk kanë për të qëndruar në këtë gjendje, sido që të jetë dhe patjetër që një ditë prej ditësh shpirti i tyre do t'i ngacmojë ata derisa të sulmojnë banorët e fshatrave e qyteteve, sepse njeriu është i civilizuar në natyrën e tij.

Ata mund të rrinë në majat e maleve, duke pasur me vete armë?

Patjetër që një ditë prej ditësh atyre do t'iu ndezen shpirtrat dhe do të bëhen kusar rrugësh.

**Pyetësi:** Atëherë, atyre nuk u lejohet të vazhdojnë në këtë gjendje?

**Shejhu:** Kjo është ajo që mendoj unë. Unë them se ata duhet të zbresin në qytete e fshatra tek familjet dhe shokët e tyre.



**Pyetësi:** D.m.th., tani e kanë të gjithë për detyrë, në rast se komanda nuk i përgjigjet thirrjes tuaj, nëse nuk i përgjigjen komandantët e luftëtarëve thirrjes tuaj, atëherë ç'duhet të bëjë çdo luftëtar me veten e tij?

**Shejhu:** Obligimi i çdokujt është të hedhë armën dhe të mos i bindet prijesave të tyre nëse ata i urdhërojnë për të ndaluara, sepse nuk ka bindje ndaj krijesës në kundërshtim të Krijuesit.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, a lejohet kundërshtimi i thirrjes tuaj për shkak të fetuave të ndonjë thirrësi tjetër?

**Shejhu:** Kjo kthehet tek vetë personi. Nëse ai beson se ajo që thonë ata njerëz, të cilët thërrasin në vazhdimin e kësaj lufte është e vërteta, atëherë ata nuk e kanë për detyrë që të kthehen, por njeriu duhet të meditojë, të mendojë dhe të shohë se cili është rezultati i vazhdimit të saj. Sa vjet i janë bërë popullit algjerian duke kaluar katastrofë pas katastrofe pa përfituar asgjë?!

**Pyetësi:** Kujtojmë që këta thirrës që përmenda, thirrës jo të njohur e me emër, si palestinezi Ebu Katade, i cili jeton në Britani. A e njihni atë, o shejhu ynë?

**Shejhu:** Nuk e njohim atë.

**Pyetësi:** E njihni?!

**Shejhu:** Jo.

**Pyetësi:** Po Ebu Musab es-Surin, a e njihni?

**Shejhu:** Asnjë prej këtyre nuk e njohim, por unë të them ty se disa njerëz, dhe nuk kam për qëllim këtë apo atë, nëse shohin që të rinjtë grumbullohen pas tyre, atëherë ata veçohen me diçka që t'u përmendet emri, si i thonë asaj fjalës: "Një kundërshtues që kërkon të përmendet".

**Pyetësi:** O shejhu ynë, prej tyre është një person i cili quhet Ebu Hanife el Aritiri dhe ai thotë se është nxënësi juaj. Gjithashtu thotë se lidhja telefonike me ju është diçka shumë e vështirë dhe se ju jeni të rrethuar nga agjentët sekretë të shtetit (shiku) e të tjera si këto. Prej kësaj, vëllezërit këtu, (d.m.th vëllezërit luftëtarë) besojnë se lidhja telefonike me ju është diçka ndërmjet të pamundurës dhe të vështirës, duke u bazuar në fjalën e këtij njeriu. A është e vërtetë kjo gjë?

**Shejhu:** Kjo nuk është e vërtetë. Përherë njerëzit vinë tek ne dhe flasin me ne në telefon. Ne rrugën nga xhamia në shtëpi, e cila zgjat rreth dhjetë minuta, e përshkojmë duke ecur në këmbë dhe të gjithë vijnë... ecin. Edhe mësimet, el hamdu lil-lah, janë të vazhdueshme dhe ne themi ç'të duam për atë që mendojmë se është e vërteta.

**Pyetësi:** Po këtë Ebu Hanife el Aritirin a e njihni?

**Shejhu:** Për Zotin, tani nuk e kujtoj, por ndoshta po ta shihja, do ta njihja. Por fjala e tij është gënjeshtër dhe nuk ka asnjë bazë saktësie...

Pas një dialogu ndërmjet tyre dhe shjehut rreth atyre që janë vrarë dhe për shtyerjen e dialogut, shejhu tha: Sikur ta shtynim këtë dialog për pas Ramazanit, nëse ka mundësi?

**Pyetësi:** O shejh, kjo është e pamundur, sepse çështja është në majë të gjëmbave, siç e shihni, është çështje gjakrash dhe çështje populli!

**Shejhu:** Atëherë e shtyjmë për nesër...

Pastaj hyri një pyetës tjetër dhe tha: O shejh, sikur të na jepje tani edhe pesë minuta për një pyetje të fundit?

**Shejhu:** Mirë.

**Pyetësi:** Vëllezërit tanë të "Grupit Selefi për Thirrjen dhe Luftën" iu duan juve dhe shohin tek ju se ju jeni prej dijetarëve tanë, pasimin e të cilëve e kemi obligim, por...

**Shejhu:** Allahu ua shpërbleftë me të mira!

**Pyetësi:** Ekzistojnë disa pyetje, të cilat sillen në kokat e tyre, prej të cilave është: Nëse ne do t'i dërgonim shejhut kasete videoje për t'i treguar se ne nuk vrasim fëmijë, nuk vrasim pleq dhe nuk bëjmë shpërthime nëpër qytete, por ne luftojmë vetëm ata që na luftojnë, prej atyre të cilët nuk gjykojnë me Librin e Allahut në mesin tonë, atëherë shejhu, d.m.th pasi ta shohë se akideja jonë është e pastër, metodologjia jonë është e pastër dhe lufta jonë e pastër, fetuaja e tij do të ndryshonte.

Cila është fjala juaj për këtë, Allahu ua shpërbleftë me të mira?

**Shejhu:** Jo. Fjala ime është se fetuaja nuk ndryshon, sido që të jetë qëllimi i luftëtarit, sepse ajo ka për rrjedhojë gjëra të mëdha, vrasje të njerëzve të pafajshëm, lejimin e pasurive të muslimanëve, rrëmujë etj!

**Pyetësi:** O shejhu ynë, Allahu të ruajt, nëse ngjitja jonë në male ka qënë e mbështetur në disa fetua, edhe pse siç tha vëllai, u bë i qartë gabimi i tyre, sikur ato fetua të ishin prej dijetarëve dhe disa prej atyre fetuave kanë qënë të disa thirrësave të cilat na kanë bërë të mendojmë se ato janë argument për ne që të luftojmë, atëherë u ngjitëm në male dhe luftuam për vite me radhë. Cili është roli i shoqërisë në lidhje me të sjellurit me ne? A do të sillen me ne sikur të ishim kriminelë, apo si muxhahidinë që kemi gabuar në këtë rrugë?

**Shejhu:** Ti e di që në çdo lloj shoqërie nuk mund të bashkohen të gjithë individët e saj në një mendim të vetëm, kështu që njerëzit në lidhje me ju do të jenë tre llojesh:

- Një grup do t'i urrejë këta luftëtarë dhe do të thotë se ata sollën shkatërrime, vranë njerëzit dhe prishën pasuritë. Ata nuk kanë për t'u kënaqur me ju, vetëm se pas një kohë të gjatë.

- Një grup tjetër do të jenë të kënaqur me ta dhe do t'i përgëzojnë, madje nëse ata i hedhin armët, mund t'i qortojnë.

- Ndërsa grupi i tretë do të heshtë dhe do të thotë se këta komentuan dhe gabuan, dhe nëse kthehen, atëherë kthimi tek e vërteta është virtyt.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, Allahu të ruajt, duam një fjalë këshilluese drejtuar të dyja palëve, kam për qëllim vëllezërit që do të kthehen në jetën e civilizuar dhe në mesin e shoqërisë. Si të veprojmë e të sillemi tani, që të harrojnë urrejtjet? Duam një këshillë në lidhje me këtë, Allahu ju ruajt!

**Shejhu:** Allahu ju begatoftë! Unë them se obligim është që muslimanët të jenë vëllezër dhe nëse hiqen shkaqet e kundërshtimit dhe armiqësisë, atëherë ta largojmë urrejtjen dhe të kthehemi tek ajo që kemi për detyrë të jemi, prej dashurisë dhe bashkimit, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: **"Besimtarët janë vëllezër, kështu që pajtoni ndërmjet vëllezërve dhe kini frikë Allahun!"** [El Huxhurat: 10].

I kërkojmë Allahut të na japë sukses dhe qëllim të së vërtetës! Po ju a vazhdoni të keni dëshirë për t'u lidhur përsëri nesër, apo jo? Ndërsa tani po e shkëpusim dhe nuk mund të shtojmë më shumë...

Të nesërmen në kohën e takimit, pyetësi tha: E rëndësishme është që të përqendrohemi në pikat më të rëndësishme, të cilat mund të ndikojnë tek vëllezërit këtu, (d.m.th tek luftëtarët), me qëllim që të kthehen tek e vërteta.

**Shejhu:** Shumë mirë! Mbështetiu Allahut dhe fillo!

**Pyetësi:** Inshallah! Çështja më e rëndësishme është pretendimi i tyre se gjoja ju nuk e dini realitetin tonë këtu në Algjeri dhe se dijetarët në përgjithësi nuk e dinë realitetin në Algjeri dhe sikur ju ta dinit që ne jemi selefi, ju do ta ndryshonit fetuanë tuaj. A është e vërtetë kjo?

**Shejhu:** Kjo nuk është e vërtetë dhe ne ju përgjigjëm dje kësaj kur thamë se sido që të jenë zmadhimet e çështjes dhe qëllimet e luftëtarëve, derdhja e gjakut është e vështirë dhe obligimi i tanishëm është ndalimi nga kjo dhe hyrja në paqe.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, cili është mendimi juaj për atë që beson se kthimi në jetën e civilizuar konsiderohet dalje nga feja?

**Shejhu:** Pamë më parë se ai që thotë këtë, shembulli i tij ka ardhur në hadithin e saktë se ai që quan kafir një musliman, apo i thërret një burri: "O kafir", ndërsa ai nuk është i tillë, atëherë ajo i kthehet atij.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, cili është mendimi juaj për fjalën e tyre se nuk ka armëpushim, as pajtim dhe as dialog me ata që kanë dalë nga feja?

**Shejhu:** Pamë që këta nuk kishin dalë nga feja. Nuk lejohet të themi se ata kanë dalë nga feja pa u vërtetuar kjo gjë sipas shariatit.

**Pyetësi:** Ku është bazimi për këtë, o shejhu ynë?

**Shejhu:** Bazimi për këtë është se ata falen, agjërojnë, bëjnë me të drejtë, haxhin dhe umran, dhe dëshmojnë se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

**Pyetësi:** Po, po, o shejhu ynë.

**Shejhu:** Atëherë si mund të themi në këtë gjendje se ata janë kufarë?! I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i tha Usame ibën Zejdit kur ai vrau një burrë ... me shpatë, ndërkohë që ai dëshmoi se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, atëherë i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e qortoi Usamen për këtë edhe pse ai burri e kishte thënë këtë për t'u mbrojtur, siç mendoi Usame. Kjo histori është e njohur.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, tani kemi një pyetje në lidhje me akiden, d.m.th për çështjen e dallimit ndërmjet kufrit me vepër dhe kufrit me bindje, në lidhje me gjykimin jo me atë që ka zbritur Allahu?

**Shejhu:** Për shembull: kush e lë namazin, ai është kafir, kush bën sexhde për idhullin, ai është kafir, kush thotë se bashkë me Allahun ka krijues tjetër, ai është kafir. Këto janë kufër me vepër. Ndërsa kufri me bindje është në zemër.

**Pyetësi:** O shjehu ynë, A të nxjerr nga Islami kufri me vepër?

**Shejhu:** Ka prej tij që të nxjerr nga Islami dhe ka prej tij që nuk të nxjerr. Siç është vrasja e besimtarit për të cilin i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Vrasja e tij është kufër", megjithatë, ai që vret vëllanë e tij besimtar nuk del nga Islami, duke u argumentuar me ajetin në suren Huxhurat: "**Nëse dy grupe nga besimtarët luftojnë me njëri-tjetrin, atëherë pajtoni ndërmjet tyre!**" Pastaj tha: "**Besimtarët janë vëllezër, kështu që pajtoni ndërmjet vëllezërve tuaj!**" [El Huxhurat: 9-10].

**Pyetësi:** Kur kthehet kufri me vepra në kufër me bindje, o shejhu ynë?

**Shejhu:** Kur njeriu i bën sexhde idhullit, ai bën kufër që të nxjerr nga Islami, me përjashtim nëse është i detyruar në të.

**Pyetësi:** Po në çështjen e të gjykuarit me ligj tjetër për atë që ka zbritur Allahu?

**Shejhu:** Kjo është një temë e gjerë. Ai mund të gjykojë me ligj tjetër nga ai që ka zbritur Allahu duke bërë padrejtësi e armiqësi, por duke e pohuar që Ligji i Allahut është i vërteti, ky nuk bën kufër që të nxjerr nga populli musliman. Dikush mund të gjykojë me ligj tjetër nga ai që ka zbritur Allahu duke pasuar dëshirën apo favorizimin e vetes së tij apo të të afërmëve të tij, pa pasur për qëllim t'i bëjë padrejtësi të gjykuarit... dhe as mospëlqimin e ligjit të Allahut, ky nuk del nga populli musliman, por ai është i prishur. Dikush tjetër mund të gjykojë me ligj tjetër nga ai që ka zbritur Allahu, duke e urreyer ligjin e Allahut, ky është kafir dhe ka dalë nga mileti musliman. Ndërsa, dikush tjetër mund të gjykojë jo sipas asaj që ka zbritur Allahu, duke qenë se ai është përpjekur të gjejë ligjin e Allahut, por ai gaboi në kuptimin e tij, ky nuk bën kufër, madje as nuk merr gjynahe, sepse i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) thotë: "Nëse gjykatësi përpiket dhe gabon në gjykimin e tij, ai ka një shpërblim dhe nëse ia qëllon, ai ka dy shpërblime."

**Pyetësi:** O shejhu ynë, tek ne për shembull, ndodhet një xhami, e cila për fat të keq është shndërruar në kazermë ushtarake, në të cilën pihet alkool, dëgjohet muzikë, nuk falet në të namazi dhe shahet brenda saj Allahu dhe i Dërguari i Tij. Cili është gjykimi për këtë?

**Shejhu:** Kjo është fusuk (prishje, vepër e keqe), sepse nuk lejohet shndërrimi i xhamisë në kazermë ushtarake, sepse ky është shndërrim i Uakëfit nga vendi i tij dhe moskryerja e faljes në të.

**Pyetësi:** O shejhu ynë, fjala juaj ishte e qartë (el hamdu lil-lah) dhe me këto shprehje do të hiqen (inshaAllahu) të gjitha dyshimet, të cilat pengojnë që e vërteta të triumfojë (inshaAllahu)!

**Shejhu:** Lusim Allahun që t'i udhëzojë ata dhe t'u japë sy për të kuptuar fenë e tyre dhe lusim Allahun të ruajë gjakun e muslimanëve!

**Pyetësi:** A na e shpjegoni fjalën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): "Kush nga ju sheh një të keqe, atëherë ta ndryshojë atë me dorën e tij..."?

**Shejhu:** Nuk ka kohë, sepse na ka mbetur vetëm një minutë.

**Pyetësi:** Na jepni datën e kësaj telefonate dhe emrin tuaj!

**Shejhu:** Kjo telefonate u zhvillua në ditën e xhuma, në muajin e Ramazanit. Atë e zhvilloi me vëllezërit e tij Muhamed ibën Salih El Uthejmin nga Unejze e Mbretërisë së Arabisë Saudite, në vitin 1420 h. Lusim Allahun që të bëjë dobi me këtë!

Nga kjo telefonatë na bëhet e qartë se një rrymë haurixhësh hyri në zemrat dhe mendjet e nxënësve të vegjël të dijes, të cilët e përshpejtuan belanë dhe në duart e tyre ndodhën ngjarje të mbushura me trazira, për shkak të së cilave u derdhën gjakra dhe u shkelën ndere, dhe tek Allahu ankohemi!

\*\*\*

### Kapitulli i pestë

#### Fitneja i është autorizuar tre personave

Ata që i kundërshtojnë fjalët e dijetarëve, disa prej të cilave i përmendëm më parë, sipas mendjes të tyre dhe pasimit të verbër, ata janë të pavëmendshëm nga udhëzimet dhe vendimet e dijetarëve, të pavëmendshëm nga njohja e fitneve sipas sheriatit dhe Ligjit të Allahut në breza e popuj, të pavëmendshëm në njohjen e Ligjeve të Tij për ndryshimin e gjendjes së tyre. Kështu, për shkak të injorancës së tyre, ata shkaktuan ndodhjen e asaj e cila nuk ka përfundime të mira, as nuk e lavdëron sheriatin, as nuk e pëlqen Allahu. Ata shkaktuan ngushtimin e thirrësave të singertë, të cilët ndjekin rrugën e dijetarëve, për shkak të lejimit të daljes kundër pushtetarëve, derdhjes së gjakut, vrasjes, shkatërrimit e përmbysjes, gjë e cila është prej shkatërrimit të qartë e të dukshëm për çdokënd. Nuk di se si logjikojnë ata (sidomos drejtuesit dhe të mëdhenjtë e tyre), pas pushimit prej atyre fitneve të mëdha. A do të vazhdojnë në qëndrimin e tyre apo nuk e dinë se ç'krime kanë bërë me duart e tyre? Ndoshta Allahu ua ka marrë shikimin për shkak të tepërimit në ndjekjen e dëshirave dhe mendjeve të tyre, saqë ata nuk dinë se ç'kanë bërë?!

Çdokush prej tyre duhet të meditojë gjatë në hadithin me zinxhir transmetimi të mirë të transmetuar nga Hudhejfe ibën el Jeman (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), në të cilin thuhet:

"Fitneja i është autorizuar tre personave: Të ashpërit ekspert, të cilit nuk i ngrihet gjë përpara, vetëm se e pret me shpatë; predikuesit, i cili thërret në të dhe zotëriut. Dy të parët ajo i hedh përmbys me fytyrë në tokë, ndërsa zotëriun e kërkon derisa të përmbysë atë që posedon."

Në një transmetim tjetër thuhet: "dhe fisnikun" në vend të "zotëriut" apo: "Të ashpërin ekspert ajo e rrëzon përtokë, ndërsa këta dy të tjerët i kërkon, derisa të shkatërrojë atë që posedojnë."

Përsa i përket ekspertit, ai është person i shkathët, i cili sheh në çdo gjë. Fitneja i autorizohet atij, nëse ai është i egër, jo i butë, dhe i padurueshëm. Ai kërkon që ta arrijë të mirën, thjesht duke qëndruar dhe duke e njohur atë, por pa ndjekur rrugën e selefëve dhe Ligjin e Allahut për ndryshimin e gjendjes së popujve. Ai nuk hedh vështrimin në pasojat e veprave dhe rrjedhojat e çështjeve, pa të cilat nuk i lejohet askujt që t'i përballet fitnes dhe as të hyjë në të.

Kjo përfshin edhe ata të cilët e admirojnë atë (ekspertin e ashpër), sugjerimet dhe vendimet e tij, duke u bërë pjesëtarë në fitne me nderin dhe sovranitetin tyre, me fjalët dhe predikimet, me artikujt, shkrimet, revistat, gazetat dhe institucionet e tyre. Fitneja i sprovon ata dhe shkatërron atë që ata posedojnë.

Predikuesi dhe ai i cili thërret në fitne është më afër saj sesa fisniku admirues, të cilin e kanë verbuar stilitë dhe e kanë mashtruar parullat. Nëse ai do të meditonte e do të tregohej i matur, nëse do të vëzhgonte, mendonte, planifikonte e të llogariste mirë, ndoshta do të shpëtonte prej saj, nëse do ta pengonte atë mëshira e Zotit të tij dhe të dilte nga thirrja e preferencave të tij.

Shembulli i cili vazhdon të jetë i ngritur para nesh, zhurmën e të cilit vazhdojmë ta dëgjojmë dhe me zjarrin dhe flakët e tij vazhdojmë të digjemi, është fitneja e madhe, shumë e madhe, çelja e së cilës nuk lulëzoi, por u ngrit kundër muslimanëve, madje të gjithë muslimanëve, për shkak të të rinjëve të zjarrtë e entuziastë, të cilët nuk dinë t'i përcaktojnë rrjedhojat e mira e të këqia, nuk i peshojnë ato me kandarin e dijetarëve dhe nuk i japin peshë kushteve të konsideruara nga dijetarët. Kështu që ngritën një kryengritje të papeshuar, nga i cili rrodhën rezultate të rrezikshme dhe u ngritën zëra të cilat akuzonin "thirrjen selefije" me diçka nga e cila ajo është e pastër, sepse këta të rinj nuk ndoqën rrugën e selefëve për ndryshim, as nuk u mbështetën në vendimet e dijetarëve të mëdhenj të kësaj thirrjeje të begatë.

Ata i mashtroi entuziazmi i tyre dhe për pasojë nuk dinin të përcaktonin fuqinë e tyre, as tërheqjen graduale për në kurrthet e armikut, as detyrën e kohës së tyre, kështu që u bënë pjesëtarë të fitnes me rebelim dhe sipas metodës së atyre që ndjekin entuziazmin dhe daljen kundër pushtetarëve. Kjo bëri të nevojshme zbulimin e shijeve, rrugëve metodologjike dhe shkollat ideologjike e të akides, në të cilat janë edukuar këta kryengritës.

Vlen të përmendim këtu se këto ngjarje bënë që disa "zotërinj" dhe "fisnikë", si dhe disa "predikues" e të ngjashëm me ta, të cilët kanë pasur vend të "të ashpërit ekspertë" (të cilët janë përmendur në hadithin e mësipërm), të kthejnë edhe një herë shikimin në



qëndrimet e tyre, sepse fitneja i ka kërkuar dhe i ka sprovuar ata, ndërsa të tjerë i ka përplasur me turinj në tokë.

Disa prej atyre të cilëve iu shfaqën rrjedhojat makabre të veprave të këtyre, iu drejtuan kritikës dhe dënimit të asaj që po ndodh. Ata publikuan në faqe të shumta e të ndryshme të internetit një deklaratë, në të cilën shfaqnin mendimin dhe qëndrimin e tyre në lidhje me veprën e këtyre kryengritësve.

Dr. Seferi, u tregua vërtet i hapur dhe guximtar në drejtimin e kritikës së tij, gjë e cila zbulon kuptimin e plotë të rrezikshmërisë së gjendjes. Ai e filloi fjalën e tij me muxhahidinët në Afganistan, pastaj u drejtua nga mbetjet e tyre pas rënies së "Talebanëve" dhe shfaqjes së "shtetit të njerëzve me dy flamuj", prej atyre të cilët u shpërndanë në të gjitha vendet dhe në duart e tyre ndodhën ankthet, shpërthimet dhe trazirat të cilat u konkretizuan, në mendimin e shtypit, me dy sulmet e Nju Jorkut dhe Uashingtonit, dhe Allahu e di më të vërtetën e gjërave.

Dr. Seferi thotë duke sqaruar mburrjen e tyre mbi bijtë e tjerë të popullit:

"Sikur muxhahidinët të kapeshin për Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ashtu siç duhet (prej të cilave është edhe konsultimi me ata që u intereson çështja dhe lënia e tiranisë kundër pjesës tjetër të popullit musliman), atyre do t'u ishte realizuar prej disfatës së armikut dhe fuqisë kompetente, atë që bën dobi dhe nuk bën dëm. Atëherë, nuk do t'i lejohej askujt që t'i kundërshtonte ata, përveç ndonjë hipokriti të njohur."

Ai thotë gjithashtu në sqarimin e anës shpirtërore për mendimet dhe sjelljet e tyre:

"Edukatorët dhe rregulluesit, duhet ta kuptojnë rëndësinë e madhe të studimit të historisë profetike dhe nxjerrjen e fazave të thirrjes prej saj, duke pasur parasysh ligjet e shfuqizuar dhe gjendjet fazore. Të njohin vendin e xhihadit dhe rregullat e tij në çdo fazë. Ata duhet të kujtojnë gjithnjë se shpirti islam në këto kohët e fundit ka një kundërpërgjigje të pamatur. Ai preferon të hyjë në luftë tani, ose të paguajë gjithçka që posedon në një çast prekshmërie, edhe pse kjo është shumë pak e dobishme, me qëllim që të ndjekë një program apo plan për t'i shërbyer fesë me një shërbim të përgjithshëm pas një viti, me mund të përhershëm apo me shpenzim të vazhdueshëm."

Gjithashtu ai thotë: "Çiltërsia me këta dhe dhënia e lirisë atyre kundrejt asaj që ata ofrojnë si dhe dialogimi me ta sipas rregullit të krahasimit të dobive dhe dëmeve në sheriat, është e vetmja zgjidhje, sepse përndryshe do të hyjmë në një qorrsoak të pafund. Ajo që argumenton më shumë për këtë gjë, është njohja e shkaqeve të depërtimit të tejkalimit në mendjen dhe veprën e disave prej tyre..."

Ndërsa për zbulimin e realitetit të gjendjes së tyre Dr. Seferi thotë:

"Pastaj, nuk ballafaqohet me xhihadin dhe nuk mbart emrin dhe përshkrimin e tij, vetëm se disa grupe të shpërndara, të cilat nuk kanë flamur, as menhexh dhe as edukatë. Nëse ata veprojnë diçka ashtu siç duhet, ajo është prej Allahut dhe nëse veprojnë keq, ajo është për shkak të pakujdesisë dhe neglizhencës sonë, bashkë me pakujdesinë dhe neglizhencën e tyre."

Ndërsa për krimin e madh të tyre mbi popullin musliman thotë:

"Nuk i lejohet këtij grupi dhe asnjë grupi tjetër, t'i tërheqë popullit armiqësi, së cilës nuk i bëjnë dot ball, e cila e tërheq atë në një luftë jo të barabartë për të cilën populli nuk është përgatitur dhe as nuk e ka pritur. Kjo është ajo me të cilën ngremë zërin, por nëse ai grup refuzon dhe ngul këmbë në tiraninë dhe autokracinë e tij, pastaj vepron ashtu si t'i thotë mendja e tyre, pa u konsultuar, pa marrë parasysh dobitë e dëmet, atëherë ne do të jemi të pafajshmit dhe ne do të jemi viktimat të hakmarrjes së armikut grabitqar. Kjo është ajo që do të ndodhë edhe me popullin e Afganistanit e të tjerë."

Ndërsa, për raportimin e injorancës dhe vetëmashttrimin e tyre ai thotë:

"Mund të ketë argumente që vërtetojnë se disa të rinj të këtij vendi (Saudisë) të kenë pasur dorë në ato që ndodhën, por nuk ka argument dhe as dyshim se plani dhe dështimi i tij në ngjarjet e ndodhura, është më i madh sesa mund ta imagjinojnë mendjet e këtyre djelmoshave të rinj, shumica e të cilëve nuk janë larguar nga vendi vetëm se para pak muajsh."

Në plotësimin e fjalës së tij, duke zbuluar një të vërtetë të rrezikshme e cila është se ata janë viktimat të mashtimit" ai u shpreh:

"Hytbet e rregullta, artikujt, vërtetimet e gjëra të bëra në vendin tonë për aksidentin, të bëjnë të kuptosh se akuzat janë të vërteta dhe se pasojat kanë qenë të qëllimshme. Ndërsa këta djelmosha i përshkruajnë sikur janë djajë të lindur për sherr, të cilët nuk kanë qëllim tjetër përveç prishjes së paqes botërore dhe ushtrimit dhunë mbi të pafajshmit. Këto janë largim nga logjikimi i drejtë dhe nga ideja për mbrojtjen e vendit dhe bijve të tij, si dhe keqbërje e madhe ndaj ndjenjave të familjeve dhe fiseve të tyre. Këto mohojnë dukshëm edhe deklaratat e përgjegjësve të shtetit, të cilat nuk kanë shtuar më tepër sesa të përshkruarit e tyre si "viktimat të mashtimit". Kështu ishte deklarata e ministrit të brendshëm, i cili është më së shumti i ka ndjekur ata dhe është më i njohuri me motivet shtytëse të tyre."

Pastaj vazhdoi të fliste për devijimet e këtyre të rinjëve në akide, gjë e cila përforcon lidhjen e asaj që ata bëjnë me ideologjinë e hauarixhëve, e cila është dhe aktivizuar nga Iraku duke vazhduar të ndodhë në ngjarje e shpirtra, derisa mbërriti tek ata. Ai thotë:

"Tejkalimi i shtyu ata të quanin kafira të tjerët, prej të cilit ka qënë edhe quajtja kafira e vetë shoqërive muslimane."

Pastaj tha: "Në Afganistan u takuan vullnetarët e ardhur nga çdo vend, madje edhe nga vetë Egjipti, pa menhexh dhe pa organizim, me këta të cilët mbartin menhexh për ndryshim e gjendjes, ide, organizim dhe heqje e përpjekje të gjata. Kështu që u ndikuan disa prej të rinjve prej tyre, me disa kundërshtime midis njëri-tjetrit, pastaj u dalluan në tejkalim apo në bindjen për përdorimin e dhunës."

Pastaj pyeti: "Si mundi të futet tejkalimi dhe imitimi i dhunës tek disa prej tyre, për ta kaluar atë në vendin dhe shoqërinë e tij, ndonjëherë?"

Pastaj u përgjigj sipas mendimit dhe përpjekjes së tij, përgjigje e cila nuk nuk del nga kufijtë e komentimit historik, i cili kam frikë se është një lloj të justifikuari me caktimin e Allahut në kozmos.

Në përzgjedhje të fjalës së tij, unë them se përgjigja është e lehtë dhe e thjeshtë; mjafton që dr. Seferi të zgjasë dorën në bibliotekën e tij për të nxjerrë një nga librat e Sejid Kutubit dhe të qëndrojë ndërmjet faqeve të teksteve të shumta ndërmjet të cilave është futur tejkalimi dhe imitimi i dhunës në mendjet dhe sjelljet e rinisë së popullit të edukuar sipas atyre librave!!

Mjafton që doktori të përtërijë leximin e atyre teksteve me syrin e drejtësisë dhe hakut, që të zbulojë se ajo që i shtyu ata për "tiraninë kundër popullit" dhe largimin nga dijetarët e tij, madje në sharjen dhe mendimin e keq për ta, ndoshta edhe në quajtjen e tyre kafira, ajo shtyrje ka ardhur pikërisht nga ato tekste kutubije, të cilat mbollën tek ata shpirtin e kryengritjes mbi popull dhe përbuzjen e përgjegjësive të tij; kam për qëllim dijetarët.

Mjafton të përmend këtu disa shembuj prej atyre teksteve:

Së pari: Në përhapjen e shpirtit revolucionar dhe tiran ndaj popullit islam, sipas kuptimit të përgjithshëm dhe shoqëror të popullit:

Sejid Kutub në librin e tij "Shenja në rrugë" shpreh qartë se të gjitha shoqëritë e sotme islame janë shoqëri injorante (paraislame), pa asnjë përjashtim:

"Së fundi, në strukturën e shoqërisë injorante (paraislame) hyjnë edhe ato shoqëri të cilat i thonë vetes se janë muslimane. Këto shoqëri nuk hyjnë në këtë strukturë, sepse ato besojnë hyjnimin e dikujt tjetër përveç Allahut, as sepse ato ia dedikojnë ritet e adhurimit dikujt tjetër përveç Allahut, por ato hyjnë në këtë strukturë (në strukturën e shoqërisë paraislame), sepse ato nuk e ushtrojnë adhurimin e Allahut, Një e të Vetëm në sistemin e jetës së tyre... Qëndrimi i Islamit ndaj këtyre shoqërive injorante, ndaj të gjitha atyre, përkufizohet me një shprehje të vetme: Islami e refuzon pranimin e të qënurit islam për të gjitha këto shoqëri."

Këtë gjë e përforcoi me mohimin e ekzistencës së Islamit në faqen e dheut, duke thënë:

"Kur ballafaqojmë të gjithë faqen e dheut sot, para kësaj paraqitjeje hyjnore të të kuptuarit të Fesë Islame, nuk gjejmë ekzistencë të kësaj Feje. Ekzistenca e saj ka mbaruar që atëherë kur shoqëria e fundit muslimane hoqi dorë nga veçimi i Allahut me qeverisje në jetën njerëzore. Ajo ka qenë dita në të cilën ato hoqën dorë nga të gjykuarit vetëm me sheriatin e Tij në të gjitha lëmitë e jetës.

Këtë realitet të dhimbshëm duhet ta pohojmë, ta shfaqim hapur dhe të mos i frikësohemi zhgënjimit, të cilin ai ngjall në zemrat e shumë njerëzve të cilët dëshirojnë të jenë muslimanë!

Këta kanë të drejtë që të sigurohen, si mund të jenë muslimanë?!

Armiqtë e kësaj feje kanë bërë për shekuj të shumtë dhe vazhdojnë të bëjnë orvajtje të mëdha, dinake e të këqia për të shfrytëzuar keqardhjen e të shumtëve të cilët dëshirojnë të jenë muslimanë, nga ndodhja e këtij realiteti të hidhur, nga përballimi i tij në dritë, si dhe nga ngushtimi i tyre për përhapjen e lajmit se: Ekzistenca e kësaj Feje ka ndaluar që kur shoqëria e fundit muslimane hoqi dorë nga zbatimi i sheriatit të Allahut në të gjitha çështjet e tyre..."

Sejid Kutub e përforcon quajtjen kafira të muslimanëve, bashkë me ata ndërmjet tyre të cilët ngrenë zërat e tyre me ezanin pesë herë në ditë. Kur thotë:

"Koha u kthye mbrapsht, si gjendja e asaj dite në të cilën kjo Fe i zbriti njerëzimit. Njerëzimi u kthye në gjendjen që ka qenë atë ditë kur ky Kuran i zbriti të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe si në atë ditë kur erdhi Islami me bazën e tij më të madhe: Dëshminë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.

Koha u kthye mbrapsht, si gjendja e asaj dite në të cilën kjo Fe i erdhi njerëzimit me "La ilahe il-Allah". Njerëzimi doli nga feja për në adhurimin e krijesave dhe në padrejtësinë e feve, duke u tërhequr nga "La ilahe il-Allah", edhe nëse një pjesë e saj vazhdon të përsërisë nëpër minare: "La ilahe il-Allah", pa e ditur domethënien e saj, pa pasur për qëllim domethënien e saj kur e thonë dhe pa e refuzuar ligjërimin e të gjykuarit të cilin krijesat thonë se ai u takon atyre, ndërsa ai është sinonim i hyjnëzimit, qoftë nëse e thonë si individë, si formacione ligjëvënëse apo si popuj. Sepse si individët, formacionet apo popujt, nuk janë hyjni, kështu që atyre nuk u takon e drejta e qeverisjes dhe ligjëvënies...

Por njerëzimi i është kthyer injorancës dhe ka dalë nga "La ilahe il-lallah", duke u dhënë këtyre krijesave veçoritë e hyjnëzimit. Ata nuk e njohin më Allahun dhe nuk duan më për hir të Tij.

Krejt njerëzimi, bashkë me ata të cilët thërrasin nëpër minaret nga Lindja në Perëndim fjalët: "La ilahe il-Allah", pa domethënie dhe pa realitet... Këta kanë gjynah më të rëndë

dhe dënim më të fortë në Ditën e Kiametit, sepse ata u kthyen tek adhurimi i krijesave pasi që iu bë e qartë atyre e vërteta dhe pasi që ishin në Fenë e Allahut!

Sa nevojë të madhe kanë pasardhësit e muslimanëve sot që të qëndrojnë gjatë para këtyre provave të qarta!"

Sejid Kutub thërret në ndarjen nga shoqëria muslimane, sepse sipas bindjes së tij, ajo është një shoqëri injorante, e cila nuk ka asnjë lidhje me Islamin. Ai thotë:

"Nuk ka shpëtim për pasardhësit e muslimanëve në çdo vend, nga rënia mbi ta ky dënim: **"ose t'iu mbulojë me ngatërresa në luftë grupesh dhe t'iu bëjë që të shijoni urrejtje e dhunë nga njëri-tjetri."** [El En'am: 65], vetëm duke u ndarë ky gjak muslimani me akiden, ndjenjat dhe mënyrën e të jetuarit, nga injorantët prej popullit të tij, derisa Allahu t'u lejojë atyre ngritjen e shtetit Islam, në të cilin do të strehohen. Atëherë do ta ndjejnë plotësisht se ata janë populli musliman dhe se çdo gjë dhe kushdo që është përreth tyre dhe që nuk kanë hyrë në atë që kanë hyrë ata, ata janë injorantë dhe popull i kohës paraislamike. Këta duhet të ndahen nga populli i tyre në akide dhe mënyrë të jetuari, pastaj t'i kërkojnë Allahut të gjykojë mes tyre dhe popullit të tyre me të vërtetën dhe Ai është më i Miri Gjykues."

Ai gjithashtu thotë:

"Sot nuk ekziston asnjë shtet musliman në faqen e dheut dhe asnjë shoqëri muslimane, në të cilin rregulli i zbatuar të jetë sheriat i Allahut dhe fikhu islam."

Gjithashtu thotë:

"Po sot, çfarë?! Ku është ajo shoqëri muslimane, e cila ka pranuar që përkushtimi i saj të jetë vetëm për Allahun, e cila ka refuzuar vërtetë robërimin ndaj ndonjë prej krijesave, e cila ka pranuar që sheriat i Allahut të jetë kushtetuta e saj, e cila ka refuzuar vërtetë kushtetutën e çdo ligjëvënieje, e cila nuk del nga ky burim i vetëm i shariatit Islam?!"

Askush nuk ka të drejtë të pretendojë se kjo shoqëri muslimane ekziston sot!"

Sejid Kutub thotë në përforsim të kësaj që kaloi, duke kritikuar ata që mendojnë për sistemin islam:

"Ata të cilët mendojnë për sistemin islam dhe formacionet e tij sot, ose shkruajnë për të, ata hyjnë në qorrsoakak. Kjo, sepse ata përpiqen të zbatojnë rregullat e sistemit islam dhe ligjet e shkruara të fikhut të tij, në ajër. Ata përpiqen t'i zbatojnë ato në këtë shoqëri injorante të ngritur, me përbërjen e saj të sotme, ndërsa kjo shoqëri injorante e sotme, sipas peshimit me natyrën e sistemit islam dhe rregullave të fikhut të tij, konsiderohet boshllëk, në të cilin nuk mund të ngrihet ky sistem dhe as të zbatohen në të këto ligje.

Përbërja elementare e saj është krejtësisht në kundërshtim me përbërjen elementare të shtetit islam.

Në shoqërinë islame, siç thamë, përbërja elementare ngrihet në bazë të kualifikimit të personaliteteve dhe grupeve, ashtu siç i kualifikon lëvizja për pohimin e këtij sistemi në botën reale si dhe për luftimin e injorancës që të nxirren njerëzit nga ajo në Islam, duke duruar shtypjet e injorancës dhe ato që dalin para prej fitneve, dëmtimeve dhe sulmet kundra kësaj lëvizjeje. Duke duruar sprovat dhe vështirësitë, që nga pika e fillimit dhe deri në pikën e ndarjes në fund të synimit.

Ndërsa shoqëria injorante e sotme është një shoqëri e fjetur, e ndërtuar mbi virtyte të cilat nuk kanë lidhje me Islamin dhe as me virtytet e besimit...

Kjo shoqëri në krahasim me sistemin Islam dhe ligjet e fikhut të tij, konsiderohet një "boshllëk" në të cilin nuk mund të jetojë ky sistem dhe nuk mund të zbatohen këto ligje."

Së dyti: Në përbuzjen e dijetarëve dhe fyerjen e referencave fetare të popullit musliman:

Sejid Kutub thotë:

"Disa prej këtyre të dyshimtave kanë lindur si rezultat i ngatërimit të vetë idesë së fesë me ata të cilët në këtë kohë quhen "njerëzit e fesë", ngatërrim, i cili është i dëmshëm për Islamin dhe paraqitjen e tij tek njerëzit.

Në fakt, këta "njerëzit e fesë" janë krijesat e Allahut më të largëta nga të përfaqësuarit e idesë së tij (islamit) dhe nga hartimi i formës së tij, as me kulturën e tyre, as me sjelljet e tyre, madje as edhe me uniformën dhe paraqitjen e tyre.

Por injoranca për realitetin e kësaj Feje dhe kultura shkollore e mbetur që nga koha e pushtimit, të cilën vazhdojnë ta marrin ata njerëz të cilët i ka formuar pushtimi, si dhe veglat zbatuese të cilat pushtuesi i formoi me dorën e tij për të zënë vendin e tij pas ikjes së tij. Kjo injorancë e lindur nga ajo kulturë nuk i lë njerëzit të shohin paraqitjen e Islamit, vetëm se tek ata njerëz të cilët njihen si "njerëzit e fesë", dhe kjo është paraqitja më e keqe e mundshme e Islamit dhe e çdo feje tjetër."

Gjithashtu ai thotë:

"Le të qetësohen mendimtarët e sinqertë, njerëzit e arteve dhe ata që ndodhen tek ata, se pushteti islam nuk do t'ia dorëzojë ata trekëmbëshave të varjes dhe as burgjeve, nuk do të ndrydhë mendimet e tyre, nuk do të thyejë lapsat e tyre, por do t'u japë atyre mbrojtjen dhe kujdesin e tij. As nuk do të marrin britmat e pavlera me të cilat bërtasin sot "njerëzit e fesë të kualifikuar" në faqet e disa librave dhe në disa ide të tyre.

Këto britma, janë një tregti e fituar në ditët e sotme, si dhe një zanat ushques, sepse ata jetojnë në kohën e feudalizmit, i cili i ka caktuar ata ruajtës të padrejtësive dhe krimeve të tij, kështu që për të justifikuar ekzistencën e tyre në sy të popullit, ata hedhin këto britma boshe kohë pas kohe.

Por kur pushteti të jetë i Islamit, nuk do të mbesë punë për këta, por do të jenë njerëz të thjeshtë të rekrutuar për punën prodhuese të dobishme, bashkë me të papunët e tjerë prej nënpunësave të mëdhenj, njerëzve të pareve të mëdha, nënpunësave në regjistrat e shtetit, prej njerëzve të kafeneve, fundërrinave e haneve, prej të pastrehëve nëpër rrugë apo atyre që ngrohen në diell anës hauzeve...

Të gjithë këta janë të barabartë në papunësi e vërdallisje. Disa prej tyre janë të detyruar e të shtyrë me forcë, disa të tjerë janë dembelë e përtacë, ndërsa disa të tjerë janë shfrytëzues dhe pasues të dëshirave të tyre."

Sejidi habitet prej myftinjëve dhe pyetësve në shoqëritë islame për problemet me të cilat ata përballen, duke thënë:

"Islami është sistem shoqëror i gjithanshëm. Pikëpamjet e tij janë të lidhura dhe ndihmojnë njëra-tjetrën. Ai është një system i cili ndryshon në natyrën e tij, idenë e tij për jetën dhe mjetet e lëvizjes së saj, ai ndryshon në të gjitha këto, nga sistemet perëndimore dhe nga sistemet e zbatuara sot tek ne. ai ndryshon rrënjësisht nga këto sisteme dhe është mëse e sigurtë se ai nuk ka marrë pjesë në krijimin e problemeve të ngritura sot në shoqëri. Këto probleme kanë lindur si rezultat i natyrës së sistemeve që praktikohen në shoqëri, si dhe nga largimi i Islamit nga lëmitë jetës.

Por habia më e madhe pas kësaj është shtimi i pyetjes së Islamit për këto probleme, kërkimi i këtyre zgjidhjeve për to tek Islami, kërkimi i mendimit të tij për çështje të cilat nuk i ka krijuar ai dhe as nuk ka marrë pjesë në krijimin e tyre!

Është e habitshme që të pyetet Islami në vende, të cilat nuk e praktikojnë sistemin Islam, për çështje të atilla si: "gruaja dhe parlamenti", "gruaja dhe puna", "gruaja dhe përzierja me burrat", "problemet seksuale të të rinjëve" e të tjera si këto. Është e habitshme gjithashtu që këto pyetje t'i drejtojnë njerëz, të cilët nuk janë të kënaqur që të gjykojë Islami, madje ata i bezdis përftyrimi i asaj dite në të cilën gjykimi do të jetë i Islamit.

Edhe më të habitshme se pyetjet e këtyre janë përgjigjet e "njerëzve të fesë" dhe hyrja e tyre në polemikë me pyetësit rreth mendimit të Islamit dhe gjykimit të tij në çështje të tilla dytësore, në një shtet i cili nuk gjykon me ligjet e Islamit!

Çfarë i duhet Islamit sot, nëse gruaja hyn apo jo në parlament?! Ç'hyn ai nëse përziehen dy gjinitë apo jo?!

Çfarë i duhet atij nëse punon gruaja apo jo?



Çfarë i duhet atij me çdo lloj problemi prej problemeve të sistemeve të praktikuara në këtë shoqëri e cila nuk gjykon me Islam dhe nuk është e kënaqur me gjykimin e Islamit?!

Fikhu Islam nuk mund të ndërtohet mbi boshllëk dhe as nuk mund të jetojë në boshllëk. Ai nuk lind në tru dhe letra, por lind në jetë dhe jo çdo lloj jete, por në jetën e shoqërisë muslimane.

Është e domosdoshme që së pari të gjendet kjo shoqëri me përbërjen individuale të natyrshme, pastaj të jetë ajo mesi në të cilin lind dhe praktikohet fikhu islam.

Atëherë gjërat do të ndryshojnë shumë dhe në atë orë, kjo shoqëri e veçantë do të ketë nevojë pas lindjes së saj në ndeshje me injorancën dhe lëvizjes për ballafaqimin me jetën, do të ketë nevojë për bankat, shoqëritë e sigurimeve, planifikimin familjar etj. Por, edhe mund të mos ketë nevojë për to, sepse ne nuk kemi shembull para nesh për të përcaktuar nevojat e kësaj shoqërie, as përmasat dhe formimin e saj, që të mund të mund t'i caktojmë asaj shembull tek paraardhësit.

Ashtu si dhe këto ligje të kësaj feje që ne kemi nuk përputhet me nevojat e shoqërive injorante dhe as nuk u përgjigjet atyre... Kjo, sepse kjo fe nuk e njeh fillimisht ligjshmërinë e ekzistencës së këtyre shoqërive injorante dhe as nuk e pëlqen qëndrimin e tyre.

Kjo shoqëri nuk e lodh veten e saj për të pranuar nevojat e lindura nga injoranca e saj dhe as me përgjigjen e atyre nevojave."

Shejh Meshhuri thotë se këto tekste, të cilat janë një pjesë e vogël nga mesi i një grumbulli të madh, nuk kanë nevojë për shpjegime apo komente. Ato janë të qarta e të hapura dhe zbulojnë realitetin e bazave mbi të cilat Sejjid Kutub ka ndërtuar idenë e tij.

Më pas erdhën pasusit e tij për të shtuar mbi to ngjyra të ndryshme prej tejkalimit dhe ekstremizmit.

Nuk ka ndonjë çudi që ata të anulojnë ekzistencën e popullit musliman dhe të përbuzin përgjegjësat e çështjeve të tij (dijetarët), duke mos vështuar tek pasardhësit e pejgamberëve, të cilët ia përkushtuan jetën e tyre shërbimit të Librit të Allahut të Madhëruar dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), në fjalë dhe në vepër, në të kuptuar, e në të kuptuar atë të tjerëve, në të mësuar e në thirrje.

Ata kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin çdo gjë që munden për përhapjen e thirrjes së Teuhidit dhe Sunetit, si dhe për luftimin e dukurive politeiste dhe bidateve me të cilat është sprovuar shumica e grupeve të popullit tonë.

Nuk ka çudi që ata ta konsiderojnë këtë një punë të pavlerë, lodhje të humbur dhe thirrje të ndërtuar nga frika e atyre dijetarëve, nga pamundësia apo nga marrja me diçka që nuk i zemëron pushtetarët nga frika prej tyre dhe nënshtrimi ndaj tyre!!

Po, po! Për këtë shkak, u gjendën në botën islame disa breza muslimanësh shqetësues të popullit, kryengritës mbi dijetarët, tallës me përpjekjet e tyre në dije e thirrje, që nuk e shohin fenë vetëm se në hakimije me të cilën Sejid Kutubi komentoi fjalën e Teuhidit (d.m.th. shehadetin).

Ata nuk i peshojnë gjërat vetëm se me anë të saj, nuk i vlerësojnë personat vetëm se në dritën e saj dhe nuk mbartin asnjë qëllim tjetër në jetë, përveç arritjes tek ajo.

Kështu, u zvogëlua predikimi fetar në popull dhe shumë prej njerëzve humbën në rrugicat e errëta e vdekjeprurëse, gjë e cila ka qenë prej fatkeqësive më të mëdha që i kanë rënë popullit.

Por megjithatë, ajo që kanë arritur dijetarët e popullit në kohën tonë, duke filluar me thirrjen e shejhut të Islamit, Muhamed ibën Abdul-Uehab (Allahu e mëshiroftë!), e deri në ditët e sotme, për ringjalljen e rrugës së pejgamberëve, për rregullimin e bindjeve të muslimanëve dhe të veprave të tyre, për nxjerrjen e tyre nga errësirat e praktikimeve politeiste, nga adhurimet e shpikura dhe nga rrëshqitjet esh'ariste e sufiste, për t'iu kthyer rrugës së Kuranit dhe Sunetit, dhe të parëve të këtij populli, në fjalë e në vepër, në sistem të plotë e gjithpërfshirës për jetën dhe shoqërinë, të gjitha këto kanë qenë një mirësi e madhe dhe begati e madhe nga Allahu, e cila ngjall përgëzim dhe optimizëm, i shton pasuesëve të Teuhidit dhe Sunetit, qëndrueshmëri në rrugën e selefëve dhe mbështjellje rreth dijetarëve dhe thirrësave të tij, si dhe përkushtim për përhapjen dhe ndihmimin e tij, derisa të vijë Urdhëri i Allahut të Madhëruar dhe ata do të jenë në këtë gjendje.

**ktthehu lart**

\*\*\*

### **Fjalë përmbledhëse rreth boshtit të fitnes, fryteve, kohës, lëndës, mjeteve dhe shtrëngimit të saj**

Boshti i përgjithshëm me të cilin lidhen fitnet është kundërshtimi dhe përçarja, e cila çon në ngritjen kundër shoqërisë muslimane në përgjithësi dhe kundër prijësit të tyre në veçanti.

Fryti i saj është lejimi i gjakut dhe shtimi i vrasjes e trazirave.

Lënda e saj është bërja kafira e muslimanëve.

Mjetet e zotërinjve të saj janë artikuj të shpikur, teza ideore, kallëpe partiake, vrojtim i realitetit dhe ndjekje e ngjarjeve.

Metoda e tyre është fshehja pas metodës së selefëve, shfaqja e teksteve që dëshmojnë se vepra e tyre është bidat dhe stërmadhimi i rrëshqitjeve të kundërshtarëve të tyre.

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë në fjalën e tij kundër bidatçinjve:

"Prej shkaqeve të nënçmimit të selefëve prej këtyre bidatçinjve është ajo që ndodhi me disa që u janë ngjitur atyre ndonjë lloj pakujdesie e gabimi, si dhe ajo që ndodhi nga disa prej tyre në çështje jo të prera por që e vërteta ishte në kundërshtim me fjalën e tyre. Këto gjëra që ndodhën u bënë fitne për kundërshtarin e tyre, me të cilën ai humbi në errësirë të madhe."

Koha e fitnes është injoranca dhe pakësimi i dijes e besimit, largimi i drejtësisë nga populli, moslindja e dritës profetike, mostriumfi i fuqisë së të argumentuarit, të vepruarit para dijetarëve dhe paraprirja e tyre, ulja e vlerës dhe nënçmimi i tyre, largimi i popullit nga ata, diskutimi i ligjeve të sheriatit të përfituara nga tekstet e tij, përçarja dhe kundërshtimi.

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë:

"Shejtani i hauarixhëve ka qenë i lidhur në kohën kur muslimanët ishin të bashkuar në kohën e tre halifëve: Ebu Bekrit, Umerit dhe Uthmanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!). Por kur populli u përça në kohën e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), shejtani i gjeti hauarixhët të përshtatshëm për kryengritje, kështu që ata ngritën krye, e quajtën Aliun, Muavijen dhe ithtarët e tyre kafira..."

Prova për të gjitha këto, është se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ka sqaruar lindjen e fitneve, kohën e shtrëngimit të tyre dhe rrugën e cila të shpie tek Dexhali.

Është e njohur me siguri se bidati i hauarixhëve ka qenë bidati i parë në akide që ka ndodhur në popull. Ai filloi në Irak dhe prej tij u përhap në shumë vende të tjera, gjatë kohërave të ndryshme dhe do të vazhdojë e do të shtrëngohet edhe më shumë, diçka nga e cila ne kemi parë me sytë tanë.

**ktthehu lart**

## Kapitulli i gjashtë

### Detyra e kohës në të cilën jetojmë

Nga fjala e prijësave të mëdhenj të thirrjes islame me në krye dijetarët tanë të mëdhenj Ibën Bazin, El Albanin dhe Ibën Uthejmin (Allahu i mëshiroftë!), qartësohet se gjëja në të cilën ata thërrasin është metodologjia e pejgamberëve, e cila është një rrugë e gjatë dhe e vështirë, qëllimi i të cilit është zbatimi i fesë, edukimi i rinisë në fe me edukim qiellor dhe jo partiak. Kjo nuk i lidh ata me përfitimet e kësaj dynjaje dhe as me postet e karriget, ndryshe nga kryengritësit të cilët janë politikanë në fjalimet e tyre, fetuatë, tezat, mënyrën e trajtimit të shpikjeve të reja, aq më tepër në mënyrën e tyre për të arritur në postet e qeverisjes.

Detyra e besimtarit të singërtë, i cili ndjek rrugën e selefëve në kohë fitnessh e trazirash mund të përmbledhet si vijon:

Së pari: Duke ndjekur fjalën e dijetarëve të mëdhenj, duke i respektuar ata. Duhet të dihet se prej shenjave të metodologjisë së gabuar është mosdëgjimi i fjalës së dijetarëve, hedhja e saj pas shpine, të folurit keq për ta dhe akuzimi i tyre, apo thënia se ata janë dijetarë të qeverisë, apo dijetarë të periodave e lehonisë, apo se ata janë njerëz dhe gabojnë e të tjera si këto. Po, ata janë njerëz dhe mund të gabojnë, por nuk ka mundësi të gabojnë në çështjet më të rëndësishme të popullit, duke mbetur që këto çështje t'i zgjidhin dhe t'i kuptojnë të paditurit, apo nxënësit e vegjël të dijes. As nuk mund të thuhet se dijetarët e mëdhenj si Ibën Bazi dhe Ibën Uthejmini nuk mund ta thonë të vërtetën hapur, duke pretenduar se ata i ruhen shtetit apo diçkaje tjetër. Siç e pamë nga vetë fjala e Ibën Uthejminit (Allahu e mëshiroftë!), ai e mohoi diçka të tillë dhe pohoi se është i lirë të thotë ç'të dojë për atë që mendon se është e vërteta.

Kjo është rruga e selefëve dhe sjellja e tyre me dijetarët, siç ka ndodhur, me tabiiun Jezid ibën Suhejb Ebu Uthman el Kufi, i cili njihet edhe si El Fakir. Sipas një transmetimi të Muslimit ai ka thënë:

"Më kishte pushtuar një prej mendimeve të hauarixhëve, kështu që dola me një grup jo të vogël për në haxh, me qëllim që atje të dilnim dhe të luftonim njerëzit me armë.

Kaluam nga Medina dhe aty ishte Xhabir ibën Abdullah duke i treguar njerëzve për të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Pastaj ai përmendi xhehenemitë (ata që do të dalin nga xhehenemi pas dënimit dhe do të hyjnë në xhenet).

Unë i thashë atij: "O shoku i të Dërguarit të Allahut, çfarë është kjo që po flisni? Ndërsa Allahu thotë: **"Atë që Ti e fut në Zjarr, atë e ke turpëruar."** [Ali Imran: 192]

**"Sa herë që ata duan të dalin nga ai, ata kthehen përsëri në të."** [Es Sexhde: 20].

### **Kështu që ç'është ajo që thoni?"**

Ky tabiin u argumentua me ajete, të cilat i kishte kuptuar sipas prirjes së tij. Atij i ishte thënë se ato ajete themelojnë kuptime, të cilat merren pa vështruar në ajete e tekste të tjera, kështu që ai e qortoi sahabiun e madh Xhabirin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) për gabimin e tij në këtë metodë të tij. Ndërsa Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i tha:

- A e lexon Kuranin?

- Po.

- A ke dëgjuar për vendin e Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), d.m.th vendin në të cilin do ta ringjallë Allahu?

- Po.

- Ai është vendi i Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), vendi i lavdëruar, me të cilin Allahu do të nxjerrë prej tij (zjarrit) ata që do të nxjerrë.

Pastaj Xhabiri përshkroi vendosjen e urës së Siratit dhe kalimin e njerëzve në të... "dhe se disa njerëz do të dalin nga Zjarri pasitë kenë qenë në të."

Pas dëgjimit të këtij hadithi, Allahu i bëri dobi Jezidit me të dhe e bëri që t'i kuptojë ajetet e mësipërme sipas këtij hadithi dhe përkrah tij, duke mos i kundërvënë tekstet kundër njëri-tjetrit dhe as duke i kuptuar ato si kundërshtues të njëri-tjetrit, prandaj Jezidi tha:

"Kur u kthyem në Kufa thamë: "Mjerë ju! A mendoni se ai shejh mashtron për të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) (duke thënë diçka që ai nuk e ka thënë)?"

Kështu, Allahu i bëri dobi atij për të besuar se dijetarët prej sahabëve janë të sinqertë dhe ky është kushti i parë për të pasur dobi nga dijetarët edukatorë në përgjithësi dhe në kohë trazirash në veçanti.

Prej shenjave të atyre që e kanë metodologjinë të prishur është edhe ajo që thamë më parë, mashtrimi për dijetarët dhe fshehja pas emrit të selefij. Ata nuk e kanë për asgjë që edhe t'i shajnë dijetarët e mëdhenj e të hedhin akuza kundër tyre, siç kanë bërë me shejh Albanin (Allahu e mëshiroftë!), duke thënë se ai është murxhi, apo siç kanë thënë edhe të tjerë para këtyre se ai është çifut (Allahu i fëlliqtë!).

Imam Ahmed ibën el Edhrai thotë: "Fjala e keqe për dijetarët dhe sidomos për dijetarët e mëdhenj, është prej gjynaheve të mëdha."

Është përcjellë nga imam Ahmedi se ai ka thënë: "Mishi i dijetarëve është i helmuar. Kush e nuhat atë, sëmuret dhe kush e ha, vdes."

E të tjera thënie të dijetarëve të mëdhenj të selefëve, të cilat bëjnë të qartë rrezikshmërinë e të folurit keq, apo e të përmendurit për të keq dijetarët dhe njerëzit e mirë.

Kjo është metodologjia e selefëve në lidhje me vendin e dijetarëve në shoqërinë muslimane, në zemrat e tyre, në ndjekjen, pasimin e fjalëve të tyre dhe në respektimin e tyre.

E si të mos jetë kështu, ndërkohë që ata janë kandilat që u bëjnë dritë njerëzve dhe u tregojnë atyre rrugën?! I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Vlera e dijetarit mbi adhuresin është si vlera e hënës mbi yjet."

Si të mos jetë kështu kur ata janë pasardhësit e peygamberëve dhe peygamberët nuk kanë trashëguar ar e argjend, por kanë trashëguar dijen?!

Si të mos jetë kështu, ndërsa kur të vdesin dijetarët njerëzit do të drejtohen tek injorantët e paditur dhe që nuk i frikësohen Allahut dhe do t'i pyesin ata, e ata do t'i përgjigjen pa dije, kështu që do t'i humbin njerëzit nga rruga e drejtë bashkë me veten e tyre?!

Vëlla besimtar, besoj se e kuptove rëndësinë e dijetarëve në mesin e popullit musliman dhe në udhëzimin e edukimin e njerëzisë. Atëherë duaji ata, fol mirë për ta, respektoi ata dhe ndiq udhëzimet dhe fjalët e tyre!

O ti selefi, a e di peshën e kësaj fjale me të cilën e ke quajtur veten? A e ke kuptuar domethënien dhe vlerën e saj?

Ti e di hadithin e ndarjes së këtij populli në shtatëdhjetë e tre grupe prej të cilave njëri do të jetë në xhenet dhe ai është grupi i shpëtuar, ai grup i cili do të ndjekë udhëzimin e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe rrugën e shokëve të tij. Ai grup është xhemati i dijetarëve të selefët.

Barra e kësaj fjale është që të veprosh ashtu si duhet dhe jo ashtu siç do ti. Të veprosh atë që do Allahu dhe e pëlqen dhe jo atë që do dhe pëlqen ti.

Kjo do të thotë, të mos hedhësh asnjë hap pa pyetur dijetarët dhe pa e studiuar e peshuar çështjen me kendarin e selefëve dhe metodologjinë e tyre. Pastaj nëse fjala e tyre është në kundërshtim me emocionin tënd, ti duhet të bësh zgjedhjen tënde, si ata vëllezërit në Algjeri kur bënë dialog me shejh Ibën Uthejminin (Allahu e mëshiroftë!) dhe mësuan se rruga e tyre ishte e gabuar, atëherë ata u kthyen nga ajo dhe kapën të vërtetën.

Kështu, ndjekja e dijetarëve bëhet edhe për çështjet e mëdha edhe për çështjet më të vogla, me qëllim që besimtari të jetojë në përputhje me udhëzimet e tyre, duke besuar se kjo është ajo që Allahu kërkon prej tij.

Por, për kohën që ne jetojmë dhe gjendjen e muslimanëve në të, ajo që duhet bërë dhe që ka për detyrë çdo musliman është ajo që ka përsëritur shpesh shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) duke u nisur nga përvetësimi dhe njohja e tij e haditheve dhe gjendjes së selefëve të parë si dhe të pasardhësve të tyre prej dijetarëve të mëdhenj. Duke u nisur nga kuptimi i detyrës së tij si dijetar, të cilët siç e thamë më lartë, janë pasardhës të pejgamberëve, edukatorë të popullit. Ata vërtet janë edukatorët qiellorë, të cilët i ka dërguar Allahu i Madhëruar nga mëshira e Tij për popullin musliman. A nuk thuhet në hadithin e saktë nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se "Allahu i dërgon këtij populli në krye të çdo shekulli dikë që t'i përtërijë atij fenë e Tij"?

Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë!) përsëriste shpesh në këshillat e tij dy fjalë: tasfije (spastrim) dhe terbiye (edukim). Pastrim dhe spastrim të akides dhe fikhut nga papastërtitë që janë përzier me to, prej shirqeve e bidateve. Edukim sipas dijes së saktë dhe praktikim e ushtrim të saj në fushën e jetës. Atëherë kur muslimanët ta bëjnë këtë në mesin e tyre, atëherë Allahu do t'i ndryshojë gjendjet e tyre.

Të dëgjojmë prej shejhut tonë, El Albanit (Allahu e mëshiroftë!), ndërsa ai thotë pas një deklaratë për rëndësinë e "spastrimit" dhe "edukimit":

"Ajo që është duke ndodhur në Algjeri apo në Egjipt, ajo është në kundërshtim me Islamin, sepse Islami urdhëron për spastrim dhe edukim..."

Pas një fjale të gjatë në përgjigje të një pyetjeje rreth përdorimit të shpërthimeve nga ana e kryengritësve, të cilat bëhen shkak për marrjen e jetës së dhjetëra të pafajshmëve:

"Përgjigja jonë është shumë e qartë. Ajo që ndodh në Egjipt e në vende të tjera, ia ka kaluar kohës së vet, së pari, dhe është në kundërshtim me ligjet e sheriatit, në qëllim dhe në metodologji, së dyti."

Pastaj foli për kryengritjet që ndodhën në Algjeri me fjalët:

"Kjo është një pjesë e totalit. Më e rrezikshmja e saj është kjo kryengritje e cila ka disa vite që ka kaluar, ndërsa gjendja nuk ka shtuar veçse rëndesë."

"...Për këtë arsye, të gjitha ato grupacione të cilat pretendojnë se janë selefite, nëse ato nuk veprojnë sipas rrugës së selefëve, prej të cilës është edhe ajo për të cilën po bëjmë fjalë; se nuk lejohet që pushtetarët të quhen të dalë nga Islami, as nuk lejohet ngritja kundër tyre. Ajo që thonë ata është një supozim i pretenduar. Kjo është një çështje, gjymtia e së cilës është shumë e qartë."

Ky themelim i shejhut i ka objektivat të qarta. Ai e përsëriste dhe e përforconte atë, madje botoi gjatë jetës së tij (në revistën "Muslimanët") në një fetva të gjatë, në të cilën ai lavdëroi dijetarët e mëdhenj bashkëkohorë dhe në mes tjerash, ai foli për çështjen e "qeverisjes" dhe "kryengritjeve" të të rinjve kundër pushtetarëve si rezultat i saj:



"Unë u kam pas thënë dhe vazhdoj t'u them këtyre të rinjëve të cilët gumëzhijnë rreth nxjerrjes nga Islami pushtetarët e muslimanëve: E supozojmë se pushtetarët janë kafira të dalë nga Islami; ç'farë mundeni të bëni pas kësaj?

Kafirat i kanë pushtuar disa vende të Islamit. Ne këtu jemi sprovuar me pushtimin çifut të Palestinës, por ç'farë mund të bëjmë ne dhe ju me këta pushtues dhe ç'farë mund të bëni ju me pushtetarët tuaj të cilët mendoni se janë prej kafirave?

A nuk e lini mënjane këtë gjë dhe të filloni me themelimin e bazës mbi të cilën ngrihet shtylla e qeverisë muslimane?!

Dhe kjo, me ndjekjen e sunetit të të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) mbi të cilin ai edukoi shokët e tij... Kjo është ajo të cilën në raste të tilla, ne themi se çdo grup musliman kategorikisht duhet të punojë me të vërtetë për kthimin e pushtetit Islam, jo vetëm mbi tokën Islame, por mbi të gjithë tokën, në përmbushje të Fjalës së Allahut të Lartësuar: **"Ai është i Cili dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe Fenë e Vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë, edhe nëse idhujtarët e urrejnë këtë."**

Ndërsa në disa hadithe të sakta është përcjellë se ky ajet do të përmbushet më pas.

Që muslimanët të munden ta përmbushin këtë ajet Kur'anor, a do të ishte rruga e saj me shpalljen e kryengritjes mbi këta pushtetarë për të cilët ata mendojnë se kanë dalë nga Islami?!

Pastaj, me këtë mendim të tyre, i cili është një mendim i gabuar, ata nuk munden të bëjnë asgjë!

Por cila është ajo metodologji dhe cila është ajo rrugë për përmbushjen e këtij ajeti?

Nuk ka dyshim se ajo rrugë është rruga në të cilën i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) rrihte rreth saj dhe i përkujtonte shokët e tij në çdo hytbe me thënien: "Dhe udhëzimi më i mirë është ai i Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)."

Kështu që është detyrë e të gjithë muslimanëve në përgjithësi dhe e atyre që interesohen për kthimin e pushtetit Islam në veçanti, të fillojnë prej aty ku ka filluar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), gjë të cilën ne e kemi shprehur me dy fjalë të lehta: "Spastrim" dhe "edukim".

Kjo, sepse ne dimë një realitet të cilin e kanë harruar, ose bëjnë sikur e kanë harruar ata ekstremistë të cilët nuk kanë gjë tjetër përveç tekfirit (quajtjes kafira) të pushtetarëve, dhe pastaj absolutisht asgjë!

Ata do të vazhdojnë të shpallin kufrin e pushtetarëve dhe pastaj nuk do të burojnë prej tyre, veçse fitne, gjë të cilën e vërteton aktualiteti i këtyre viteve të fundit të cilat ata i dinë mirë, duke filluar me fitnen e Haremit të Mekës, pastaj me fitnen e Egjiptit dhe vrasjen e Sadatit bashkë me derdhjen e gjakut të shumë prej muslimanëve të pafajshëm për shkak të asaj fitneje, pastaj në Siri dhe tani në Egjipt dhe Algjeri, për fat të keq...

E gjitha kjo për shkak se ata kundërshtuan tekste të shumta të Kur'anit dhe Sunetit, ku më e rëndësishme ka qënë Fjala e Allahut: **"Ju keni pasur shembullin më të mirë të i Dërguari i Allahut; për atë që shpreson Allahun dhe Ditën e Fundit, dhe që e ka përmendur shumë Allahun."**

Por, me ç'farë filloi i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)?

Ju e dini se ai filloi me thirrjen në mesin e individëve për të cilët mendonte se ishin të gatshëm për pranimin e të Vërtetës. Pastaj iu përgjigj atij ai që iu përgjigj, siç është e njohur në historinë e jetës së Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Pastaj ishte vuajtja dhe tortura që ra mbi muslimanët në Mekë. Pastaj urdhëri për emigrimin e parë, të dytë e me radhë, derisa Allahu themeloi Islamin në Medinen e ndritshme. Atëherë filluan përlëshjet dhe lufta ndërmjet muslimanëve dhe idhujtarëve nga një anë, pastaj çifutët nga ana tjetër, e kështu.

Kështu që duhet të fillojmë ne t'u mësojmë njerëzve Islamin, ashtu siç filloi i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)."

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë në librin e tij "Minhaxhu es sunetin nebevije" (vëll.IV, f.528,532), ndërsa paraqiti disa grupe rebelësh, të cilët kishin ngritur krye kundër prijësave të padrejtë të kohës së tyre, disa prej të cilëve nuk ishin mbartës të parimeve hauarixhe prej nxjerrjes nga Islami me kryerjen e një gjynahu të madh. Ai thotë:

"Limiti i këtyre është ose të triumfojnë, ose të munden. Pastaj pushteti i tyre do të bierë dhe atyre nuk do t'u ngelë përmendje. Abdullah ibën Ali dhe Ebu Muslimi janë ata dy që kanë vlarë krijesa të shumta dhe që të dy ata i vrau Ebu Xheafer el Mensur. Po kështu edhe kryengritësit e El Hara, Ibën el Eshath, Ibën el Mehleb e të tjerë, u shtypën dhe bashkë me ta u shtypën shokët e tyre. Ata as nuk ngritën fe dhe as nuk lanë dynja (për vete).

Por Allahu i Lartësuar nuk urdhëron për gjëra të cilat nuk i sjellin dobi as fesë dhe as jetës njerëzore, edhe sikur vepruesi i tyre të ishte prej të dashurve të Allahut të devotshëm dhe prej banorëve të Xhenetit. Kushdo qoftë, nuk do të jetë më i mirë se Aliu, Aisha, Talha, Zubejri etj. Megjithatë, këta nuk u lavdëruan për fitnet që shkaktuan, edhe pse ata kanë vend më të madh tek Allahu dhe singeritet më të mirë se çdokush tjetër.

Po kështu edhe banorët e El Harasë, në mesin e tyre gjendeshin njerëz me dije e fe, po kështu edhe në grupin e Ibën el Esh'ath, në mesin e tyre gjendeshin dijetarë dhe njerëz me fe, Allahu i faltë të gjithë ata!

El Hasen el Basri thoshte: "Haxhaxhi është ndëshkimi i Allahut, kështuqë mos e shtyni ndëshkimin e Allahut me duart tuaja! Por nënshtrojeni Allahut dhe bindiuni Atij, sepse Allahu i Lartësuar thotë: **"Ne i mbërthym ata me ndëshkim, por ata nuk iu përulën Zotit të tyre dhe as nuk u lutën me nënshttrim ndaj Tij."** [El Mu'minun: 76].

Ndërsa Talk ibën Habib thoshte:

"Friksojuni fitnes me përkushtim ndaj Allahut! Dikush i tha: "Na e sqaro me pak fjalë kuptimin e devotshmërisë!" Ai tha: "Të veprosh me bindje ndaj Allahut me dritë nga Allahu, duke shpresuar mëshirën e Allahut, dhe të mënjanoj mosbindjen ndaj Allahut me dritë nga Allahu, duke iu frikësuar ndëshkimit të Allahut!"

Transmetuar nga Ahmed i dhe Ibën Ebi Dunja.

Dijetarët muslimanë ndalonin nga dalja dhe vrasja në kohë fitnesh, siç ka qënë Abdullah ibën Umer, Seid ibën el Musejib, Ali ibën el Husejn etj. Këta i ndalonin njerëzit nga dalja kundër Jezidit në vitin e fitnes së El Hara, ashtu si dhe ndalonte El Hasen el Basri, Muxhahidi e të tjerë, nga ngritja krye kundër Ibën el Esh'athit.

Prej këtu, vendimi i Ehli Sunetit qëndroi në lënien e luftës në kohë fitnesh, duke u bazuar në hadithe të sakta e të qëndrueshme nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Këtë gjë ata filluan ta përmendin në akiden e tyre dhe urdhëronin për durim ndaj padrejtësisë së prijësave dhe mosluftimin e tyre, edhe nëse ata kanë vrarë shumë dijetarë e të devotshëm në kohë fitnesh.

Tema e fikhut islam për luftimin e tiranëve dhe urdhërimin për të mirë e ndalimin nga e keqja, i përngjan luftimit në kohë fitnesh, por vendi i këtij sqarimi nuk është këtu.

Kush i mediton hadithet e sakta të përcjella nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për këtë temë, dhe i merr në konsideratë sipas konsiderimit të largpamësve, ai bindet se ajo që thonë ato tekste është puna më e mirë. Për këtë shkak, kur Husejri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ndërmori daljen për tek banorët e Irakut të cilët i kishin dërguar atij mesazhe të shumta, optimalët e dijes dhe fesë, si Ibën Umeri, Ibën Abasi, Ebu Bekri dhe Abdurrahman ibën el Harith ibën Hishami e këshilluan atë që të mos shkojë tek ata.

Këta kishin frikë se ai do të vritej nëse do të shkonte atje, prandaj dikush prej tyre i tha atij: "Të lë amanet tek Allahu nga ndonjë kriminel". Ndërsa dikush tjetër i tha: "Sikur të mos ishte ndërmjetësimi, unë do të kapja dhe do të të ndaloja nga dalja tek ata." Me këtë

gjë ata kishin për qëllim këshillimin e tij duke pasur si synim të mirën e tij dhe të muslimanëve.

Dijeni, se Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) urdhërojnë për rregullim dhe jo për shkatërrim, por logjika jonë herë ia qëllon dhe herë gabon.

Kështu që u bë e qartë se çështja ishte ashtu si thanë ata burra, dhe kryengritja nuk pati ndonjë dobi, as në fe dhe as në mbarëshkuarjen e jetës së njerëzve, përkundrazi, ata mizorë e tiranë vranë nipin e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) me të padrejtë duke rënë martir.

Në daljen dhe vrasjen e tij pati një humbje dhe shkatërrim, i cili nuk do të ndodhte nëse ai do të qëndronte në vendin e tij. Ajo që ai pati për qëllim prej tërheqjes së të mirës dhe shtyrjes së të keqes, asgjë prej saj nuk u arrit, madje e keqja u shtua edhe më shumë me daljen dhe vrasjen e tij, gjë e cila i hapi rrugën një katastrofe të madhe. Vrasja e Husejnit bëri të detyrueshme ndezjen e fitneve, ashtu si edhe vrasja e Uthmanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

E gjitha kjo bën të qartë se urdhëri i të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për të bërë durim nga mizoria e prijësave dhe për të mos ngritur krye kundër tyre, është puna më e dobishme dhe më me interes për njerëzit në mbarëshkimin e jetës së tyre dhe të të ardhmes së tyre tek Allahu.

Për këtë shkak i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e lavdëroi Hasenin me fjalën e tij: "Ky biri im është zotëri dhe me të Allahu do të pajtojë ndërmjet dy palëve të mëdha prej muslimanëve."

Por, nuk ka lavdëruar askënd, as për pjesëmarrjen e tij në fitne, as për daljen me shpatë kundër prijësave, as për daljen nga bindja ndaj prijësit dhe as për ndarjen e tij nga grupi i muslimanëve.

Hadithet e sakta të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) argumentojnë të gjitha për këtë gjë, siç ka ardhur në "Sahihu el Buhari" nga hadithi i Hasen el Basri, ka thënë: "Kam dëgjuar Ebu Bekrah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) të thotë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), i cili ishte mbi minber me Hasenin pranë, duke vështuar herë tek njerëzit dhe herë tek Haseni, ai thoshte: "Ky biri im është zotëri dhe me të Allahu do të pajtojë ndërmjet dy palëve të mëdha prej muslimanëve."

I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) njoftoi se ai është zotëri dhe ajo që ai tha për të u përmbush.

Kjo tregon qartë se pajtimi ndërmjet dy palëve ka qënë i dashur dhe i lavdëruar, të cilin e donte Allahu dhe i Dërguari i tij dhe se vepra e Hasenit ka qënë nga meritat e tij më të mëdha dhe nga virtytet e tij më të larta për të cilat e lavdëroi atë i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Nëse lufta do të ishte obligim apo e pëlqyeshme, i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) nuk do të kishte lavdëruar askënd për lënien e obligimit apo veprës së pëlqyeshme.

Po për këtë shkak, i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) nuk lëvdoi askënd për përleshjet që ndodhën ditën e "El Xhemel" dhe "Safin", aq më pak për atë që ndodhi në Medine ditën e "El Hara", apo për atë që ndodhi në Mekë në rrethimin e Ibën ez Zubejr e në fitne të tjera. Përkundrazi, nga ai kanë ardhur hadithe të transmetuara nga i gjithë populli (muteuatir) në të cilat ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) urdhëron për luftimin e havarixhëve të dalë nga bindja të cilët i luftoi Ali ibën Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në "Nahravan", pasi që kishin dalë kundra tij në "Haura".

Për këta kanë ardhur lajme të gjithënjohura nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për vrasjen e tyre dhe kur Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i luftoi ata, ai u gëzua me luftimin e tyre dhe transmetoi hadithin që kishte dëgjuar nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për ta. Sahabet të gjithë ishin dakord për luftimin e këtyre, po kështu edhe dijetarët pas tyre. Ata nuk e konsideronin luftimin e këtyre si luftimi në ditën e "El Xhemel" dhe "Safin" për të cilat nuk ka zbritur tekst hyjnor, as nuk ranë dakord sahabet dhe as nuk e lavdëruan atë burrat e mëdhenj që morën pjesë në të, përkundrazi u penduan dhe u kthyen nga ajo."

"Nëse dikush thotë: Aliu dhe Husejni e lanë luftën në fund për shkak të pamundësisë, sepse ata nuk kishin përkrahës. Kështu që lufta do të çonte në derdhjen e gjakërave pa arritur ndonjë përfitim të kërkuar?

Atij i thuhet: Pikërisht kjo është zgjuarsia dhe urtësia të cilën e ka marrë në konsideratë i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në ndalimin për daljen kundër prijësave dhe lënien e luftës në kohë fitnesh, edhe pse vepruesit e saj mendojnë se qëllimi i tyre është urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, siç thanë ata që dolën në "El Hara" dhe "El Xhemaxhim" kundër Jezidit, Haxhaxhit etj.

Por, nëse e keqja nuk mund të hiqet veçse me një të keqe më të madhe se ajo, atëherë heqja e saj kthehet në të keqe dhe nëse e mira nuk mund të arrihet veçse me një shkatërrim më të madh se ajo e mirë, atëherë arritja e kësaj të mire në këtë rast është e keqe.

Pikërisht në këtë pikë, havarixhët lejuan ngritjen e shpatave kundër muslimanëve që kthehen nga Kibla, sa që vranë Aliun e muslimanë të tjerë. Po kështu edhe ata që i kanë pasuar ata në daljen me shpatë kundër prijësave në përgjithësi.

Ata që janë të devotshëm prej tyre, synojnë të arrijnë atë që mendojnë se është e ligjshme. Por këta mund të gabojnë në dy pikëpamje:

E para: Ajo që ata mendojnë se është prej fesë (e ligjshme) të mos jetë e tillë. Si ideja e havarixhëve e të tjerëve prej pasuesëve të epsheve e tiranisë së tyre. Ata formojnë bindje të cilat në fakt janë të gabuara dhe të shpikura, pastaj luftojnë njerëzit në bazë të tyre, madje quajnë kafira ata që i kundërshtojnë, duke u futur në dy gabime të mëdha; në idetë dhe bindjet e tyre, dhe në luftimin e kundërshtarëve të tyre, apo nxjerrjen e tyre nga Islami dhe mallkimin e tyre.

Kjo është gjendja e të gjithë kapriçozëve në tekat e tyre, si Xhehmijet të cilët thërrasin njerëzit në mohimin e realitetit të Emrave të Bukur dhe Cilësive të Larta të Allahut, duke thënë: Ai nuk flet, përveç asaj që ka krijuar tek të tjerët, apo se Ai nuk sheh, e kështu. Pastaj tensionuan njerëzit, kur disa udhëheqës u ndikuan nga idetë e prishura të tyre, duke filluar të ndëshkonin të gjithë ata që i kundërshtonin në bindje e ideologji, ose me vrasje, ose me burgosje, ose me përndjekje e ndalim të furnizimit. Xhehmijet e kanë praktikuar disa herë këtë mizori, por Allahu i ndihmon gjithnjë robët e tij besimtarë mbi ta.

Ndërsa "Rafiditë" (grup prej shijave) janë edhe më mizorë se ata. Njëset u jepet mundësia, këta miqësohen me kafirat dhe i ndihmojnë ata, dhe armiqësohen me të gjithë muslimanët të cilët nuk bashkohen me ta në ideologji.

Kështu është puna me të gjithë ata që mbartin ndonjë lloj bidati...

Pikëpamja e dytë: Ata që luftojnë në bazë të një ideologjije në të cilën thërrasin, por e cila është në kundërshtim me Sunetin dhe me kolektivin, si ata të fitnes së "El Xhemel", "Safin", "El Hara", "El Xhemaxhim" e të tjerë. Këta mendojnë se me luftë mund të arrihet dobia e kërkuar, por në fund, nga lufta nuk arrihet ajo që kërkohet, madje e keqja shtohet edhe më shumë se më parë.

Ajo që duhet të bëhet e ditur është se shkaqet e këtyre trazirave janë të përbashkëta e të njëjlojta. Zemrave iu paraqiten disa gjëra të cilat i pengojnë ato nga njohja e të vërtetës dhe të synuarit e saj. Për këtë shkak ato vihen në rolin e injorancës në të cilën nuk ka njohje të së vërtetës dhe as kërkim të saj.

Ndërsa Islami ka ardhur me nxitje për kërkimin e dijes së dobishme dhe veprimin e punës së mirë, në bazë të njohjes së të vërtetës dhe kërkimin e saj."

"Prej këtui, unë i këshilloj të rinjtë entuziastë për xhihad e të përkushtuar Zotit të njerëzve: Përkujdesuni për rregullimin e brendshëm dhe shtyjeni interesimin për të jashtmen, për të cilën nuk keni asnjë lloj manovrimi! Dijeni se kjo kërkon një punë të pashtershme dhe kohë të gjatë, për të përmbushur atë që quhet "Spastrim dhe edukim". Por me këtë nuk mund të ngrihen veçse grupe dijetarësh të kulluar dhe edukues të

devotshëm, të cilët janë shumë të paktë në këtë kohë dhe veçanërisht në mesin e grupeve të cilat ngrihen kundër pushtetarëve.

Disa mund ta mohojnë rëndësinë e këtij "spastrimi", siç është aktualiteti i disa partive Islame, ndërsa disa mund të supozojnë se koha e tij ka mbaruar. Për t'iu drejtuar politikës, apo xhihadit (i cili në fakt është kryengritje dhe jo xhihad) dhe për t'i kthyer shpinën interesimit për "spastrimin" dhe "edukimin". Por të gjithë ata janë gabim për këtë. Sa kundërvajtje fetare kryhen nga të gjithë ata për shkak të zhvleftësimit të detyrës së "spastrimit" dhe të mbështetjes së tyre në imitim e fabrikim të ligjeve të sheriatit (duke zgjedhur nga medh'hebet e ndryshme të fikhut atë që iu intereson), me anë të të cilave ata bëjnë të lejuar shumë prej ndalesave të Allahut.

Shembulli është ky: Ngritja kundër pushtetarëve, edhe nëse prej tyre nuk ka dalë kufër i hapur.

Vëlla besimtar, kjo nuk është vetëm për popullin në masë, por ajo të drejtohet ty personalisht, edhe ty, edhe ty tjetrit! Kjo i drejtohet gjithsecilit nga ne. Nëse ti do ta ndryshosh veten tënde në përputhje me dispozitat e sheriatit dhe nëse do ta vërtetosh fjalën e Allahut në veten tënde **"Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për tjetër gjë, veçse për të më adhuruar Mua."**, atëherë Allahu do ta ndryshojë gjendjen tënde dhe do të të japë sukses në të dyja botët.

Vëlla musliman, mos të të preokupojnë çështjet e mëdha dhe të harrosh ato të voglat, në syrin tënd, sepse ti nuk e di se cilën kërkon Allahu prej teje pikërisht!

Hadithet e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në të cilat ai paralajmëron për fitnet dhe se si duhet vepruar në rast se ato përhapen, janë të shumta e të njohura.

"Do të ketë fitne në të cilat ai që qëndron ulur është më i mirë se ai që qëndron në këmbë, ai që qëndron në këmbë është më i mirë se ai që ecën dhe ai që ecën është më i mirë se ai që vrapon drejt tyre. Atë që u shfaqet atyre, ato e tërheqin. Kush gjen ndonjë strehim apo vendmrojtje prej tyre, atëherë të strehohet në të!"

"...Dikush tha: O i Dërguari i Allahut, ç'farë më urdhëron të bëj nëse i arrij ato (fitne)? Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: Kush ka deve, të shkojë tek devetë e tij (t'i kullosë); kush ka dele, të shkojë me delet e tij; kush ka tokë, të shkojë tek toka e tij dhe kush nuk ka asgjë, të marrë shpatën e tij dhe të godasë me tehun e saj një shkëmb, ashtuqë të mund të shpëtojë nëse mundet, ashtuqë të mund të shpëtojë nëse mundet!"

Këto janë ato me të cilat na ka këshilluar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në rast fitnesh dhe se ato (fitnet) janë të papëlqyeshme, madje shumë të urryera tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, sepse ato shkaktojnë derdhjen e gjakut të muslimanëve, marrjen e nderëve të tyre dhe shkatërrimin e pasurive të tyre. Ato bëhen



shkak për thashethemet dhe përgojimin të cilat tek Allahu janë sikur të hash mishin e vëllait tënd të vdekur. Ato përçajnë popullin musliman dhe e ndajnë fjalën e tyre...

Dëmet e tyre nuk mund të numërohen dhe ne i kemi parë me sytë tanë pasojat e tyre dhe po i shohim dita-ditës në fatin e popullit musliman, jo vetëm në vendet muslimane, por edhe kudo në botë.

Ato trazira nuk vijnë kurrë me të mira për popullin musliman, për këtë arsye dijetarët e mëdhenj këshilluan dhe e ngritën zërin e tyre, por shejtani i tyre (kryengritësve) nuk i la që të kthehen në udhëzimet e tyre, kështuqë ata i hipën kokave të tyre dhe trazuan një popull të tërë, e futën në bela, derdhën gjakun e tij, shkatërruan pasuritë e tij, shkelën nderet e tij, madje u bënë shkak për pushtimin e tokave të tij.

E keqja është se ata ende nuk kanë ardhur në vete, ende nuk u ka ardhur mendja, por vazhdojnë të prishin qetësinë e muslimanëve, madje edhe të vrasin shumë të pafajshëm prej tyre, nëpër ato atentatet e tyre me shpërthime të makinave të minuara në vendet muslimane, gjë e cila nuk është kurrë prej Islamit, siç thonë dijetarët e mëdhenj.

\*\*\*

## Kapitulli i shtatë

### Llojet e dijeve dhe metodologjia e ndjekur për të arritur tek e vërteta e gjërave

Detyra që ka çdokush që kërkon të vërtetën është që ai të ndjekë procedurë akademike, pa e përzierë atë me supozime e iluzione, si dhe t'i përmbahet rregullave akademike që të shprienë tek ajo. Entuziazmi i muslimanit për këtë është i shoqëruar me ndjenjën se kjo gjë është detyrë nga sheriatu mbi të, sidomos nëse ajo ka të bëjë me ajetet kuranore dhe hadithet e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Subjekti i çdo studimi, ose është "kallëzim" i transmetuar, ose "supozim" i pretenduar.

Kështu që metoda akademike imponon për "kallëzimet e transmetuara" thjesht perceptimin e saktësisë së atribuit të tyre tek thënësi i tyre, si dhe heqjen e asaj që mund të nxisë futjen e diçkaje të huaj apo mundësinë e asaj futjeje. Nëse kjo hiqet, atëherë ndërtohet mbi të një e vërtetë e caktuar akademike.

Ndërsa me ekzistencën e supozimit dhe pasigurisë, ajo nuk mund të ngrihet në të qënurit e një të vërtete të miratuar e të pranuar.

Metoda akademike imponon gjithashtu për "supozimet", të drejtuarin tek "lloji i argumenteve dhe provave" të përshtatshme. Kështu, teoritë që kanë të bëjnë me natyrën e sendeve materiale dhe përbërjen e tyre, kërkojnë prova shkencore eksperimentale konkrete. Teoritë që kanë të bëjnë me njohuritë abstrakte, si numrat, shpirti, logjika etj, kërkojnë faktet e tyre ligjore të miratuara.

Teoritë që kanë të bëjnë me të drejtat dhe çështjet juridike për konfliktet ndërmjet dy kondradiktorëve, me to nuk bëjnë dobi vetëm se provat dhe argumentet për të cilat është rënë dakord se ato janë të domosdoshme në lidhjen e tyre.

Dhe kështu, teoritë nuk mund të bëhen të vërteta shkencore të qëndrueshme, vetëm se pas bashkëgjithësisë së argumentit të përshtatshëm të tyre. Argumenti i cili nuk është kësaj natyre, nuk ka asnjë lloj vlere shkencore.

Allahu e mëshiroftë Ibën Tejmijen i cili ka thënë në librin e tij. "Kërkimi i ndihmës dhe kundërpërgjigja ndaj Bekrit" vëll.II, 628-629:

"Dija ndahet në dy gjëra: Ose transportim i vërtetuar, ose studim i kontrolluar. Të tjerat, përveç këtyre, janë përçartje të vjedhura dhe shumë prej fjalëve të këtyre janë të këtij lloji; prej përçartjeve. Ndërsa transmetimet që gjenden në të, disa prej tyre nuk u dallohet e sakta nga e shpifura, disa nuk i transmeton ashtu siç janë dhe disa i vendos jo në vendin e tyre.

Ndërsa, studimi dhe argumentimi për teorinë e tij është nga gjërat më të habitshme. Në të nuk përshtaten llojet e argumenteve, që të mund të dallohen ato që e provojnë, apo që nuk e provojnë teorinë e tij dhe as gradat e tyre (argumenteve), që të mund të paraprihet dominuesi mbi më të dobëtin, në rast të përplasjes së dy argumenteve me njëri-tjetrin."

Thuhet se njerëzit i dëmton gjysëm teologu, gjysëm juristi, gjysëm gramatikani dhe gjysëm doktori. I pari prish fetë, tjetri vendet, tjetri gjuhët dhe tjetri shëndetin."

Kjo theksohet më tepër nëse ai zhytet në një çështje, të cilës nuk i ka hyrë asnjë dijetar më parë dhe nuk ka nga kush të japë referime për të, as nuk është prej çështjeve kontradiktore ndërmjet dijetarëve, që të mund të zgjidhte njërin prej dy fjalëve, por ai mësyu mbi diçka e cila bie ndesh me fenë islame të njohur detyrimisht nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)."

Lidhja e haditheve me ngjarjet e ndodhura, sipas një rruge në të cilën nuk ka asnjë lloj përputhjeje ndërmjet tyre dhe as nuk ka lidhje ai argument me atë ngjarje apo me atë çështje të marrë në studim, përveç supozimit, iluzionit, hamendjes dhe daljes nga metoda akademike e saktë, gjë të cilën e themi me plotbindje për ato studime, artikuj e libra të cilat përmbajnë ngacmim dhe tërheqje të vëmendjes së njerëzve me anë të titujve të lustruar e tërheqës, të cilat ndeshen me atë dëshirë të përqendruar në shpirtrat e njerëzve për të mund të mësuar diçka prej të fshehtës që të dije se çdo të ndodhë më pas.

Kjo theksohet edhe më tepër kur mbi njerëzit bien dhimbjet, fatkeqësitë e krizat në ndonjë vend të caktuar.

Nëse ne nuk do t'i përmbahemi metodës akademike të sqaruar më parë, do të ngelim në përshtjellim dhe do t'i ekspozojmë tekstet e shpalljes para përgënjeshtimeve, talljes, përbuzjes, apo ndryshimit e ndërrimit të tyre.

Këtu po paraqesim disa rreziqe të leximit të haditheve të fitneve me qëllim të zbritjes së tyre në ngjarjet aktuale:

Së pari: Mosstudimi i saktësisë së tyre dhe pranimi i tyre me përçartjen e tyre, edhe pse ato mund jenë hadithe të shpikura e të paqëndryeshme.

Së dyti: Shtrembërimi i domethënies dhe nxjerrja e tyre nga pikësynimi i thënësit të tyre, për shkak të vuajtjeve dhe presionit aktual të studiuesit apo lexuesit të tyre, duke i marrë në mënyrë direkte dhe pa i ballafaquar me tekstet e tjera të të njëjtës temë, ose duke konkluduar prej tyre gjëra të tjera, pa u bazuar në rregullat e dijetarëve në konkludim.

Së treti: Prej llojeve më të këqia dhe më të rrezikshme të këtij shtrembërimi është shkelja e miratimeve dhe rregullave të përgjithshme, njësoj nëse kanë të bëjnë me sheriatin në përgjithësi, apo me fitnet në veçanti. Shembull për këtë është përcaktimi i kohës së bërjes së Kijametit, apo i kohës së daljes së Mehdiut, apo i kohës së rrëzimit të shtetit çifut e kështu, etj.

Së katërti: Gjëja më e rrezikshme në mënyrë absolute në lidhje me trajtimin e haditheve të fitneve është të kuptuarit e tyre sipas bazave të ithtarëve të të kotës; çifutëve dhe fallxhorëve. Kjo sepse hadithet e fitneve para përmbushjes së tyre në botën reale, janë më tepër komentim i "të përngjashmeve", kështu që, duhen pasur parasysh disa cilësi të së interpretuarës:

1. Kuptimi i drejtpërdrejtë i saj të jetë domethënia arabe. Nuk lejohet të bëhen shtesa të përdorimit të saj në gjuhën arabe. Si p.sh: Komentimi i gërmave të alfabetit me numra të caktuar, apo mrekullia numerike etj.

Kush preokupohet me këtë, ai hyn në temën e të përngjasuarit me çifutët.

Kundra këtyre, mund të argumentojmë me hadithin e nxjerrë nga Buhariu në librin "Et tarih el kebir", Ibën Xheriri në "Tefsirin" e tij dhe Ebu Amër ed Dani në "Sqarimi për numërimin e ajeteve të Kuranit". Transmetohet nga Ibën Is'hak, i cili ka thënë se i ka treguar El Kelbi, e ky e ka dëgjuar nga Ebu Salih, ky nga Ibën Abasi, ky nga Xhabir ibën Abdullah ibën Riab, të ketë thënë:

"Ebu Jasir ibën Ahtab bashkë me disa çifutë kaloi pranë të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i cili ishte duke lexuar hapjen e sures Bekare: **"Elif**

**lam mim. Ky është Libri në të cilin nuk ka asnjë dyshim.**" Atëherë ai shkoi te vëllai i tij, Huzej ibën Ahtab, i cili ishte në mesin e disa çifutëve dhe i tha:

- A e dini se unë dëgjova nga Muhamedi të lexonte prej asaj që i ka zbritur Allahu: **"Elif lam mim. Ky është Libri në të cilin nuk ka asnjë dyshim."**?

- A e dëgjove vërtetë këtë? - e pyetën.

- Po. - u përgjigj ai.

Atëherë Huzej ibën Ahtab bashkë me çifutët e tjerë shkuan tek i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe i thanë:

- O Muhamed, a është e vërtetë ajo që na kanë thënë se ti ke lexuar prej asaj që të ka zbritur: **"Elif lam mim. Ky është Libri në të cilin nuk ka asnjë dyshim."**?

- Po. - u përgjigj ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)

- A të ka ardhur me të Xhibrili nga Allahu? - thanë ata

- Po. - u përgjigj ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)

- Allahu ka dërguar para teje pejgamberë të tjerë për të cilët nuk dimë t'i jetë bërë e qartë ndonjërit prej tyre koha e sundimit të tij dhe koha e jetës së popullit të tij, përveç teje. - thanë ata.

Huzej ibën Ahtab, duke u kthyer nga ata që ishin me të tha: "Elifi është 1, lami është 30 dhe mimi është 40. Shuma e tyre është 71. A do të hyni në fenë e një të Dërguari, koha e sundimit dhe e popullit të të cilit do të jetë vetëm shtatëdhjetë e një vjet?!"

Pastaj u kthye nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe i tha:

- O Muhamed, a ka zbritur gjë tjetër si kjo?"

- Po. - tha ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)

- Çfarë? - e pyetën.

- **"Elif, lam, mim, sad"** (El Earaf: 1) - tha ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)

- Kjo qenka më e rëndë dhe më e gjatë: Elifi është 1, lami = 30, mimi = 40 dhe sad = 90.

Shuma e tyre është 161. - ia ktheu.

Po përveç kësaj, o Muhamed, a ka tjetër?

- Po. - u përgjigj ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)

- Çfarë?

Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: **"Elif, lam, ra"** (Jusuf: 1).

- Për Zotin, kjo është më e rëndë dhe më e gjatë. Elifi = 1, lami = 30 dhe ra = 200. Shuma e tyre është 231 vjet.

A ka tjetër përveç kësaj, o Muhamed? - e pyeti përsëri.

- Po, - u përgjigj ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe pastaj shtoi: **"Elif, lam, mim, ra"** (Er-Rad: 1).

- Kjo është më e rëndë, për Zotin dhe më e gjatë. Elifi = 1, lami = 30, mimi = 40 dhe ra = 200. Shuma e tyre është 271 vjet.

- Çështja jote na u përshtjellua, o Muhamed, saqë nuk e dimë nëse të është dhënë shumë apo pak kohë!

Pastaj u ngritën nga ai dhe Ebu Jasir i tha vëllait të tij, Hujei ibën Ahtabit, dhe atyre që ishin me të prej klerikëve çifutë.

- Ku i dihet, ndoshta Muhamedit i janë dhënë të gjitha këto bashkë:  $71+161+231+271=734$  vjet.

- Çështja e tij na u përshtjellua. - përfunduan ata.

Argumentimi me këtë hadith është i pavlefshëm, nga disa aspekte:

Zinxhiri i transmetimit të tij është i dobët, sepse El Kelbi rreth të cilit sillet hadithi, nuk i pranohet hadithi, nëse veçohet me të.

Ndërsa sikur të supozojmë se ai është i saktë, përgjigja për të është në disa aspekte:

Së pari: Është e ditur se ato shkronja nuk janë vendosur për të treguar numra të caktuar në gjuhën arabe dhe siç dihet, Allahu i Lartësuar e ka zbritur Kur'anin në gjuhën arabe, kështuqë arabishtja nuk mund të komentohet veçse me bazat e arabishtes dhe jo me ato iberiane.

Së dyti: Është e ditur se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i kundërshtonte çifutët në veprat dhe fjalët e tyre, kështuqë heshtja e tij dhe moskundërshtimi i tyre në këtë hadith është si heshtja e tij kur ata shkojnë në kishat e tyre.

Së treti: Ata e mohojnë që Kurani të jetë Fjalë e Allahut dhe e komentuan atë duke qënë dakord se po komentonin fjalë të rreme, sipas tyre.

Së katërti: Ka mundësi që heshtja e tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të ketë qënë për t'i shqetësuar dhe mërzhitur ata, sepse qëndrimi i tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) një ditë të vetme i bezdis dhe i shqetëson ata, po qëndrimi i tij për disa vjet?!

Së pesti: Është e ditur se kjo nuk është prej gjuhës së tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe të popullit të tij, sikur t'u thoshte atyre: Nëse ky është zakoni dhe gjuha juaj, ju e dini se ajo nuk është zakoni dhe as gjuha jonë, por ajo është diçka të cilën e nxorret nga vetja juaj. Prej këtui, nuk u mohohet atyre të merren vesh me njëri-tjetrin me çdo lloj shprehjesh.

Nëse thuhet se ku e dimë ne se ajo nuk ka qënë prej gjuhës së tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe as prej gjuhës së popullit të tij?

U përgjigjemi atyre se e dimë, sepse nuk ka ardhur asnjë shkronjë e vetme nga ndonjë sahab apo tabii që të përmbajë këtë kuptim, megjithëse neve na janë përcjellë komentimet e tyre të Fjalës së Allahut.

Pastaj kjo është e sigurtë që nuk është prej gjuhës së arabëve, të cilën e shkruan dijetarët e mëdhenj të gjuhës me përpjekje e lodhje të shumta, duke e ndjekur atë nëpër shkretëtira e lugina, nëpër beduinë e të civilizuar, por nuk gjen asnjë libër të gjuhës që të përmend diçka të tillë (komentimin e gërmave me numra).

Madje Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ka ndaluar nga ky lloj komentimi dhe ka thënë se ai është prej magjisë. Kjo tregon se ai e ka ditur që ky përdorim ka qënë tek çifutët, të cilët i përdorin nëpër magjira.

Ibën Kethiri në Tefsirin e tij thotë:

"Ndërsa ai që pretendon se këto shkronja (shkronjat në fillim të disa sureve) janë vendosur për të treguar periudha kohore të caktuara dhe se prej tyre mund të nxirret koha e ngjarjeve, fitneve dhe kasaphaneve, ai ka pretenduar diçka e cila nuk i takon atij dhe ka flutuar jo në qiellin e tij. Për këtë ka ardhur një hadith i dobët..." Pastaj përmendi hadithin që përmendëm më sipër nga Ebu Jasir ibën Ahtab.

Plotësisht si kjo, duke mos ndryshuar nga ajo aspak, është të argumentuarit me numrin e shkronjave të teksteve për çështje të fshehta, si trillimi i të argumentuarit me disa ajete (ajeti 109 në suren Teube) për ngjarjet e Amerikës të 11 shtatorit të 2001-it, të cilat patën ndikim të dukshëm në rrjedhën e ngjarjeve të mëpasshme, sidomos në Afganistan dhe Irak.

Kjo është një gënjeshtër me brirë, siç i thonë. Matja e kohës sipas lindjes së Krishtit nuk është e konsiderueshme në sheriatin tonë, kështu që llogaria e supozuar është e pavërtetë, por nuk e di se kujt i shërbejnë dhe në dobi të kujt janë këto njohuri të gabuara?!

Më e çuditshme është guximi që marrin disa njerëz për përkrahjen e këtyre përrallave dhe përbuzjen e librave të Tefsirit me fjalët: "Librat e tefsirit janë libra tradicionale dhe nuk i përmbushin kërkesat e kohës."

Metoda e Kuranit në lidhje me ngjarjet që do të ndodhin nuk i jep interes gjërave të tilla dhe as përcaktimit të vendeve e kohës, apo të personaliteteve dhe ngjyrave e prejardhjeve të tyre. Kjo është nga puna e gënjeshtarëve e mashtruesve, si dhe e atyre që kanë dyshim në zemrat e tyre, apo defekt në mendjet e tyre. Ata kanë lënë atë që është e sigurtë dhe u futën në studime me hamendje e iluzione, duke ndjekur rrugë qorre e të panjohura as tek sahabët, as tek tabiinët dhe as tek ata që pasojnë rrugën e tyre deri në Ditën e Kiametit.

2. Prej gjërave që duhen pasur parasysh në të interpretuarën është që ajo të kthehet në një domethënie të saktë në konsideratë, ku shprehja me të cilën ajo është interpretuar ta pranojë atë. Kjo, sepse mundësinë e të interpretuarës, shprehja mund ta pranojë në varësi të gjuhës dhe sipas qëllimeve të arabishtes. Ajo që degëzohet prej kësaj është ajo që përmendin të padisiplinuarit me rregullat e dijetarëve në argumentim, si shtrembërimi i emrave të ardhura në hadithe, shumica e të cilave janë të shpifura e të pasakta, duke i zbritur ato mbi personalitete bashkëkohorë.

Ata nuk u mjaftuan me hadithet e vërteta dhe as nuk u mbështetën në bazat e dijetarëve, por i lexuan ato kallëzime me paragjykime të mëparshme dhe u përpoqën t'i praktikonin ato hadithe mbi ngjarje të supozuara e të përfytyruara.

Pastaj kërkuan për argumentime të tyre të çdo lloj natyre qofshin, nga çdo lloj burimi, dhe i paraqitën ato me veshjen e haditheve të kasaphaneve e fitneve të kohës së fundit. Por koha i zbulon dhe i tradhton ata bashkë me trillimet e tyre, siç e kemi dëshmuar në shumë prej përcaktimeve të hamendjes së tyre.

Së pesti: Prej devijimit të leximit të haditheve të fitneve me qëllim të zbritjes së tyre mbi ngjarjet aktuale, janë edhe disa çështje shumë të rrezikshme, të cilat ndikojnë rrënjësisht në ligjshmërinë e argumentimit të burimeve prej të cilave duhet marrë dhe çdo tekst i tyre të vendoset në vendin dhe gradën e tij të fuqisë argumentuese, sepse ajo që është vënë re këto kohët e fundit është mbështetja plotësisht dhe marrja në mënyrë të miratuar nga librat e ithtarëve të librit (çifutët dhe të krishterët) si dhe preokupimi i njerëzve me to sikur të ishin diçka e prerë.

Sipas asaj që del në pah nga vepra e tyre, këto argumente kanë fuqinë e ajeteve kuranore dhe haditheve të sakta. Madje kallëzimet e marra nga ato libra kanë preokupuar grumbullimet e përgjithshme dhe janë përcjellë gojë më gojë, ndërsa hadithet e sakta në të njëjtën temë janë braktisur dhe thuajse nuk dëgjon askënd t'i përmend ato, megjithëse ato përmbajnë në vetvete mirësi dhe begati, rëndësi dhe domosdoshmëri për të cilat do të flasim më pas.

E keqja e kësaj nuk ka qëndruar në këtë kufi, por ajo e ka tejkaluar atë për t'u mbështetur në atë që nuk mban të mbështetesh në të dhe për të argumentuar me diçka që nuk ka frerë dhe as kapistër, veçanërisht në kohë fitnesh. Kohë pas kohe na vjen për to një kallëzim i trilluar i marrë nga një burim i degraduar për të cilin Allahu nuk ka zbritur ndonjë ligjshmëri apo provë, siç ka ndodhur në fitnen e parë të Gadishullit Arabik (lufta e Gjirit Persik) në lidhje me hadithin për "Sadimin" (apo Sadamin, sipas tyre)... e të ngjashme me të.

Së gjashti: Prej devijimeve të kësaj vepre është gjithashtu mësymja me një guxim të pashtershëm mbi gjërat e fshehta të cilat janë përmendur në tekstet hyjnore dhe lidhja e tyre me ngjarjet aktuale, apo të pritura, pa pasur asnjë shenjë apo argument që provon saktësinë e asaj lidhjeje. Siç kanë bërë shumë persona me lidhjen e "Trekëndëshit të



Bermudës" me Dexhalin, e shumë të tjera si këto.

\*\*\*

## **Mospraktikimi i haditheve të fitneve në kohën aktuale që jetojmë**

Dijetari dhe eksperti i madh, Salih ibën Abdul-Aziz ali Esh-Shejh, në librin e tij "Rregullat e sheriatit për pozicionin e muslimanit nga fitnet" f.25-53, në fund të atyre rregullave, ai thotë:

"O ti musliman, mos i praktikoj hadithet e fitneve në kohën aktuale në të cilën jeton, sepse njerëzve në kohën e shfaqjes së fitneve u pëlqen t'i kthehen haditheve të të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për fitnet dhe në tubimet e tyre shtohet fjala: I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë kështu dhe kjo është koha e saj, kjo është ajo fitne për të cilën ka folur! E të tjera si këto.

Selefët na kanë mësuar se hadithet e fitneve nuk zbriten në kohën aktuale, ndërsa vërtetësia e fjalës së të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për njoftimin e fitneve që do të ndodhin, shfaqet pas ndodhjes dhe përfundimit të tyre, duke treguar kujdes për të gjitha fitnet.

P.sh: Dikush e ka interpretuar fjalën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): "Fitneja në kohët e fundit do të jetë nën një burr prej familjes sime", se ai burr është filani i biri i filanit. Apo se me fjalën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): "Deri sa njerëzit të pajtohen nën besën e një burri farkëtar të fortë", është për qëllim filani i biri i filanit. Apo se fjala e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): "Ndërmjet jush dhe romakëve do të ketë një pajtim për siguri..." deri në fund të hadithit si dhe rrjedhën e ngjarjeve më pas, se gjoja kjo është në këtë kohë.

Ky praktikim i haditheve të të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në kohën aktuale dhe përhapja e tyre në mesin e muslimanëve, nuk është prej metodologjisë të ehli sunetit dhe xhematit.

Pasuesit e sunetit dhe xhematit i përmendin fitnet dhe hadithet e fitneve për të parajmëruar prej tyre dhe për të larguar muslimanët nga frekuentimi i tyre apo nga të afërmit atyre, me qëllim që të mos ndodhin trazira në mesin e muslimanëve dhe që të binden për saktësinë e atyre për të cilat ka njoftuar i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)."

\*\*\*

## **Përfitimi nga hadithet e fitneve, sipas metodës së rregullt akademike dhe gabimi i dy grupeve të dala nga rruga e drejtë**

Me gjithë ato që u thanë më sipër, ne duhet të përfitojmë prej haditheve ku përmenden trazirat sipas metodës së rregullt akademike dhe t'i trajtojmë ato, pas sigurimit për saktësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre me drejtësi, duke mos i bërë padrejtësi veteve tona me hedhjen e tyre poshtë dhe as të mos i bëjmë padrejtësi atyre, duke përsheptuar ndodhjen e tyre.

Detyra jonë është t'i kërkojmë mbrojtje Allahut prej tyre dhe të punojmë për luftimin e tyre. Nëse ne nuk do t'i luftojmë fitnet duke tharë rrënjët e mbirjes së tyre, na zunë!

Në trajtimin e haditheve të fitneve kanë humbur rrugë dy grupe kryesore:

Grupi i parë: Ky grup i ka pritur këto hadithe sipas metodës së "xhebrive" dhe i ka përsheptuar ngatërresat para ndodhjes së tyre, pastaj rrinë dyarkryq para tyre, pa lëvizur asnjë gjë nga ato që ka urdhëruar Allahu për ndjekjen e shkaqeve të ndryshimit të gjendjes. Këta e shfuqizuan synimin kryesor të haditheve për fitnet, sepse i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) na ka njoftuar me to me qëllim që të jemi të kujdesshëm prej tyre, të paralajmërojmë për to, të nxisim forcat tona shpirtërore për përgatitje para tyre, që të mos vijnë shtrëngatat dhe atëherë besimtari të thotë: "Ky është shkatërrimi im", pa ndryshuar gjë. Për këtë shkak i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tregoi kujdes që muslimanët të qëndronin larg trazirave të verbërta që ndodhin në mesin e tyre dhe që në atë kohë të preokupohen me adhurim. Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e bëri të qartë se kush janë thirrësat në trazira dhe cilësitë e tyre.

Po ashtu ka njoftuar (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për trazira që do të ndodhin ndërmjet muslimanëve dhe armiqve të tyre prej romakëve e të tjerë, prej trazirave nga jashtë. Gjithashtu i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e zmadhoi shumë paralajmërimin për Dexhalin, për cilësitë e tij.

Shembulli më i mirë që përmendet në këtë pikë është El Mehdi (Paqja qoftë mbi të!), për të cilin njerëzit përfytyrojnë se ai do të ketë fuqi të mbinatyrshme dhe një shkop magjik me të cilin do të ndryshojë gjendjen e muslimanëve, do të udhëheqë botën dhe do të përhapë Islam. Nuk ka dyshim se ai (Paqja qoftë mbi të!) do të ndihmohet nga Allahu i Madhëruar, por ai do të kryejë shkaqet e gjërave me mjeshtëri, njohuri e dije të plotë për atë që është e domosdoshme, tek e cila do ta udhëzojë Allahu dhe me anë të kësaj do të vijë begatia në duart e tij.

Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë) e ka shfaqur qartë këtë gjë në shumë tubime dhe libra të tij, prej të cilave po përmendim:

"Dije, o vëllai im musliman, se shumë prej muslimanëve sot kanë devijuar nga e vërteta në këtë çështje. Disa prej tyre u është fiksuar në vete se shteti islam nuk do të ngrihet vetëm se me daljen e Mehdiut. Ky është një trillim dhe errësi, të cilën shejtani e ka futur në zemrat e shumë njerëzve të thjeshtë, veçanërisht tek sufitet. Por në hadithet për Mehdiun nuk ekziston absolutisht asgjë që të jep këtë përshtypje, madje të gjitha ato nuk dalin nga të përgëzuarit e muslimanëve nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) me një burrë nga familja e tij, të cilin e përshkroi me disa cilësi të larta e të dalluara, më e rëndësishmja e të cilave është se ai do të gjykojë me Ligjet e Islamit dhe do të vërë drejtësinë në mes të njerëzve. Në fakt, ai është prej ripërtëritësve, të cilët Allahu i dërgon në krye të çdo shekulli, siç thuhet në hadithin e saktë të të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Ashtu si kjo nuk sjell për rrjedhojë lënien e angazhimit me dijen dhe të punuarit me të për ripërtëritjen e fesë, poashtu edhe dalja e Mehdiut nuk sjell për rrjedhojë vartësinë tek ai dhe lënien e përgatitjes dhe të punuarit për ngritjen e Ligjit të Allahut në tokë. Përkundrazi, e vërteta është e kundërta e kësaj, pasi që Mehdiu nuk do të mundohet më shumë se i Dërguari ynë, Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i cili vazhdoi për njëzet e tre vjet me radhë duke punuar për themelimin e shtyllave të Islamit dhe ngritjen e shtetit të tij.

Çfarë mund të bënte Mehdiu nëse do të dilte sot dhe do t'i gjente muslimanët në grupe e parti?! Ai nuk do të mund ta ngrinte shtetin Islam veçse pas njësimi të fjalës së tyre dhe bashkimit të tyre në një grusht të vetëm dhe nën një flamur të vetëm, gjë e cila sigurisht që kërkon një kohë relativisht të gjatë, të cilën e di vetëm Allahu.

Sheriati dhe logjika bashkë, kërkojnë që me këtë detyrë të ngrihen muslimanët e sinqertë, në mënyrë që kur të shfaqet Mehdiu, të mos ketë nevojë vetëm se për udhëheqjen e tyre drejt triumfit, dhe nëse nuk shfaqet, ata e kanë bërë detyrën e tyre, sepse Allahu thotë: **"Dhe thuaj: Punoni, sepse Allahu do ta shohë punën tuaj, edhe i Dërguari i Tij!"** [Teube: 105].

Disa të tjerë, në mesin e të cilëve edhe disa njerëz të veçantë (me dije), e kanë mohuar historinë e Mehdiut, duke argumentuar se ajo shpie në prishjen e akides së njerëzve duke besuar për Mehdiun cilësi të mbinatyrshme, për të cilat thamë më lartë se ato lloj përfytyrimesh të njerëzve janë të trilluara. Puna e tyre është si ajo e mutezilive, të cilët mohuan caktimin e Allahut për t'iu ruajtur akides së xhebrive (atyre që e mohojnë lirinë e njeriut në të vepruar).

Ndërsa një grup tjetër mendojnë se besimi tek Mehdiu është shfrytëzuar shumë keq në historinë Islame. Atë e kanë pretenduar shumë tendenciozë apo idiotë. Për shkak të saj kanë ndodhur shumë trazira të errëta, prej të fundit e të cilave ishte fitneja e

Xhuhejmanit në Haremin e Mekës. Kështuqë prerja e bishtit të këtyre fitneve bëhet duke mohuar këtë besim të saktë.

Shembulli i këtyre, është si shembulli i atij i cili mohon besimin në zbritjen e Isait (Paqja qoftë mbi të!) në fund të kohës, përmendja e të cilit ka ardhur në hadithet e sakta dhe muteuetira (të transmetuara nga grumbull i madh transmetuesish), pasi që disa dexhalinë kanë pretenduar se janë Isa, siç ka thënë Mirza, shërbëtori i Ahmed el Kadianit. Disa njerëz, e kanë mohuar vërtet zbritjen e Isait (Paqja qoftë mbi të!) duke e shprehur hapur këtë gjë, siç ka bërë Shejh Sheltut dhe unë mund ta them thuajse prerë se ai që e mohon daljen e Mehdiut, e mohon edhe zbritjen e Isait gjithashtu.

Shembulli i të gjithë këtyre mohuesëve, për mua, është si ai që mohon Hyjnimin e Allahut të Madhëruar, duke pretenduar se disa faraonë e kanë shpallur se janë zota. **"Atëherë, a ka ndonjë që të përkujtojë e të marrë këshillë?!"** [El Kamer: 15]."

Grupi i dytë: Ata të cilët marrin mbi supe hadithet e fitneve dhe veprojnë sipas teksteve të shpallura, por nuk janë të vëmendshëm për çështjet që duhen pasur parasysh në marrjen e gjykimit të shariatit për detyrën e kohës në trazirat që ndodhin dhe që do të ndodhin. Këta marrin tekste të shariatit prej ajeteve e haditheve të sakta, por i vendosin ato jo në vendin e tyre, kështu që nuk kanë sukses për arritjen e drejtësisë, pa të cilën nuk plotësohet mirësia.

Ngjarjet botërore, bashkë me fitnet të cilat do të vërshojnë si dallgët e detit, për të cilat ka njoftuar i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), fryti i tyre i jashtëm është triumfi i një populli mbi një tjetër, shfaqja e së mirës dhe e së keqes, komoditetit dhe vuajtjes, fisnikërisë dhe përçmimit në mesin e shoqërive. Por këto ngjarje kanë shkaqet e tyre dhe të lakmuarit e përshpejtimit të tyre para kohe dhe lidhja e ngjarjeve jo me shkaqet e tyre, është një dukuri e pasaktë, nën të cilën rrjedh ajo ku kanë arritur muslimanët sot në përgjithësi, si dhe ato të cilat kryejnë kuptimshkurtërit, të cilët marin guximin të ballafaqohen me hadithet e "ngjarjeve masive" dhe "çështjeve të mëdha", të cilat i përkasin të gjithë popullit, Ata të cilët janë prej të vegjëlve, njerëzve inferiorë dhe prej të përkëdhelurve që janë ulur në tryezat e dijetarëve, prej atyre të cilët e quajnë veten "njerëzit e ideologjisë" dhe "mendimtarët".

Nëse historia është tregim i gjendjeve të njerëzisë dhe grumbullim i ndodhive sipas renditjes kohore, pa sqaruar lidhjen ndërmjet tyre dhe pa kërkuar për shkaqet dhe gjurmët e tyre, po kështu edhe fitnet pas ndodhjes së tyre, do të bëhen pjesë e historisë dhe do të shënohen në të ngjarjet e tyre. Por para kësaj, ato janë të njohura për ne dhe do të ndodhin patjetër, por pa e ditur ekzakhtësisht kohën e tyre, edhe pse ne mund t'i kuptojmë shkaqet e lindjes së tyre. Detyra jonë është të përpiqemi për shtyrjen e tyre, të mësojmë shkaqet dhe të kemi parasysh rregullat që rezultojnë nga ato apo që i shoqërojnë ato.

## **Domosdoshmëria e të mësuarit të haditheve për fitnet dhe të bindurit për të saktat prej tyre sipas synimit për të cilin janë thënë**

E rëndësishme për hadithet e fitneve është që t'i njohim ato, të dimë të bashkojmë ndërmjet tyre, të dallojmë ndërmjet të saktave nga të pasaktat e tyre, të njohim Ligjin universal të Allahut me anë të haditheve në të cilat gjendet mburoja prej tyre, sepse kallëzimet e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) për to janë të padyshimta.

Detyra jonë është të besuarit në të gjitha ato që ka treguar i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në këtë temë, ashtu siç besoi dhe miratoi Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) tregimin e Israsë, në kohën kur mendja e mosbesimtarëve kurejshite nuk e honepste dot, ata të cilët e matën Fuqinë e Allahut me mendjet e tyre, ndryshe nga i sinqerti (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i cili e njohte vërtetësinë e Fjalës: **"Ai nuk flet nga dëshira dhe mendja e tij"** [En-Nexhm: 3].

Ai e dinte gjithashtu se Allahun nuk e sfidon asgjë, siç ka kallëzuar për Vetën e Tij: **"Dhe Allahu është gjithnjë i Zoti për të bërë çdo gjë."** [El Ahzab: 27].

Ai që e njeh Fuqinë e Zotit të tij të Madhëruar dhe sinqeritetin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), mendja e tij nuk ngushtohet nga të pranuarit e njoftimeve të tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Kështu që tregohu i vëmendshëm ndaj mohimit të teksteve, në të cilat i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka njoftuar për gjëra që do të ndodhin në të ardhmen, ashtu siç ka njoftuar ai dhe pa shtuar apo pakësuar gjë prej tyre.

Dije se prej mohimit të tyre, është edhe devijimi i tyre nga domethënia e drejtpërdrejtë, pasi që sheriatu nuk ka ardhur me gjëgjëza për të hutuar mendjet e njerëzve. Përkundrazi, ai e ka bërë të qartë synimin e tij me gjuhën e qartë arabe. Allahu i Lartësuar thotë: **"Ne nuk kemi sjellë të Dërguar vetëm se me gjuhën e popullit të tij, ashtu që ai t'ua bënte të qartë (mesazhin atyre)."** [Ibrahim: 4].

Nuk duhet të na shtyjë aktualiteti i kohës sonë, mënyra e të jetuarit apo zhvillimet shkencore, në interpretimin e diçkaje prej shenjave të Kiametit, të cilat nuk kanë ndodhur ende. Rrjedha e ngjarjeve është prej të fshehtës, ditët sjellin të reja dhe ne nuk e dimë se çdo të bëhet. Masa proteksioniste (mbrojtëse) është në të qëndruarit tek hadithet e sakta, por kjo gjë nuk ndodh sipas mënyrës së përmendur më sipër, vetëm se tek pak njerëz, të cilëve Allahu u ka dhënë bindje të plotë dhe ngritje në gradë me anë të dijes së dobishme dhe imanit të fortë i cili i shkakton atij përfytyrim të saktë, vigjilencë dhe shqetësim për popullin për shkak të pakujdesisë dhe gjynaheve të tyre. Për këtë arsye, Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) thoshte:

"Do të doja të kisha njëqind burra me zemra prej ari, pastaj të ngjitesha mbi një shkëmb dhe t'u tregoja një hadith pas dëgjimit të të cilit ata nuk do t'i dëmtojë kurrë asnjë fitne. Pastaj të shkoj dhe të mos i shoh më ata dhe as ata të mos më shohin më mua!"

Nga kjo thënie e Hudhejjes (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) përfitohet se dija e sigurtë për fitnet është shkak prej shkaqeve të qëndrimit larg saj dhe për këtë arsye shumë prej njerëzve i keqkuptojnë hadithet e fitneve dhe e përmbysin pikësynimin e kallëzimit të tyre. Kemi dëgjuar shumë prej tyre të justifikohen se çështja ka marrë fund dhe rruga e përmirësimit është mbyllur.

Por trazirat dhe forcimi i tyre me kalimin e kohës, nuk do të thotë ndonjë lloj detyrimi apo caktimi që përfshin njerëzit, pa pasur ata faj në to, apo pa i përshpejtuar shkaqet dhe parapërgatitjet e tyre.

Ky lloj të kuptuari, të cilin e thamë edhe më parë, është i shpikur dhe i futur mbi të kuptuarin e sahabeve (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) dhe në të ka tejkallim dhe shkelje të të vërtetave të miratuara dhe të Ligjeve të Allahut të Madhëruar.

\*\*\*

## **Adoleshentët dhe hadithet e fitneve**

Bidat më i madh se ai më lart (dhe në të cilin ka dalje të plotë nga menhexhi i selefëve të mirë, nga bazat që ndjekin dijetarët dhe nga logjika e shëndoshë), është ajo që bëjnë një grup "adoleshentësh", sipas ideve të tyre, të ngarkuarit me atë që nuk iu është ngarkuar, zbritësit e ngjarjeve aktuale mbi hadithet dhe etheret e fitneve, me anë të kumarit, hamendjes, iluzionit dhe cytjeve të shejtanit, si dhe prerja e kësaj pa ndonjë ngurrim. Po kështu edhe emërtimi i personave (shumica e të cilëve janë politikanë e të shquar), vendeve dhe ngjarjeve, si dhe përcaktimin e kohës nga disa prej tyre. Por e gjitha kjo është prej dështimit, sepse për kohën që ata përcaktuan dhe për ngjarjet të cilave ata i caktuan emrin, rrjedhën dhe heronjtë, gënjeshtra dhe injoranca e tyre doli sheshit për një pjesë të tyre, ndërsa për pjesën tjetër pritet të dështojnë gjithashtu.

\*\*\*

## **Kapitulli i tetë**

**Kushtet dhe rregullat e praktikimit të haditheve të fitneve mbi ngjarje reale**

Ka disa kushte dhe rregulla me anë të të cilave mund të thuhet se lejohet t'i përdorësh tekstet e shpalljes mbi një ngjarje të caktuar. Këto kushte po i paraqesim si vijon:

Së pari: Është e domosdoshme të sigurohemi për saktësinë e tekstit të caktuar, për saktësinë e shprehjeve të tij dhe të mbledhim të gjitha transmetimet e tij, me qëllim që të njohim domethëniet e tij.

Duhet të bëhet e ditur se sado që të përpiqet dhe të lodhet studiuesi për kuptimin e teksteve apo praktikimin e tyre mbi ndonjë ngjarje të caktuar, i gjithë mundi dhe përpjekja e tij është e padobishme dhe pa vlerë, nëse bëhet e qartë se ai tekst nuk qëndron. Për këtë arsye, dhe me qëllim që studiuesi të përfitojë nga koha dhe mundi i tij, ai duhet të ketë parasysh këtë kusht të rëndësishëm, i cili është baza dhe themeli i çdo gjëje.

Mund të theksojmë këtu se ky kusht metodologjik mungon plotësisht tek shumë studime të shfaqura kohët e fundit rreth shenjave të Kiametit dhe kasaphaneve, për shkak se autorët e tyre kanë qënë të etur për përdorimin e këtyre haditheve mbi ngjarje të caktuara, të cilat u futën në mendjet e tyre dhe se gjoja këto hadithe kanë për qëllim këto ngjarje.

Sigurisht që pasi të sigurohemi se ai tekst i caktuar nuk është i qëndrueshëm, atëherë procesi i praktikimit anulohet dhe nuk i jepet asnjë lloj peshe.

Së dyti: Mosargumentimi për pasojat dhe me kuptime jo të drejtpërdrejta të teksteve, si dhe largimi nga të radhiturit e ngjarjeve të përmendura në tekste pa pasur argument.

Së treti: Ky praktikim duhet të mbetet në rrethin e probabilitetit të supozuar, pa u shtrënguar që t'i gjejmë atyre rrjedhje nga vetja jonë, sepse ngjarjet dhe ndodhitë janë çështje universale të caktuara, të cilat do të ndodhin patjetër, por ne nuk na është kërkuar që t'i nxjerrim ato nga bota e fshehtë në atë të dukshmen.

Së katërti: Ky praktikim dhe probabiliteti që rrjedh prej tij, të mos ndikojë në kryerjen e detyrës së kohës dhe ngarkesave të sheriatit.

Së pesti: Ai që e ndërmerret praktikimin e haditheve mbi ngjarje aktuale, duhet të jetë dijetar i aprovuar nga dijetarët e tjerë, pasi kjo punë është interpretimi dhe shpjegimi më i përpiktë i tekstit. Ky është kufizim i domethënies së tij në një ngjarje të caktuar, të ngjashme me të cilën kanë ndodhur edhe në kohët e kaluara me ndonjë ndryshim në ndonjë cilësi, apo në përmendjen e ndonjë kohe a vendi, apo të ndonjë personaliteti të përmendur në tekst. Kështu që mësymja për shkak të ngjashmërisë dhe imagjinatës pa maturi nuk është prej metodës akademike, aq më tepër kur dihet se ngjarjet nuk kanë mbarim.



Duhet pasur parasysh këtu, se muxhtehidi (juristi islam) duhet t'i përmbahet një rregulli metodologjik: Lirimit së plotë dhe objektivizmit.

Është për qëllim me "lirimin": Lirimi i muxhtehidit nga të gjitha vendimet e mëparshme dhe qëndrimet e ndryshme, me qëllim që t'i drejtohet tekstit të shpallur me mentalitet të paanshëm duke pasur për synim njohjen e qëllimit hyjnor, pa marrë parasysh nëse ai qëllim ku do të arrijë është në përputhje me vendimet e tij të mëparshme, apo në kundërshtim me to.

Ndërsa me "objektivizmin" është për qëllim lirimi i muxhtehidit nga identiteti i tij dhe nga njëanshmëria për mendimet dhe vendimet e tij të mëparshme.

Rëndësia e këtij rregulli metodologjik qëndron në të qënurit e tij si rregulli i shtypur në mesin e rregullave metodologjike të jurisprudencës për kuptimin e teksteve, për shkak se ai shpeshherë harrohet, shpërfillet dhe nuk përmendet veçse rrallë herë. Për shkak të kësaj shpërfilljeje u përhap tefsiri (interpretimi) politik dhe medhhebi i teksteve hyjnore, Kuranit dhe Sunetit.

Madje rëndësia e këtij rregulli zbardhet edhe më shumë në të qënurit e tij si metodologjia e ndjekur nga sahabët e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në trajtimin e tyre të teksteve hyjnore, gjë e cila e bëri të kuptuarin e tyre të paarritshëm dhe të pakrahasueshëm, pasi sahabët shpenzonin mundin e tyre për të kuptuarit e tekstit Hyjnor, pa i marrë qëndrimet dhe drejtimit e tyre gjyqtare të të kuptuarit të tyre.

### **Letra e shejhut të Islamit Ibën Tejmije drejtuar mbretit sulltan En nasir për çështjen e tatarëve**

Shejhu i Islamit, Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) e ka trajtuar "fitnen e tatarëve" në një letër drejtuar mbretit En Nasir. Kjo letër provon të kuptuarit e thellë të haditheve të fitneve, duke mos i shfuqizuar detyrat koherente të sheriatit të ngarkuara udhëheqësit dhe masës së gjerë të popullit.

Për shkak të rëndësisë së kësaj letrë në kuptimet e praktikimit të haditheve të fitneve, po e transportojmë të plotë megjithë gjatësinë e saj:

Sulltanit të muslimanëve, me të cilin Allahu e ndihmoftë fenë, i ndrydh të kafirat dhe hipokritët, fuqizoftë ushtrinë e besimtarëve dhe i ngadhënjeftë me të mbi popullin shkatërrimtar!

Selamun alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu! Ne falenderojmë Allahun e Madhëruar, i Cili është Një e i Pashok, Zot i falenderimit, i Mundshëm për çdo gjë. E lusim Allahun të dërgojë salavat mbi Muhamedin, robin dhe të Dërguarin e Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Allahu i ka garantuar ndihmesën kësaj feje deri në Ditën e Kijametit, si dhe triumfin e saj mbi të gjitha fetë. Ai Vetë ka dëshmuar për këtë gjë dhe neve na mjafton Allahu si Dëshmues.

I sinqerti dhe i besueshmi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka njoftuar se një grup prej popullit të tij do të vazhdojë të qëndrojë në të vërtetën dhe nuk do t'i dëmtojë ata braktisësit e tyre deri në Ditën e Kiameti, si dhe ka njoftuar se ata do të jenë në anën perëndimore të Mekës dhe Medines, e cila është toka e Shamit dhe ato pas tij.

Ashtu si dhe na ka njoftuar se nuk do të bëhet Kiameti, derisa të luftojmë turqit, njerëz me sy të vegjël, me hundë të shtypur, që mbathin flokë në këmbë (sandale me qime kafshësh), sikur fytyrat e tyre të ishin mburoja të shtypura.

Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka njoftuar gjithashtu se populli i tij do të vazhdojë t'i luftojë popujt e tjerë derisa të luftojnë Dexhalin me një sy të verbër, në kohën kur Isai, biri i Merjemes, të zbresë nga qielli mbi minaren e bardhë në lindje të Damaskut. Atëherë muslimanët do të vrasin ushtrinë e ardhur me të prej çifutëve e të tjerë.

Ka njoftuar se Allahu i Lartësuar i dërgon këtij populli në krye të çdo njëqind vjetëve dikë që i ripërtërin atij fenë e Tij, dhe ripërtëritja nuk bëhet veçse pas shkatërrimit.

Ai (sal-lallahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "I kërkova Zotit tim që të mos i japë pushtet ndonjë armiku të jashtëm mbi popullin tim, në mënyrë që t'i çrrënjosë ata, dhe Ai ma dha këtë. Pastaj i kërkova Atij që të mos i shkatërrojë ata me thatësi të përgjithshme, dhe Ai ma dha këtë."

Provat e profetësisë së tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) vazhdojnë të shfaqen njëra pas tjetrës dhe Allahu shfaqti në atë fitne prej Mëshirës së Tij me këtë popull dhe ushtrinë e tij, gjë në të cilën ka shembull të mirë, pasi Ai i sprovoi ata me diçka që iu fshin me të gjynahet e tyre, i bën që të kthehen me zemrat e tyre nga Zoti, që të bashkohet fjala e tyre nën udhëheqësin e tyre, që të hiqet përçarja dhe kundërshtimi ndërmjet tyre dhe që të ndezë shpirtat për të luftuar në Rrugën e Allahut ata që kanë dalë nga Ligji i Allahut.

Kjo fitne që ndodhi, megjithëse ishte e dhimbshme për zemrat, por ajo (me Lejen e Allahut) nuk është vetëm se si ilaçi që i jepet të sëmurit me qëllim që të shërohet e të fuqizohet. Ndërkohë që nuk mund të mohohet se te njerëzit kishte hyrë

mendjemadhësia, injoranca dhe tirania, kështu që nëse do të ndodhte ajo që ata dëshironin prej lavdisë e famës, ajo do të pasohej nga një katastrofë e madhe.

Allahu i mëshiroi robërit e Tij me Mëshirën e Tij, me të cilën Ai është më i Mëshirshëm se nëna për fëmijën e saj. Kështu që iu bë e qartë të gjithë muslimanëve, nga Lindja në Perëndim, realiteti i gjendjes së këtyre shkatërruesëve të dalë nga sheriatu i Islamit, edhe nëse shprehin dy dëshmitë. Atëherë mësoi ai që nuk e dinte se në ç'gjendje ishin ata prej injorancës, tiranisë, hipokrizisë, pështrjellimit dhe të larguarit nga ligjet dhe natyra e Islamit. Por më pas, në kampet islame u bashkuan shpirtra të cilët më parë u kishin kthyer shpinën, u zbutën zemra, të cilat më parë ishin të ngurta dhe Allahu zbriti prej engjëjve dhe qetësisë së Tij, atë që nuk ishte me ta në atë fitne. Shpirtrat e besimtarëve u bënë të mirë me shpenzimin e pasurive dhe veteve të tyre në xhihadin në Rugë të Allahut dhe u përgatitën për luftimin e armiqve të Allahut dhe armiqve të tyre. U zgjuan nga gjumi i tyre dhe falenderuan Allahun për mirësinë që dha në gatishmërinë e mbretit dhe ushtrisë për xhihad dhe për pasuritë që u mbledhën për të shpenzuar në Rugën e Allahut.

Allahu u ka bërë detyrë muslimanëve xhihadin me trup dhe pasuri dhe xhihadi është i detyrueshëm për çdo musliman të mundshëm, ndërsa ai që nuk mundet të luftojë me veten e tij, atëherë ka për detyrë të luftojë me pasurinë e tij nëse ka dhe i mjafton për këtë. Allahu e ka bërë xhihadin të detyrueshëm me pasuri dhe me trup, dhe ai që i fsheh pasuritë në rast nevojë për to që të shpenzohen në xhihad, prej mbretërve, princave, të moshuarëve, dijetarëve, tregtarëve prodhuesëve, ushtarëve etj, ai hyn në Fjalën e Allahut: **"Dhe ata të cilët grumbullojnë pasuri në ar e argjend dhe nuk e shpenzojnë atë në Rugën e Allahut, përgëzoji me dënim të dhimbshëm, ditën kur ajo (pasuri) të nxeht fortë në zjarrin e xhehenemit dhe me të do të damkoset balli, krahët dhe shpina e tyre, (duke iu thënë): Kjo është ajo që grumbulluat dhe groposët për veten tuaj, kështu që shijoni atë që grumbulluat!"** [Teube: 34-35].

Aq më tepër, nëse ato pasuri kanë qenë nga banka e shtetit të muslimanëve, apo pasuri që janë marrë nga kamata, apo që nuk është dhënë zekati i tyre dhe nuk është dhënë drejta e Allahut në to.

Kush e lë xhihadin, atë e dënon Allahu me dënim të dhimbshëm, me përçmim e të tjera, si dhe ia heq çështjen atij dhe ia jep dikujt tjetër, sepse kjo fe është e atij që e ruan dhe e mbron atë.

I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) thotë: "Luftoni në xhihad, sepse ai është një derë prej dyerve të xhenetit dhe me të Allahu largon shqetësimin dhe trishtimin!"

Kur populli të luftojë armikun e tij, Allahu do të bashkojë zemrat e tij dhe nëse ai e lë xhihadin, Allahu i angazhon ata me njëri-tjetrin.

Në këtë çast, zemrat janë të ndezura dhe fërgëllojnë për ndihmën e Allahut kundër popullit shkatërrimtar, saqë në Musil, në Gadishull dhe në malet kurde gjenden njerëz të shumtë të gatshëm për xhihad, në pritje të ushtrive, pa marrë parasysh nëse armiku do të lëvizë apo jo....

Nuk është e detyrueshme që të lihet triumfi i Allahut dhe xhihadi në Rrugën e Tij, nëse armiku i Allahut dhe i muslimanëve është përçarë në vetvete, por ky është rast i volitshëm nga i cili duhet përfituar. Muslimanëve nuk u lejohet të presin që ata të shkelin vendet muslimane, siç bënë një vit më parë, sepse i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Nuk ka popull që sulmohet në oborrin e tij, veçse poshtërohet."

Allahu e ka bërë të obligueshëm për muslimanët xhihadin kundër atyre që kanë dalë nga feja e Tij edhe nëse ata na sulmojnë neve, ashtu siç përgatiste i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe zëvendësat e tij ushtritë kundër armiqve, edhe nëse armiqtë nuk i kishin për synim ata. Pastaj, pas vdekjes së të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e cila ishte gjëma më e madhe dhe populli u shpërnda e u kundërshtuan në mes vete, Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) e angazhoi ushtrinë e Usame ibën Zejd të cilin i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e kishte caktuar komandant të saj për të luftuar të krishterët në Sham, ndërkohë që muslimanët në atë kohë ishin në kulmin e dobësisë.

Kur armiku i pa ata, u frikësua dhe tha: "Sikur këta të kishin qenë të dobët, nuk do të dërgonin ushtri"!

Po kështu edhe Ebu Bekri i tha Umer ibën Hatabit kur iu afrua vdekja: "Të mos iu preokupojë vdekja ime nga luftimi i armikut tuaj." Kështu që ishin ata që i mësynin armikut dhe nuk ishin të mësyer.

Po kështu në kohën kur një princ i Halebit u nis me një ushtri në Gadishull për gjueti, reputacioni i atyre vendeve ra me mbërritjen e asaj ushtrie. Zemrat e tyre u mbushën me frikë saqë filluan të shfaqin uniformën muslimane që të mos sulmoheshin. Në zemrat e armiqve kishte hyrë aq frikë sa nuk e dinte kush përveç Allahut.

Më e pakta që i detyrohet muslimanëve të luftojnë armikun e tyre është një herë në çdo vit dhe nëse e lënë më shumë se kaq, ata kanë kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe meritojnë ndëshkimin. Po kështu edhe nëse qëndrojnë ulur derisa armiku të mësyjë tokat e Islamit, gjë për të cilën dëshmon provimi i kësaj. Përsa kohë që muslimanët i mësynin ata në vendet e tyre, ata ishin ngadhënjimtarë, ndërsa në dy alternativat e Himsit, në të parën dhe në të dytën, kur muslimanët u dhanë rast atyre që të hynë në vendet e tyre, muslimanët në atë alternativë ishin gati të thyheshin sikur të mos i rrënjoste ata. Gjatë asaj periudhe ndodhi ajo që ndodhi dhe sa herë që muslimanët i mësynin ata, ngadhënjenin, si në alternativën

e "Ajn Xhalut", "Ofratit" dhe me romakët, të cilët shpresojmë që Allahu t'i çrrënjosë dhe nuk ka mundësi e fuqi veçse me Allahun. Përgëzimet për këtë janë të disponueshme.

Por kjo alternativë nuk është si ajo, pasi në të kishte çështje të cilat nuk shkon t'i përmendim, Allahu i faltë ato, dhe ajo që Allahu bëri me muslimanët ishte më e lavdërueshme për ta.

Pastaj nuk ka dyshim se Allahu e ndihmon fenë e Tij dhe merr hak prej armiqve të Tij, siç thotë: **"Sikur të donte Allahu, Ai Vetë do t'i ndëshkonte ata, por (Ai iu lë të luftoni ju) që t'iu sprovtojë juve me njëri-tjetrin, ndërsa ata që vriten në Rrugën e Allahut, Ai nuk do t'i lerë të humbasin veprat e tyre. Ai do t'i udhëzojë dhe t'ua përsosë atyre gjendjen. Dhe do t'i fusë në xhenet të cilin ua ka bërë të njohur atyre (më parë, ua ka premtuar). O ju që keni besuar, nëse ju e ndihmoni Allahun, Ai iu ndihmon juve dhe iu bën të qëndroni fortë në këmbët tuaja."** [Muhamed: 4-7].

Në luftën në Rrugën e Allahut ka disa lloje të dobive:

E para: Qetësia e zemrave të njerëzve me qëllim që të ndërtojnë e kultivojnë, përndryshe gjendja e tyre nuk do të jetë e qëndrueshme.

E dyta: Vendet veriore si Halebi e tjera, disponojnë begati e të mira të shumta prej të cilave përfiton ushtria muslimane.

E treta: Xhihadi forcon zemrat e muslimanëve të atyre vendeve dhe i shton panikun armikut, por nëse nuk kryhen lëvizje, zemrat ftohen dhe ndoshta disa prej tyre kthehen me armikun, sepse populli bëhet me atë që ngrihet.

Kur ushtria erdhi në Sham, leverdia ishte e madhe dhe nëse disa prej tyre do të përparonin drejt kufijve, do të ishte akoma më mirë.

Dobia e katërt: Sikur ata të marshonin drejt Gadishullit derisa të merrnin drithin dhe pasurinë e mbretërisë pa i dëmtuar muslimanët, kjo do të ishte prej dobive më të mëdha dhe sikur të marshonin duke mbledhur njerëz dhe fuqi ushtarake, princat e atyre vendeve do vinin tek ata dhe kështu do të bashkoheshin ushtri të mëdha. Shumica e banorëve të vendeve i kanë zemrat me muslimanët, përveç kafirave të krishterë e të ngjashëm me ta, si dhe përveç rafidive shumica e të cilëve i kanë zemrat me armikun. Këta shfaqën gëzim në thyerjen e ushtrisë muslimane si dhe shfaqën hare me fatkeqësinë e muslimanëve. Diçka e tillë është e njohur prej tyre që në krizën e Bagdadit dhe Halebit...

Nuk është prej sheriatit Islam që muslimanët ta presin armikun e tyre derisa të vijë tek ata. Këtë nuk e ka urdhëruar as Allahu, as i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe as muslimanët. Por muslimanët duhet t'i mësyjnë ata duke luftuar në Rrugë të Allahut dhe nëse fillojnë ata të lëvizin të parët, atëherë nuk lejohet t'u jepet

mundësia që të hyjnë në vendet e muslimanëve, por është e detyrueshme që ushtritë muslimane të përparojnë në kufijtë e vendeve të tyre dhe Allahu zgjedh për muslimanët në të gjitha çështjet atë që është më e mira për dynjanë dhe botën tjetër.

“Ues-selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!  
Uel-hamdu lilahi uahdehu ue sal-lallahu ala Muhamedin”!

\*\*\*

### **Xhiahadi në kohë fitness**

Shejh Meshhuri (Allahu e ruajt!) thotë: “Ajo që gjendet në këtë letër është një deklaratë koherente nga feja dhe ajo që na ka ngarkuar Allahu në Librin e Tij dhe në gjuhën e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Bashkë me këtë ai (Allahu e mëshiroftë!) përmendi mësymjen e tatarëve dhe e konsideroi atë si një ilaç të dhimbshëm, por me të cilin arrihet shërimi. Pastaj sqaroi se si muslimanët përfituan nga ajo disfatë dhe megjithatë, ai (Allahu e mëshiroftë!) nuk i mënjanoi hadithet e fitneve dhe nuk e zhvlerësoi atë që duhet pasur parasysh në ndodhjen e tyre.

Këtë gjë, ai e shfaqti me disa fjalë, të cilat i kënaqin rregulluesit e mençur që punojnë pas miratimeve të dijetarëve, në librin e tij "Kërkimi i ndihmës në kundërpërgjigjen ndaj Bekrit" (Vëll II, f. 631) duke folur për gjendjen e muslimanëve në kohën kur tatarët i mësynë ata dhe duke përshkruar kundërvajtjet e tyre në akide:

"Ky dhe të tjerë si ai, në aspektin tjetër, lusnin të vdekurit dhe u kërkonin atyre, iu mbështeteshin dhe iu përulleshin atyre, apo edhe më shumë se kaq. Sepse ata i drejtoheshin të vdekurve në një katastrofë që u ra atyre dhe i luteshin me lutjen e nevojtarit, duke shpresuar se do t'i u përmbushen nevojat me lutjen e tyre, apo me lutjen me ta (si ndërmjetësa), apo me lutjen tek varret e tyre. Ndryshe nga adhurimi i tyre Allahun dhe lutjen e tyre Atë të cilat shpeshherë i bëjnë nga tradita dhe shtirja. Kështu që kur armiku doli nga sheriatit i Islamit, hyri në Damask, ata dolën t'i kërkonin ndihmë të vdekurve tek varret e tyre për të cilat shpresonin të largonin fatkeqësinë e tyre.

U thashë atyre se këta të cilëve ju u kërkonin ndihmë, sikur të ishin me ju në luftë do të ishin mundur, ashtu si u mundën ata që u mundën prej muslimanëve në ditën e Uhudit.

Por, ishte caktuar që ushtria të thyhej për shkaqe që bënë të mundur atë dhe për një Urtësi që kishte Allahu i Madhëruar në këtë gjë."

Pastaj tha se kjo është pika e argumentimit tonë.

"Për këtë shkak, njerëzit e njohur me fenë dhe kuptimgjerët, nuk luftuan asaj radhe për shkak të mosekzistencës së luftës së ligjshme, për të cilën ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe për shkak të sherrit, shkatërrimit dhe mosdisponimit të ndihmës së kërkuar në luftë, pa të cilat nuk mund të ketë fitore të dynjasë dhe as të botës tjetër, për atë që e njeh këtë, edhe pse shumë prej luftëtarëve të cilët menduan se ajo luftë ishte e ligjshme, janë shpërblyer sipas qëllimeve të tyre.

Pas kësaj, ne filluam të urdhërojmë njerëzit që ta bëjnë adhurimin me singëritet vetëm për Allahun, të kërkojnë ndihmë vetëm prej Tij, të mos i kërkojnë ndihmë askujt tjetër përveç Allahut, të mos i kërkojnë ndihmë ndonjë engjëlli të afërm (tek Allahu) dhe as ndonjë peygamberi të dërguar, siç thotë Allahu i Lartësuar për ditën e Bedrit:

**"(Përkujtoni) Kur ju i kërkuat ndihmë Zotit tuaj dhe Ai iu përgjigj juve..."** [El Enfal: 9].

"Kur njerëzit e përmirësuan gjendjen e tyre dhe ishin të singërtë në kërkimin e ndihmës vetëm nga Zoti i tyre, Ai i ndihmoi ata mbi armikun e tyre me një ndihmë të fortë të paparë më parë, madje tatarët nuk kanë pësuar asnjëherë disfatë të tillë. E gjitha kjo, për shkak të saktësisimit të teuhidit të Allahut dhe bindjes ndaj të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), gjë e cila nuk gjendej më parë tek ata. Kështu, Allahu e ndihmon të Dërguarin e Tij dhe ata që kanë besuar, në jetën e kësaj bote dhe në ditën kur do të ringjallen krijesat."

**kthehu lart**

\*\*\*

## Kapitulli i nëntë

### Si duhet t'i kuptojmë hadithet e fitneve

Fenomeni i të treguarit të të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të fshehtat dhe profetësitë, pushton pasionin dhe vëmendjen e çdo lexuesi të librave të sunetit: Ç'domethënie kanë? Ç'është për qëllim me to? Cili është ndikimi edukativ i tyre në shpirtin njerëzor? Cilat janë gjurmët e tyre në akiden Islame, në hovin e muslimanit drejt thirrjes për tek Allahu i Madhëruar dhe në praktimin e Islamit në mënyrën e të jetuarit?



Për të njohur diçka nga të gjitha këto, duhet patjetër ta analizojmë këtë fenomen me analizë ligjore, që buron nga parimet kuranore, hadithet profetike, gjurmët e selefëve dhe konceptet autentike islame, pastaj t'i interpretojmë ato sipas atyre bazave të përgjithshme, si dhe të analizojmë qëllimet e tyre në formimin e personalitetit Islam.

Ky fenomen, tërheq vazhdimisht vëmendjen tonë për të ditur se ç'mund të përfitojmë nga ky grumbull i madh i haditheve profetike, të cilat flasin për fitnet dhe shenjat e Kiametit, dhe ndoshta është shpejt dhe para kohe që të nxitohemi e të themi se ky fenomen kërkon studim analitik të drejtë nga persona të kualifikuar e të interesuar për shkencat sociologjike, humane dhe psikologjike.

Por, kjo nuk na pengon që në këtë shqyrtim të shpejtë të hedhim pak dritë mbi disa pika të lidhura me shkaqet e atyre, për të cilat jemi duke folur, si dhe të bëjmë aluzion për shkarjet e rrezikshme, pre e të cilave bien shumë prej muslimanëve sot, për shkak të të kuptuarit të tyre të gabuar kundrejt domethënies së haditheve dhe profetësive.

Kjo është një çështje kritike, sidomos kur gjejmë tek shumë të rinj muslimanë, për të cilët do të ishte më e denjë të qëndronin më larg se të tjerët nga këto shkarje të rrezikshme ideologjike, (gjejmë tek ata) lejim të ndodhjes së ngjarjeve dhe dorëzimit tek caktimet (sipas supozimit të tyre), si dhe largim nga kërkimi dhe zbulimi i shkaqeve të vërteta dhe faktorëve të fshehtë, të cilat manovrojnë lëvizjen e historisë dhe ndryshojnë trajektoren e lëvizjes shoqërore të çdo lloj shoqërie qoftë.

Shumë prej muslimanëve sot, veçanërisht kur lexojnë këto hadithe apo profetësi, preken nga steriliteti, negativiteti dhe të izoluarit nga puna islame.

Sterilitet në fushën e studimit dhe ekzaminimit, të ndjekjes dhe zbulimit të së panjohurës.

Negativitet në lëvizje, thirrje dhe punë.

Izolim nga bota reale dhe shoqëria, si dhe të mjaftuarit me supozimin e përmirësimit të vetvetes. Një përmirësim i ftohtë, negative, i burgosur, i cili është më pranë arratisjes nga aktualiteti sesa përmirësimit.

Këta që rrinë ulur dhe nuk i përcaktojnë shkaqet e aktualitetit të hidhur, as nuk i njohin faktorët dhe ligjet e ndryshimit të shoqërisë dhe individëve, këta nuk janë më të mirë se ata të cilët janë zhytur në pasuritë e kësaj bote dhe stolitë e saj, ata të cilët dështuan në fushën e ndryshimit psikologjik dhe shoqëror, kështuqë iu drejtuan shpërthimit të energjive të efektshme në fushën e garimit për dynjanë dhe përkujdesjes për kënaqësitë e saj, pasi panë se çështjet ishin mbi mundësitë e tyre, sipas supozimit të tyre.

Ndoshta nuk habitemi nëse i shohim të zotët e këtyre bindjeve ideologjike, larg fitneve (sipas shprehjeve të tyre) dhe të izoluar nga jeta. As kur i shohim ata t'ia ngjisin çdo gjë

caktimit dhe përcaktimit të Allahut, pasi ata nuk kanë mundësi t'i bëjnë rezistencë gjendjes së keqe aktuale, sepse këto (sipas asaj mbi të cilën ata janë edukuar), janë fitne të pashmangshme, për të cilat ka paralajmëruar i Dërguari i Islamit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Kështu që nuk ka asnjë mundësi për t'u bërë ballë atyre, sepse ato janë prej dëshirës së Allahut të Lartësuar.

Nuk habitemi gjithashtu, nëse mësojmë se ata justifikues të vetes së tyre, që janë mbështetur tek fati, ata në fakt janë mbetje të kohëve të izolimit ideologjik, të cilët nuk janë edukuar mbi bazat e sakta për konceptet ligjore që gjenden në Kuran, në sunetin e ndershëm profetik dhe në gjurmët e sahabëve të ndershëm, as nuk i kanë perceptuar faktorët historik të ndryshimit të njerëzisë në përgjithësi dhe të Islamit në veçanti.

Ata në fakt, jetuan duke shtënë në dorë hadithe të shpërndara për paracaktimin e Allahut, për fitnet, kasaphanet, shenjat e Kijametit, Dexhalin etj, duke qëndruar krejt larg perceptimit të pikësnyimeve të vërteta të sheriatit islam dhe larg lëvizjes për ndryshim në jetën e brezit të parë të sahabeve (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!).

E para gjë që tërheq vëmendjen (veçanërisht kur jemi duke folur për hadithet e fitneve dhe rrënujave), është koncentrimi i fortë në efikasitetin e njeriut në këtë jetë dhe në influencën e tij të madhe në procedurën për ndryshim dhe për konstruksionin e botës dhe sundimin e saj. Kjo gjë na bëhet e qartë në të perceptuarin e vërtetë të domethënies së xhihadit në Islam, por të xhihadit me kuptimin e tij të gjerë e gjithpërfshirës, si dhe me përcaktimin e misionit themelor të njeriut musliman në jetë, i cili është sakrifikimi i të gjitha orvajtjeve për të ngritur lartë Fjalën e Allahut në tokë.

Pastaj koncentrimi kuranor në formimin e bindjes së prerë për akiden e teuhidit "La ilahe il-Allah" dhe bindja e plotë se varësia në Ditën e Gjykimit do të jetë varësi individuale dhe çdo njeri do të llogaritet për punën e tij.

Të gjitha këto, përbëjnë një pjesë të madhe të mjeteve për të arritur te personaliteti i efektshëm islam; personaliteti, i cili nuk justifikohet me aktualitetin e hidhur dhe të supozojë se kjo është koha që muslimani duhet të shtrëngojë fortë me dhëmballë trungun e pemës dhe të largohet nga fitnet..., prej nga ai jep vendim me vdekje për veten e tij para se t'ia japë dikush tjetër, dhe as personaliteti i mbështetur tek fati, i përshtjelluar dhe i mundur përbrenda.

Por, ai personalitet, i cili nuk ia hedh të gjitha fajet rrethanave dhe ambientit, sikur vetë të ishte i pastër nga të metat dhe defektet.

Ai personalitet, i cili nuk i gjymton fuqitë që i ka dhuruar Allahu në rolin e tyre për konstruksionin e botës dhe përmirësimin e saj.

Ai personalitet reagues në betejat e jetës, marrës dhe dhënës, ndërtues dhe ambicioz, personalitet i ekstraktuar nga Drita e Allahut, i frymëzuar nga hapat e pejgamberëve

dhe përtëritësve, orbita e të cilit ndriçohet nga shembuj të gjallë nga jeta e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) dhe nga biografitë e të gjitha figurave që kanë vënë në jetë akiden islame në historinë e gjatë të muslimanëve.

Fitnet për të cilat ka folur i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), nuk janë ndonjë lloj detyrimi, apo ndonjë paracaktim i pashmangshëm që kufizon njerëzit, duke mos pasur ata asnjë faj në të, apo pa i favorizuar atyre shkaqe, rezultatet e të cilave i godasin ata.

Jo, fitnet nuk janë veçse rezultat i punës së vetë njerëzve: **"Dhe çfarëdo fatkeqësie që t'ju bjerë, ajo është rezultat i punës së duarve tua, megjithëse Ai fal shumë të tjera."** [Esh Shura: 30].

Prej këtui, procedura për ndryshim, për ndalimin nga e keqja, si dhe ngritja e njerëzve me shtyerjen e shkaqeve të fitneve dhe kauzave të tyre, do të ndihmonin shumë në mbrojtjen dhe në të qëndruarit larg tyre.

Fitnet, për të cilat ka folur i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), nuk janë ndonjë lloj detyrimi, aq sa mund të jenë paralajmërim me disa të fshehta, të cilat do të ndodhin si rezultat i faktorëve shpirtëror të brendshëm dhe faktorëve shoqëror; d.m.th. ato janë në rolin e ligjeve dhe standardeve në kaldajën e të cilave bien njerëzit, duke u bërë kështu e detyrueshme rënia e rezultateve të tyre mbi ta.

Bindja jonë se këto faktorë janë të përcaktuar faktikisht dhe realisht, është ajo që na dikton neve llojin e punës së kërkuar prej nesh për të mbrojtur vetet tona nga zonat e dënimit të Allahut dhe zemërimit të Tij.

Sipas këtij perceptimi të realitetit të ligjeve ndëruniversale dhe lirisë së Dëshirës Hyjnore (gjithashtu), mundemi të vizatojmë rrugën në të cilën duhet të ecim, aq më tepër kur në shumicën e rasteve ne nuk posedojmë argumente të mjaftueshme (praktike) të cilat vërtetojnë se ato shkaqe kanë ndodhur vërtet, që më pas të themi prerë e të vulosim se do të ndodhin rezultatet e tyre prej fitneve, katastrofave e fatkeqësive.

Prej atje shfaqet marrëzia e atij vështrimi pesimist, larg realitetit të jetës dhe të izoluar nga përmirësimi i rrjedhës së jetës njerëzore.

Prej këtui, nuk ka vend për atë mentalitet të lëkundshëm, aq më tepër kur këndvështrimi i tyre nuk është i saktë...

Megjithatë, nëse do të supozonim se shkaqet e fitneve kanë ndodhur vërtet dhe të supozojmë se të gjithë faktorët tregojnë se fitneja është shumë pranë dhe njerëzve u është dhënë lamtumira.

Të supozojmë gjithashtu, se ne e vërtetë (ndërmjet shkaqeve paraprake) se rezultatet e tyre do të ndodhin patjetër; a do të thotë kjo se ne duhet t'i dorëzohemi fitneve dhe t'i hipin dallgëve të tyre pa anije dhe pa vela, pa bërë rezistencë dhe pa i kundërshtuar ato?! Apo t'i nënshtrohemi rrymës së zhurmshme të tyre, pa rezistencën më të vogël?!

A mos është ky misioni i muslimanit, me të cilin e ka ngarkuar Allahu?! A mund të justifikohet me të para Zotit të tij atë ditë kur të ngrihen njerëzit para Zotit të botëve?! A e pëlqen Zoti i tij nga ai këtë negativitet therres, saqë të arrijë gjendja me ne deri aty sa të mos mundemi të ndryshojmë të paktën vetet tona?!

Nuk është më brenda mundësive të muslimanit që të ndryshojë shoqërinë e tij në atë mënyrë rrënjësore të kërkuar. Kështu, më e pakta që mund të bëjë, është që ai vetë në veten e tij t'i përmbahet ligjeve dhe rregullave të atij ndryshimi dhe të përpiqet me të gjithë mundin e tij që të ruajë më të afërmit e tij e t'i mbrojë nga katastrofa e fitneve.

Ndërsa negativiteti, qëndrimi duarkryq dhe dorëzimi para kundërvajtjeve të sheriatit dhe trysisë së aktualitetit, pastaj nënshtimi para kërkesave të tij dhe mbytja në situatat e tij; kjo nuk është prej kësaj feje, as nga afër dhe as nga larg.

Në vijim, ndoshta në të gjithë këtë gjendet diçka që i bind ata mbështetës në mëshirën e fatit dhe ata që qëndrojnë duarkryq, t'i kthehen praktikimit të rolit të tyre të rrezikshëm në jetën e njerëzve dhe të mbarë njerëzisë, dhe të ngjiten nga ajo humnerë e pafund, në të cilën janë duke rënë. Ndoshta ne do të perceptonim kuptimin e fitnes dhe se si i pushton ajo njerëzit. Ajo i pushton ata në varësi të disa ligjeve dhe kushteve. Ajo i pushton ata për shkak të harresës së tyre të shumë realiteve, ose për shkak të injorimit të saj dhe pavëmendjes së tyre se ajo punon fort në aktualitetin e jetës së tyre. Kështu, fitneja dhe fitnet, ashtu siç janë prej paracaktimit të Allahut, si dhe çdo incident tjetër në botë, por ato kanë lidhje me rregullin e shkakut dhe përfundimit: **"Kështu që, ata i goditi e keqja e punës së duarve të tyre."** Zumer: 51.

Me këtë perceptim të kësaj feje dhe të domethënies së fitnes, ne mbrojmë vetet tona nga të qënurit si shumë prej njerëzve, të cilët nuk lëvizin gisht (nuk e prishin gjakun) duke supozuar se gjenden përballë një fitneje të verbër për të cilën nuk ekziston ndonjë "Ebu Bekër" dhe muslimani nuk mund të bëjë gjë tjetër përballë saj vetëm se të izolohet, të mbyllet dhe të dorëzohet.

Ky perceptim i domethënies së imanit-besimit dhe rruga e punës së kësaj feje në jetën njerëzore, na imponon neve pathyeshmërinë para fitneve, madje jo vetëm kaq, por të ndryshojmë aktualitetin shoqëror dhe para tij atë shpirtëror; në mënyrë që t'i ndryshojmë drejtimin kësaj gjendjeje dhe ta kthejmë aktualitetin njerëzor në drejtimin që kënaq Allahun e Madhëruar.

Nuk ka ndonjë dallim nëse dështojmë apo kemi sukses, e rëndësishme është që ne të përmbushim misionin tonë, për të cilin jemi krijuar; d.m.th. të mos jemi pasivë në

ballafaqimin me aktualitetin, të punojmë, edhe nëse i vjelim frytet e punës sonë këtu, sepse frytet e vërtetë të punës sonë do t'i vjelim në xhenet.

**"Dhe thuaj: Punoni, sepse Allahu do ta shohë punën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët!"** [Et-Teube: 105].

**"Ai i Cili krijoi vdekjen dhe jetën ashtu që t'ju sprovtojë juve se cili prej jush do të veprojë më mirë?!"** [El Mulk: 2].

Fitnet që kanë ndodhur në kohët e vjetra, pas të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) nuk janë dhe nuk do të jenë autorizim për këmbëkryqet që të na bindin edhe neve të qëndrojmë ulur dhe të mbështetemi te fati. Menhexhi (drejtimi, metodologjia) është baza, ndërsa historia islame nuk është vetëm se praktikim i menhexhit, me të cilin mund të përputhet shumë, ose ta kundërshtojë e të dalë nga ai ndonjëherë.

Ishin të domosdoshme (në mbyllje) këto fjalë të kësaj natyre, me qëllim që të mos keqkuptohen tekstet dhe përfitimi prej tyre te disa njerëz, si dhe që të jetë faktor për vëmendjen dhe përkujdesjen, për punën kundër rrymës së fitneve dhe jo të pajtohemi me të, t'i dorëzohemi dhe t'i nënshtrohemi asaj.

Nga ana e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ato kanë qënë njoftim për çështje të fshehta, argument për vërtetësinë e profetësisë së tij, paralajmërim për muslimanët nga të zhyturit në fitne, nga lehtësimi i rrugës së tyre, apo nga të kontribuarit për lindjen dhe vazhdimin e tyre. Si dhe me qëllim që sahabet (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) të ishin të vëmendshëm për çdo të papritur.

**ktthehu lart**

\*\*\*

## Kapitulli i dhjetë

### Fitneja dhe nxënësit shqiptarë të dijes

Është e natyrshme që edhe muslimanët shqiptarë, dhe veçanërisht nxënësit të cilët studiojnë në vendet islame, të kenë qëndrimin e tyre në lidhje me këto trazira, sepse ata janë pjesë e popullit musliman.

Kështu, nëse do të hidhje një vështrim në gjendjen e tyre, do t'i gjeje ata të ndikuar nga vendi në të cilin ata gjenden dhe pse jo edhe të përzierë në çfarë ndodh rreth tyre. Ata

mund të konsiderohen individë të shoqërisë ku ata i kalojnë ato vite të jetës së tyre studentore, por me një dallim, ata gjenden në këto vende posaçërisht për kërkimin e dijes fetare dhe jo si individë të thjeshtë të popullit.

Që të mësonim më shumë për gjendjen e nxënësve shqiptarë të dijes, do të na duhej të njihnim gjendjen e nxënësve të dijes së vendeve në të cilat ata studiojnë, sepse siç e thamë, ata bëhen pjesë e asaj shoqërie.

Kemi dëgjuar shumë dhe kemi parë që gjendja e këtyre nxënësve nuk është e kënaqshme dhe nuk është duke ecur në rrugën e duhur. Shpeshherë, duket sikur ata ia kanë kaluar mosmarrëveshjeve të vetë nxënësve të dijes të konsideruar, gjë e cila ka çuar në përçarjen dhe ndarjen e tyre në grupe, ku secili grup e quan grupin kundërshtar me terma e llagape, të cilat nuk u shkojnë për shtat nxënësve të dijes.

Më e keqja është se këto gjëra transportohen në atdhe tek muslimanët e pastër e të pafajshëm të atij vendi të shumëvujtur, për të derdhur helmin tek ata, në fazën e tyre të çeljes.

Për Zotin, përgjegjësia është e madhe dhe ende nuk është kuptuar ashtu siç duhet. Duhet të bëhet e ditur se kjo nuk është e veçantë për nxënësit shqiptarë të dijes, por për të gjithë nxënësit e dijes muslimanë kudo që ndodhen dhe të çdo kombësie.

Të gjithë ata pohojnë se duhet bërë bashkim dhe njësim i fjalës së muslimanëve, por ata harrojnë themelin, harrojnë bazat dhe faktorët ndikues, mashtrojnë veten dhe popullin.

Nuk ka bashkim, nëse nuk bashkohen idetë dhe mendimet, sepse siç thonë dijetarët e mëdhenj: "Ne jemi grup që na bashkon të kuptuarit e idetë dhe jo trupat tanë."

Prandaj, duhet ta dinë të gjithë nxënësit shqiptarë dhe jo shqiptarë të dijes se bashkimi i fjalës së këtij populli musliman bëhet vetëm mbi paravija, zbatime dhe përfundime të sakta. Kemi për qëllim me "paravijat", bazat dhe menhexhet në të cilat duam të ndërtojmë, dhe kemi për qëllim me "të sakta", sipas sheriatit dhe në përputhje me të.

Të gjitha këto, bëhen duke pyetur dijetarët dhe duke ndjekur udhëzimet e tyre, duke hequr dyshimet dhe duke u kthyer te të sigurtat.

Unë u bëj thirrje të gjithë vëllezërve të mi, të cilët janë nxënës të dijes, të kenë frikë Allahun në veten e tyre, në nxënësit e tyre dhe në vëllezërit e tyre muslimanë!

Të ulin kokën dhe të mësojnë fenë e Allahut dhe ligjet e sheriatit, me qëllim që kur të kthehen në vendin e tyre, ta edukojnë popullin sipas Islamit të vërtetë dhe dijes së saktë!

Të bashkohen të gjithë në zemrën e një burri të vetëm pas udhëzimeve të dijetarëve të mëdhenj edukatorë si Ibën Bazi, El Albani, Ibën Uttejmini etj.

Nëse vendi ku ata ndodhen është i përzierë në fitne e trazira, ata e dinë se ç'duhet të bëjnë! E vërteta është e qëndrueshme, ndërsa e kota nuk ka rrënjë. Menhexhi i saktë është bazë, ndërsa dyshimet dhe devijimet janë aksidentale e të paqëndrueshme, siç e vumë re edhe në ngjarjet e shtjelluara në këtë libër.

Tërheqim vëmendjen këtu për një fenomen të kohëve të fundit, rrënjët e të cilit nuk janë shumë të largëta, por efekti i tij ka qënë i fortë dhe ka prekur shumë prej nxënësve të dijes së kësaj kohe. Mund të them se nuk ka shpëtuar prej tij, vetëm se një pakicë, të cilën e ka ruajtur Allahu i Lartësuar me Mëshirën e Tij, madje nuk do të ngurroja të aprovoja këtu (sidomos pas atyre që pamë në këtë libër) se Allahu nuk humb kënd vetëm nëse ai e humb veten e tij dhe nuk e kërkon të vërtetën me përkushtim dhe sinqeritet të plotë.

Ky fenomen është mikstura apo përzjerja ndërmjet të vërtetës dhe të kotës, ndërmjet të drejtës dhe të shtrembërës, ndërmjet sunetit dhe bidatit. Këta marrin nga selefët atë që iu intereson si dhe emrin, marrin nga ihuanul muslimin atë që iu intereson, marrin nga tabligët atë që iu intereson, marrin nga huarixhët atë që iu intereson dhe në përfundim dalin me një miks, të cilit i vënë emrin "selefi" apo "ehli suneh".

Subhanallah! Sikur rruga e selefëve të mos jetë e plotë dhe e mjaftueshme. Sikur të parëve, të cilët janë brezi i ndritshëm dhe i zgjedhur nga Allahu për shoqërimin e të Dërguarit të Tij dhe për ndihmën e fesë së Tij, t'u kenë shpëtuar gjëra që i kanë kapur këta!!!

Kur do të jetë ajo kohë kur muslimanët të gëzojnë dhe të shijojnë bashkimin e tyre në kënaqësi të Allahut dhe në rrugën e hartuar nga Ai?

A e dini se të fundit e këtij populli nuk mund të rregullohen e përmirësohen vetëm se me atë që u rregulluan dhe u përmirësuan të parët e tij?!

Kur do të jetë ajo kohë kur muslimanët t'i kthehen Fesë dhe udhëzimeve të dijetarëve të tyre?

Kur do të jetë ajo ditë kur nxënësit e dijes do të ecin përkrah njëri-tjetrit, dashamirë të njëri-tjetrit, tolerues dhe vëllezër të njëri-tjetrit?

**"Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ata vetë ta ndryshojnë gjendjen e tyre."** [Er Ra'd: 11].

Lusim Allahun e Madhëruar të na udhëzojë në të drejtën e asaj në të cilën ka kundërshtim dhe të na japë sukses në fjalë e në vepër!

O Zot, ktheji muslimanët te feja e tyre me një mënyrë të mirë!



O Zot, bashkoje fjalën e muslimanëve mbi të vërtetën dhe jepu atyre vendin që u takon në mesin e popujve! Ti je Zot i kësaj dhe i Mundshëm për çdo gjë!

**Amman, Jordani 25.08.2004**